


MedMPAnet^{project}

PLANI I MENAXHIMIT PËR PARKUN NATYROR “GJIRI I PORTO PALERMOS- LLAMANI” NË SHQIPËRI (ALBANIA)



Punonjësit e titulluar dhe materiali i prezantuar në këtë dokument, nuk paraqesin asnjë shprehje opinionit të çfarëdo lloji nga ana e institucionit të UNEP/MAP – RAC/SPA në lidhje me statusin ligjor të Shteteve, Territoreve, qyteteve ose zonave, ose të autoriteteve drejtuese, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve ose territoreve të tyre. Mendimet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë detyrimisht ato të UNEP/MAP-RAC/SPA.

Publikuar nga: RAC/SPA

Copyright: © 2015 - RAC/SPA

Riprodhimi i këtij botimi për qëllime edukative ose qëllime të tjera jo tregtimi, është i autorizuar pa miratimin paraprak me shkrim nga mbajtësi i autorësisë duke mirënjohur plotësisht burimin. Riprodhimi i këtij botimi për shitje ose për qëllime biznesi është i ndaluar pa miratimin paraprak me shkrim nga mbajtësi i autorësisë.

Për qëllime bibliografike, ky botim mund të citohet si:

RAC/SPA - UNEP/MAP, 2015. Plani i Menaxhimit për Parkun Natyror “Gjiri i Porto Palermos-Llamani” në Shqipëri. Nga Zamir DEDEJ, Genti KROMIDHA dhe Nihat DRAGOTI. Ed. RAC/SPA - Projekti MedMPAnet, Tunis: 84 p + Aneksat.

Faqesja: Zine El Abidine MAHJOUB dhe Asma KHERIJI.

Fotografia në kapak nga: Audimage.

Photographitë nga: INCA dhe Audimage.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të Projektit Rajonal për Zhvillimin e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura Detare e Bregdetare (ZMD-ve) të Mesdheut nëpërmjet mbështetjes së Krijimit dhe Menaxhimit të ZMD-ve në Mesdhe (Projekti MedMPAnet).

Projekti MedMPAnet zbatohet në kuadër të programit të UNEP/MAP-GEF që quhet MedPartnership, me mbështetjen financiare të KE, AECID dhe FFEM.



PLANI I MENAXHIMIT PËR PARKUN NATYROR “GJIRI I PORTO PALERMOS-LLAMANI”

MedMPAnet project

Mbështetje për planifikimin, zonimin dhe zhvillimin e Zonës së Mbrojtur Detare në Gjirin e Porto Palermos (Shqipëri), bazuar në njohuri të shëndosha shkencore dhe socio-ekonomike

Studimi i kërkuar dhe financiar nga:

MedMPAnet^{project}

Qendra e Aktiviteteve Rajonale për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura (RAC/SPA)
Regional Activity Centre for Specially Protected Areas (RAC/SPA)
Boulevard du Leader Yasser Arafat
B.P. 337
1080 Tunis Cedex – Tunisia

Të ngarkuar për studimin :

Souha EL ASMI, Projekti MedMPAnet, RAC/SPA
Atef LIMAM, Projekti MedMPAnet, RAC/SPA

Stafi shkencor i studimit :

Zamir DEDEJ, Ekspert i Biologjise Detare, Drejtor i Përgjithshem i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (Albania)
Genti KROMIDHA, Ekspert i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, President i INCA (Albania)
Nihat DRAGOTI, Ekspert i zonave të mbrojtura pranë INCA (Albania)

Referenca për studimin :

MoU n° 04/MedMPAnet/2013

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) u shpreh mirënjohjen autoriteteve, personave dhe ekspertëve nga të gjithë institucionet, grupeve të interesit, OJF-ve, shoqërisë civile, etj, që kontribuan në mbledhjen e të dhënave, informacionit dhe në mbështetjen e dhënë për hartimin e Planit të Menaxhimi për zonën bregdetare-detare të Gjirit të Porto Palermos-Llamani.

Falënderime të veçanta, shkojnë për Ministrinë e Mjedisit, Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve dhe stafin e Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura.

Falenderimi u drejtohet përfaqësuesëve të RAC/SPA (UNEP/MAP) të cilët mbështetën zhvillimin e «Projektit pilot MedMPAnet në Shqipëri», kuadër të Projektit Rajonal për Zhvillimin e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura Detare e Bregdetare (ZMD-ve) të Mesdheut, nëpërmjet mbështetjes së Krijimit dhe Menaxhimit të ZMD-ve në Mesdhe. Gjithashtu falenderojmë UNDP për kontributin e tyre në pjesën e fundit të studimit.

Në nivel lokal falenderojmë Këshillin e Qarkut Vlorë, Bashkinë e Himarës, personelin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjorë Vlorë dhe institucionet e tjerë të zonës.

Falenderojmë shoqërinë civile, shoqata mjedisore, veçanërisht “Adriatiku”, pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe të gjithë grupet e interesit të kësaj zone të mbrojtur, për kontributin e dhënë në diskutimin final të planit të menaxhimit.

Falenderojmë, Prof. Lefter Kashta, Prof. Dr. Sajmir Beqiraj, Arjan Gaçe, Xhemal Mato, për “Studimi ekologjik i Gjirit të Porto Palermos dhe zonave përreth”. Njëherazi, Thanas Goga e Franka Paloka për “Analiza socio-ekonomike dhe studimi mbi zhvillimin e turizmit”.

Gjithashtu, falënderojmë, Msc. Valbona Simixhiu, për përgatitjen e hartave të përfshira në këtë plan menaxhimi.

SHKURTESA & AKRONIME

AdZM	Adriministrata e Zonës së Mbrojtur
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
CITES	Konventa për Tregëtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së egër
DBZM	Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura
DBZM	Zonë e Mbrojtur Detare e Bregdetare
DSHP	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
DSHPQ	Drejtoria e Shërbimit Pyjor e Qarkut
INCA	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
INUK	Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar
ISHMPU	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës
KB	Konventa e Biodiversitetit
KBZM	Konventa Botërore për Zonat e Mbrojtura
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KoM	Komiteti i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur
MedMPAnet	Rrjeti i Zonave të Mbrojtura Detare i Mesdheut
MEM	Monitorimi i Efektivitetit të Menaxhimit
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mjedisit
MMb	Ministria e Mbrojtjes
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MZHUT	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
OJF	Organizatë Joqeveritare
PEMMZMDB	Përmirësimi i Efektivitetit të Mbulimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare-Bregdetare
PN	Park Natyror
PIM	Plan Menaxhimi
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
PPL	Planit i Përgjithshëm Lokal
PSZMDB	Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare e Bregdetare
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
RAC/SPA	Qendra e Aktiveteve Rajonale për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura
RrE	Rrjetit Ekologjik
SNM	Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit
SPLVB	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin
SSHPR	Seksioni i Shërbimit Pyjor i Rrethit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZM	Zonë e Mbrojtur
ZMVRM	Lista e Zonave me Mbrojtje të Veçantë me Rëndësi për Mesdheun
ZVR	Zonë e Veçantë e Ruajtjes

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	9
1. Informacion i përgjithshëm dhe përshkrim i zonës së mbrojtur bregdetare-detare (ZMBD)	9
2. Vlerat	12
3. Kërcënimet kryesore	12
4. Vizioni dhe objektivat për ZMBD	13
5. Zonimi dhe menaxhimi	13
6. Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit	14
HYRJE	17
1. Përshkrimi i përpunimit të Planit të Menaxhimit (PIM)	17
2. Përshkrimi i strukturës së planit të menaxhimit	18
3. Kujt i drejtohet plani ?	19
4. Qëllimi i planit	19
5. Kohëzgjatja e planit	20
I. PËRSHKRIMI I ZONËS SË MBROJTUR BREGDETARE–DETARE (ZMBD)	23
1.1 Kriteret e përzgjedhjes së ZMBD	23
1.2 Vendndodhja	24
1.3 Statusi ligjor i ZM	26
1.4 Politikat dhe legjislacionet	28
1.5 Strukturimi institucional	30
1.6 Përshkrim i sistemit natyror të ZM	32
1.7 Përshkrimi i sistemit social-ekonomik, përfshirë zotërimin e tokës	34
1.8 Struktura qeverisëse aktuale dhe ajo e parashikuar	35
1.9 Përshkrimi i peizazhit kulturor dhe trashëgimisë	36
II. VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR DHE I KUADRIT INSTITUCIONAL	39
2.1 Vlerësimi i Vlerave	39
2.1.1 Vlerat ekologjike	39
2.1.2 Vlerat social-ekonomike	44
2.1.3 Vlerat kulturore	44
2.2 Vlerësimi i Kornizës Institucionale	45
2.3 Vlerësimi i Kërcënimeve	45
III. MENAXHIMI ZONËS SË MBROJTUR	49
3.1 Vizioni dhe Objektivat	49
3.1.1 Vizioni, misioni dhe funksionet	49
3.1.2 Programet dhe Objektivat afatgjatë të menaxhimit	49
3.1.3 Objektivat afatshkurtër të menaxhimit	50
3.2 Përcaktimi i Zonave të Menaxhimit	54
3.3 Veprimet Menaxhuese	57
3.4 Plani i Veprimit	63
IV. PLANI FINANCIAR	71
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I MENAXHIMIT	77
VI. REFERENCAT / BIBLIOGRAFIA	83
ANEKSET	


LISTA E TABELAVE

- Tabela 1: Përdorimi i territorit të zonës së mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”
- Tabela 2: Krahasimi i përkufizimeve të kategorive të menaxhimit të zonave të mbrojtura
- Tabela 3: Përshkrim i shkurtër i kufizimeve kryesore për menaxhimin e ZM
- Tabela 4: Grupet e interesit, roli i tyre në administrimin e burimeve natyrore
- Tabela 5: Habitete detare kryesore të zonës
- Tabela 6: Nën-zonat e menaxhimit dhe sipërfaqja
- Tabela 7: Zonimi i sipërfaqes së ZM “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”
- Tabela 8: Veprimet kryesore menaxhuese
- Tabela 9: Buxheti sipas programeve
- Tabela 10: Ndjekja e efektivitetit të menaxhimit të planin e menaxhimit të ZM

LISTA E HARTAVE

- Harta 1: Zona e mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”
- Harta 2: Përdorimi i territorit të zonës së mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”
- Harta 3: Habitatet kryesore detare të ZM
- Harta 4: Zonimi i territorit të ZM “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”





PËRMBLEDHJE

1. Informacion i përgjithshëm dhe përshkrim i zonës së mbrojtur bregdetare-detare (ZMBD)

Himara shtrihet përgjatë bregut Jon të Shqipërisë (banorët vendas e quajnë Bregu). Përfaqësonë pjesën VP të tij, nga rrëza jugore e Qafës së Llogarasë deri tek mali i Qeparoit, në JL, me një gjatësi në vijë të drejtë prej 22 km.

Krahina e Himarës përbëhet nga qyteti i Himarës së bashku me 10 fshatra: Palasa, Dhërmiu, Gjilekë (ish-lagje e Dhërmiut), Vunoi, Iliasi (ish-lagje e Vunoi), Himara, Piluri, Kudhësi, Qeparoi dhe Qeparo-Fushë (ish-lagje e Qeparoit).

Veçoritë gjeografike të Himarës¹ përbëhen nga një vijë bregdetare, që me gjarpërimet e saj nëpër kepat e gjiret, arrin në rreth 37 km. Ajo është e lartë, shkëmbore, me gremina rrëpirët vertikalisht mbi det, por ka edhe shumë gjire, ku formohen plazhe zallore të mrekullueshëm. Në gjatësinë e përgjithshme të vijës bregdetare, bregu shkëmbor dhe greminat zënë rreth 26 km, kurse plazhet zallore afër 11 km. Duke pasur një vijë të gjatë bregdetare me plot kontraste dhe me bukuri të rralla natyrore, Himara ka kushte shumë të mira e të qëndrueshme për turizmin.

Treva e Himarës, dallohet nga një ndërtim gjeologjik mjaft kompleks dhe i larmishëm. Ndërlidikimet gjeologjike dhe tektonike të konsiderueshme janë pasqyruar edhe në karakterin e relievit. Proceset tektonike në zonën e Himarës janë aktive edhe sot.

Relievi i trevës është kryesisht malor, por vende-vende malet që e rrethojnë atë ulen drejt Perëndimit në disa kodra gëlqerore me lartësi nga 200-300 m në 700-900 m. Brenda dhe rreth ZM gjenden mali i Vërrit (547 m) dhe i Qytezës (578 m).

Relievi i Himarës është shumë i thyer dhe i përçarë nga ujërat rrjedhëse të përrenjve malorë. Shumica e këtyre përrenjve kanë rrjedhje të përkohshme, janë me ujë aq kohë sa vazhdojnë shirat dhe e kanë çarë truallin shkëmbor, duke formuar shtretër të thellë në trajtë grykash, madje edhe kanionesh të ngushta. Përrenjtë kanë fuqi gërryese dhe kur zbresin në det depozitojnë sasi shumë të mëdha jo vetëm materialesh copëzore. Përroi i Bucit (i Koramit) derdhet në Potam, ndërsa përroi i Thatë derdhet në gjirin e Lllamanit, ku ka formuar një plazh shumë piktoresk.

Në relievin e Himarës vend të veçantë zënë format dhe proceset karstike. Ky lloj relievi është shumë i përhapur. Sheshe e fusha karstike më të vogla ka në kodrën e Kolzës (552 m), të Qytezës (578 m), që shtrihen në lindje të Himarës, në Qafën e Lerës (midis Lllamanit dhe Portopalmos) dhe në shumë vende të tjera të Himarës.

Elementet kryesore morfologjike të bregdetit të Himarës janë kepat shkëmborë, gjiret, greminat (falezat) dhe plazhet zallore. Kepat në bregun e Himarës hyjnë disa qindra metra në det dhe drejtimi i tyre i përgjithshëm është JP dhe Jug. Në ZM dallohen: Kepi i Alpunit (Prato), që shtrihet në Jug të kepit të Niqiforit (Mësunit). Është krejtësisht shkëmbor, formon gremina, rreth të cilave thellësitë janë të mëdha. Në përbërje të këtij kepi janë edhe tre gjire e kepe të vegjël, pjesë të Gjirit të Lllamanit. Kepi i Kavadonit është një nga më të mëdhenjtë e bregut Jonik. Ka drejtëm Jugor dhe futet 1.5-2.5 km në det. Maja e tij ulet në det në mënyrë të butë, ndonëse në anët formohen gremina disa metra të larta. Kepi i Panormës ka pamjen e një gadishulli të vogël shkëmbor, me formë thuajse të rrumbullakët. Ai futet në det rreth 1 km, duke formuar gremina, që shkojnë deri në 115 m.

Kepat e fundit të bregut të Himarës janë kepi i Spinarasit, në Jug të Panormës dhe i Shën-Dhimitrit (Sugës) në JL të të parit. Kepat rrethojnë sipërfaqe ujore, duke krijuar gjire të shumta në formë harku e patkoi, me brigje të larta shkëmbore ose me thellësi të mëdha.

Gjiret janë formuar nga fundosjet tektonike, por brigjet e tyre janë modeluar nga veprimtaria e detit. Gjiri dhe plazhi i Lllamanit shtrihet rreth 3 km në Jug të Himarës. Skajet e tij janë shkëmbore, sidomos jugori, ku formohet një greminë rreth 30 m e lartë. Pjesa tjetër e bregut formon një plazh zallor shumë të bukur. Është formuar nga zajet e çakëllet e sjella nga Përroi i Thatë. Është nga plazhet që parapëlqehet prej vizitorëve. Në anën Jugore të tij gjernden dhe burime ujore nëndetare.

Gjiri i Palmos (Portopalmos), i njohur qysh në kohën antike, është gjiri më tipik, më i bukur e më madhështor i gjithë bregut Jonian të Shqipërisë. Është i futur në tokë rreth 2 km, kurse gjerësia e hyrjes është 1.5 km. Një kep i vogël shkëmbor, në trajtën e një gadishulli, me emrin Gadishulli i Kalasë, gjendet Kalaja e ndërtuar në periudhën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës. Gadishulli e ndan gjirin në dy pjesë: në gjirin e Armeridhës dhe të Shën Nikollës. Në pjesën veriore të gjirit të Armeridhës gjenden burime ujore nëndetare dhe shpella.

⁽¹⁾ Prof. M. Kabo, «Himara në shëkuj», Tiranë 2004.

Brigjet e gjirit janë shkëmbore, me gremina që luhaten nga 50-60 m, e madje deri në 115 m, siç është gremina e famshme e Panormës, në pikën më të lartë të Kepit me të njëjtin emër. Kepi në gadishullin e Kalasë është i futur në det 40 m dhe brigjet i ka të larta. Gadishulli është i veshur me shkurre mesdhetare.

Thellësitë e hyrjes në gji janë 80-105 m, kurse brenda tij 65-75 m. Tek istmi, që lidh bregun me gadishullin e Kalasë, është ngritur një mol për qëndrim anijesh. Gjiri i Portopalermos ka vlera shumë të mëdha turistike, por nuk ka asnjë lloj infrastrukture.

Gjiri i Gravës apo i Panormës i futur në tokë rreth 35 m është krejtësisht shkëmbor e me gremina. Thellësitë në hyrje të gjirit janë 30-35 m, kurse në krye të tij 10-13 m.

Treva e Himarës, ka një klimë të tipit mesdhetar. Dallohet për stinën e dimrit shumë të lagësht dhe të butë, thuajse pa temperatura negative dhe pa ngrica; për verën e thatë dhe të nxehtë, me reshje të papërfillshme; për pranverën e paqëndrueshme, e cila kalon përnjëherë në verën e nxehtë dhe sidomos për vjeshtën e gjatë, relativisht të thatë (shtator-tetor) dhe më të ngrohtë se pranvera. Këto veçori klimatike lidhen me pozitën gjeografike të saj dhe shprehin shumë qartë natyrën mesdhetare të klimës.

Temperatura mesatare vjetore në zonë është 16.8 °C. Mesatarja e lartë e të dy muajve më të ftohtë të vitit tregojnë se periudha e vegjetacionit në trevën e Himarës nuk ndërpritet gjatë dimrit ose ndërpritet për një kohë shumë të shkurtër.

Temperaturat më të larta realizohen në muajin Gusht (karakteristikë kjo e gjithë vendeve bregdetare) dhe shkojnë deri në 30 °C e më shumë. Temperatura mesatare e muajit Gusht arrinë në 25.5 °C. Temperaturat maksimale shkojnë deri në 32-36 °C dhe më rrallë edhe 38-39 °C. Temperaturat minimale më të zakonshme lëvizin nga +1.5 -2 °C, por në raste të veçanta ato mund të ulen edhe më poshtë.

Rrezatimi diellor është shumë i lartë, rreth 1495 kwh/m². Shuma e orëve me diell është 2442 orë/vit, kurse numri i ditëve me diell është 136 ditë/vit.

Në trevën e Himarës bien sasi të konsiderueshme reshjesh, kryesisht në formë shiu, ndërsa dëbora është një dukuri shumë e rrallë. Bie mesatarisht 1442mm/vit. Karakteristikë e ecurisë vjetore (stinore) të reshjeve në Himarë është shpërndarja e pabarabartë e tyre. Nga Tetori-Mars bie rreth 80 % e sasisë së përgjithshme të reshjeve. Në tre muajt e verës nuk bie veçse 4-5 % e reshjeve vjetore. Reshjet verore zakonisht lidhen me avullimin e madh, shoqërohen me vetëtimë e bubullima dhe zgjasin disa minuta. Breshëri është dukuri e përvitshme, madje ka mesatarisht 5-7 ditë me breshër në vit. Zakonisht bie në gjysmën e parë të pranverës.

Ndërkaq, treva është e hapur ndaj erërave të ngrohta e të lagështa që vijnë nga Jugu dhe Perëndimi. Më karakteristike janë Garbiu (Shiroku), Murlani (Murrëri) dhe Brizat (Maistrot).

Të vetmet pasuri natyrore që Himara i ka të kursyera janë ujërat dhe tokat. Ujërat vijnë nga burime nëntokësore karstike dhe më rrallë nga puse të hapura në shtresat zhavarore të depozituara nga përrrenjtë në pjesët e ulëta të këtyre viseve, sidomos përreth grykave të përrrenjve.

Burimet karstike të Himarës zakonisht janë të vogla, me prurje nga disa 1/sek. në disa dhjetëra 1/sek. Burimet më të mëdha karstike të trevës së Himarës janë ato që dalin në buzë të ujit (burime buzëdetare) dhe madje edhe nën ujë. Burimi më i madh buzëdetar është Potami, në skajin më Jugor të gjirit të Himarës, vetëm 30 m larg nga buza e ujit. Ka prurje rreth 120-150 1/sek. Uji i tij përdoret edhe sot për furnizimin e qytetit të Himarës me ujë të "pijshëm".

Burimet nëndetare, dalin brenda në det, duke krijuar vorbulla uji që dallohen nga bregu. Burime të tilla dalin edhe në gjirin e Portopalermos (Armeridhës) dhe të Lllamanit.

Për shkak të rezervave të pakta ujore, të thatësisirës tepër të zgjatur dhe të terrenit gëlqeror karstik, ku ujërat infiltrtojnë me shpejtësi në thellësi të tokës, burimet ujore shfrytëzohen me kujdes të madh nga banorët e zonës.

Toka bujqësore të vërteta ka vetëm në fushën e Qeparoit dhe në fushat karstike të Vunoit. Viset e tjera bujqësore janë në shpatet malore e kodrinore, ku shtresa e tokës është fare e hollë ose mungon fare, sepse shpëlahet nga ujërat rrjedhëse.

Bimësia dhe fauna e trevës së Himarës, në përputhje me klimën, tokat dhe faktorët e tjerë natyrorë, janë kryesisht të tipit mesdhetar. Shtrihen nga niveli i detit e deri në lartësitë më të mëdha. Bimësia tipike mesdhetare është e përhapur në një brez vertikal, që shtrihet nga niveli i detit dhe deri në lartësinë 700-800 m. Ky brez përbëhet nga shkurre mesdhetare, pëlqen terrenet gëlqerore dhe është i aftë t'i rezistojë periudhës së thatësisirës verore.

Në Himarë rritet edhe makja e vërtetë mesdhetare ose makja e përzier. Bimët më tipike të saj janë ato gjethebjatëse, si xina, koçimarija, mërsina, shqopa, dafina, oleandri, gjeshtria, qumështorja (dru rryelli), sherebela, cfaka etj. Në brezin e makjes futen dhe lloje drurësh pyjorë shumë të rëndësishëm për të gjithë bregun e Jonit, si valanidhi, ilqja etj.

Katin e sipërm e të fundit bimor e përbëjnë kullotat subalpine mesdhetare, që shtrihen në pjesët e larta të Vargut të Çikës. Kullota takohen dhe në ZM tek gadishulli i Kavadorit, Panormës dhe në zonat përreth.

Rajoni përfshin habitate bregdetare me shkurreta Termo-Mesdhetare dhe pre-desert, me prezencë të *Euphorbia dendroides*, me origjinë të spikatur Terciare Macaronesiane. Gjithashtu dhe specie detare të ndryshme me interes ruajtjeje si të Posidonias.

Fauna tokësore përfaqësohet: Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Lepuri i egër (*Lepus europaeus*), Nusja e lalës (*Mustela nivalis*), Breshka e tokës (*Testudo hermanni*), etj. Disa lloje reptilësh

si: *Coluber gemonensis*, *Elaphe longissima*, *Natrix natrix*, *N. tessellate*, *Lacerta trilineata*, *Anguis fragilis*, *Coluber jugularis*, *Elaphe longissima*, *Vipera ammodytes*, *Lacerta viridis* etj. Llojet më të zakonshëm të amfibëve janë: *Rana graeca* dhe *Rana balcanica*. Nga shpendët takohen: Pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibundus*), Dalëndydhja e detit (*Sterna sandvicensis*), Dallëndydhja e detit ballëbardhë (*S. albifrons*), Thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), Pëllumbi i egër (*Columbia livia*), etj.

Fauna detare përfaqësohet nga: Breshka e Detit (*Caretta caretta*), Delfini (*Delphinus delphis*), Foka mesdhetare (*Monachus monachus*) dhe një numër i konsiderueshëm peshqish, etj.

Në këtë rajon përfshihet zona e mbrojtur e përbërë kryesisht nga tri gjire kryesore: Llamani, Porto Palermo dhe Gravës /Panormit.

Peizazhi i Llamani në përgjithësi është i këndshëm, një gropë e kufizuar midis kodrash gëlqerore, të dala në formë kepi. Faqja Perëndimore e kodrës, në Veri, karakterizohet nga shpate gëlqerore të transformuar nga kushtet klimaterike dhe të mbuluar me shkurre e bimësi barishtore. Shpatet Lindore të plazhit janë të mbuluara me shkurret, pyllëzime me pishë dhe shkurre mesdhetare. Pranë qafës së Lerës janë edhe disa rënoja të ndërtesave ushtarake. Territorit në këtë pjesë të gadishullit është i mbuluar kryesisht me bimësi barishtore për kullotë.

Gjiri i Porto Palermos është i njohur që në kohët e lashta. Është i vendosur në ndërmjet Kepit të Kavadonit dhe Kepit të Panormës dhe në Lindje me rrugën automobilistike qafa Lerës-Qeparo.

Gjiri është me origjinë tektonike, i mbrojtur dhe ka patur një qasje shumë të kufizuar para viteve 1991, pasi ishte zonë ushtarake. Për këtë arsye, gjatë kësaj periudhe biodiversiteti detar-bregdetar mendohej të ketë qenë i pasur, edhe pse studimet kanë qënë shumë të kufizuara. Aktualisht, baza është përdorur për ankorim të Rojes Bregdetare dhe për anijet e peshkimit.

Mbetjet e ndryshkura nga pikat ushtarake ndotin disa pjesë të zonës. Ndërtimet e reja pranë rrugës bregdetare krijojnë pamjen e një zhvillimi të ngushtë të zonës.

Brenda gjirit gjendet një gadishull i vogël dhe tërheqës shkëmbor, i cili hyn rreth 300 metra në det. Këtu ndodhet dhe kalaja e ndërtuar nga Ali Pashë Tepelena, në fillimet e shekullit të 19-t, në një lartësi prej 28.2m, e rrethuar nga uji dhe bimësia e Rryellit (*Euphorbia dendroides*). Në vendin ku kalaja lidhet me tokën ndodhet kisha e Shën Nikollës, disa ndërtesa dhe një mol i vogël. Pika më e lartë e këtij gjiri është 123,8m, në afërsi të qafës së Lerës.

Kepi i Kavadorit përgjithësisht është i mbulura me bimësi barishtore. Në pjesën veriore të Gjirit janë rënojat e ndërtesave ushtarake dhe tuneli.

Në Jug të gjirit të Palermos gjendet gadishulli i Panormës. Përgjithësisht i mbuluar me bimësi barishtore dhe shkurre mesdhetare. Në pjesën Veriore të këtij gadishulli janë 3

qendra të rritjes së peshkut. Në gjiret e vegjël dhe pranë rrugës janë krijuar qendra pushimi (plazhe) me infrastrukturën pritëse për pushuesit e vizitorëve, si i Llamani, i Protopalermos, i Panoramës, i peshkatarëve dhe i Gravës.

Zona përreth është e varfër në bimësi tokësore, por gadishulli dhe pjesa Perëndimore është shumë e pjerrët dhe me peizazh mahnitës. Edhe në gjirin Jugor të gadishullit pranë rrugës vihen re tendecnat të ndërtimeve dhe krijimit të qendrave të plazheve.

Në pikën më të lartë të gadishullit m.Palermos (104.7m) janë të vendosura dhe antenat e komunikimit si dhe fari.

Rrjeti rrugor brenda zonës së mbrojtur përbëhet kryesisht nga një rrugë e vetme e asfaltuar si dhe disa shtigje apo rrugë të paasfaltuara. Rruga shtrihet afër bregdetit duke i dhënë pamje të bukur peizazhit.

Gjiri i Porto Palermos dhe i Llamani janë shumë tërheqës. Kanë vlerë ekologjike, skenike dhe pikë potenciale për turizëm, argëtim dhe sportet (eskursionë, ciklizëm, alpinizëm, fluturim me parashuta pa motor, kalërim, shikimin e zogjve, peshkim sportiv, not, zhytje, kanoe, vozitje me vela, motora-ujë, etj).

Peizazhi rreth gjirit të Palermos-Llamani, në pjesën Veriore, kufizohet nga k.Ullirit të Hollë, fshati Himarë (Potam). Në Lindje nga një territori mjaft i pjerrët dhe rruga automobilistike. Në Jug nga gadishulli i Palermos. Pika më e lartë është m.Gjumi 542,1m dhe m.Vrriut 547.0m, jashtë territorit të ZM. Gjithashtu, takohen q.Kukumit e q.Suqes dhe kuota 93.2m.

Përbërja floristike e kësaj bashkësie është e ndryshme dhe e larmishme. Shoqërimet me *Salvia fruticosa L.* janë një tjetër karakteristikë për këtë zonë. Ndërsa shoqërimet me formacionet e *Euphorbia dendroides* janë konsideruar më interesante për këtë fushë dhe afërsisht unike në Shqipëri. Pyjet e dominuara nga *Quercus ithaburensis subsp. Macrolepis*, i njohur si dushku i Vlorës, janë të pranishëm. Nuk formojnë brez të veçantë të pyjeve dhe mund të konsiderohet specie relikte që vijon mbi bregdetin e Jonit, që prej periudhës Terciare.

Në brigjet shkëmbore të zonës së Porto Palermos takohet bimësia xero-halophytic. Llojet më të zakonshme janë: *Crithmum maritimum*, *Limonium anfractum*, *Elymus pycnanthus*, *Desmazeria marina*, *Lotus cytisoides*, etj., të cilat përfaqësojnë bashkësitë endemike *Crithmo-Limonietum anfracti*.

Në zonën e Porto Palermos takohen edhe dy lloje bimësh invazive: *Agavia (Agave americana L.)* dhe *Arra e Hindit (Ailanthus altissima Mill.)*. Kësisoj kërcënim potencial për biodiversitetin detar janë edhe invazioni i specieve të *Caulerpa Racemosa var. cylindracea*, që është përhapur gjerësisht në zonën e Porto Palermos, si në të gjithë pellgun e Mesdheut, përfshirë dhe bregdetin shqiptar të detit Jon.

Barërat e detit janë të llojeve Magnoliophytes detare, që formojnë shtretërit nënujor, të cilat janë habitate të rëndësishme për ekosistemet detare. Në zonë janë të pranishme tre lloje bimësh: *Posidonia oceanica*, *Cymodocea nodosa* dhe *Halophila stipulacea*. *Posidonia oceanica* ose bari i detit është lloji më i bollshëm, që formon livadhe të mëdha në thellësi të cekët dhe të mesme.

Në zonën e Porto Palermos është gjetur një diversitet i madh peshkor, por ato më të zakonshmet janë: *Chelon sp.*, *Mullus surmulletus*, *Diplodus sp.*, *Coris juli*, *Serranus cabrilla*, *Oblada sp.*, *Chromis sp.*, etj.

Përdorimi i Porto Palermos dhe zonës përreth për kullotjen e bagëtive është krejtësisht i pakontrolluar, shpesh ka prekur ndjeshëm habitatet. Kullotja dhe zjarret janë kërcënime të ndjeshëm e potencial për habitatet, speciet në rrezik dhe peizazhin.

Rajoni i Himarës ka një shumëllojshmëri të atraksioneve turistike (trashëgimisë kulturore, burimeve natyrore, peizazheve, traditave dhe ushqimit), që i japin mundësi për të zhvilluar forma të ndryshme të turizmit duke e integruar me pjesët e tjera të rajonit. Prania e zonave rurale, zonave të mbrojtura me biodiversitet të pasur, kryesisht bregdetar-detar, malor, kodrinor, fushor, kepe, gryka e delta, shpella, peizazh nënujor e bën një destinacion ideal për ekoturizmin dhe turizmin rural.

2. Vlerat

Hapësira bregdetare-detare përfshinë vlera të veçanta natyrore dhe ekuilibrin e përsosur ekologjik të nivelit kombëtar e ndërkombëtar. Përfaqëson një nga rajonet më të rëndësishme, më me perspektivë për zhvillimin social-ekonomik në përgjithësi dhe të turizmit në veçanti. Simboli i zonës së mbrojtur Gjiri i Porto Palermos-Llamani është: Deti-Natyrë-Kultura

Në zonën e mbrojtur vlerat konsistojnë:

1. Është pjesa më interesante dhe e merituar e emrit të Rivierës shqiptare.
2. Përfaqëson peizazhin më piktoresk, mahnitës dhe të individualitetit natyror. Reliev të larmishëm të përbërë nga katër kepe, tre gjire, me hapësirë të kaltër detare-bregdetare dhe mjedisin natyror për rreth përherë të blerët, me plazhe e burimet me ujëra të ftohta dhe të kristalta.
3. Pasuria e biodiversitetit bregdetar, detar dhe nënujor, habitate dhe specie janë të rralla e të kërcënuara. Shoqërimet me Rryell (*Euphorbia dendroides*) konsiderohen interesante dhe afërsisht unike në Shqipëri. Pyjet e dominuara nga Valanidhi (*Quercus ithaburensis subsp. Macrolepis*), mund të konsiderohet specie relike e bregdetit të Jonit, që prej periudhës Terciare.
4. Biodiversiteti nënujor shquhet për llojshmërinë e specieve të kërcënuara si *Posidonia oceanica*, *Cymodocea nodosa* dhe *Halophila stipulacea*. Po kështu dhe për llojshmërinë e peshqeve, delfinëve, fokave, breshkave të detit, butakave, iriqëve detar, koraleve etj.

5. Një vend unik ku kombinohet eko-turizmi dhe turizmi detar, veçanërisht nënujor. Pikë potenciale për argëtim dhe sportet ujore e malore (eskursionë, ciklizëm, alpinizëm, fluturim me parashuta pamotor, kalërim, shikimin e zogjve, peshkim sportiv, not, zhytje, kanoe, vozitje me vela, motora-ujë, etj), krijon kushtet për kampig me çadra, etj.
6. Klima mesdhetare e ndërthurur me peizazhin tokësor, bregdetar-detar e nëndetar, me vegjetacion të përhershëm dhe plazhet, janë të përshtatshëm si potenciale biokurativ (klimatik, hidrik) për qëllime shëndetësore.
7. Zonë për zhvillim të përgjithshëm social-ekonomik (blegtori, peshkim, kullotë, agrume, pemtari, përpunim të prodhimeve bujqësore e blegtorale, agroturizëm dhe ekoturizëm). Në zonat përreth mundësi të burimeve për prodhim të energjisë së rinovueshme.
8. Është pjesë e një treve me histori të lashtë, me trashëgimi historike e kulturore të veçantë. Ndërtime karakteristike të lashta dhe të kultit si Kisha e Shën Nikollës, Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, baza ushtarake e Porto Palermos (e cila në të ardhmen mund të kthehet në muze), me arkeologji të pasur nënujore etj.
9. Bukuritë e natyrës dhe shpirti i njerëzve janë pasqyruar edhe në botën e veçantë shpirtërore, të folklorit, këngët polifonike të rralla, vallet, veshjet, traditat popullore etj, vlera që e bëjnë më tërheqëse për turistët e huaj dhe vendas.
10. Zona ka vlera të mëdha për kërkimet shkencore dhe monitorim.

3. Kërcënimet kryesore

Zona e mbrojtur është një qendër e jashtëzakonshme e diversitetit të specieve dhe habitateve, por edhe një nga më të kërcënuarët. Veprimtaria e pakontrolluar njerëzore, për dekada të tëra rradhazi, ka shkaktuar një stres të fuqishëm të zonës, i cili ka patur një ndikim të shoqëruar me dëme të mëdha me natyrë të theksuar demografike dhe ekologjike.

Intensiteti i këtyre ndikimeve përcaktohet ndjeshëm nga faktorë social-ekonomike të tillë si rritja e popullsisë apo shpopullimit të zonave rurale, bujqësia, blegtoria dhe praktikat jo të mira të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

Ekosistemet bregdetare-detare shqiptare janë nën presion të konsiderueshëm. Risqet janë të lidhura me vlerën e brendshme të tyre, por edhe me humbjen e biodiversitetit, specieve dhe habitateve natyrore, të cilat luajnë në rol kryesor në shëndetin e njerëzve, stilin e jetës, prodhimin e ushqimit dhe disponueshmërinë e burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik dhe mirëqënien e komunitetit.

Rreziqet kryesore të zonës së mbrojtur dhe rreth saj, konsistojnë:

- Zhvillimi intensiv i rajonit bregdetar-detar;
- lëvizja e popullsisë dhe shpërndarja jo uniforme e saj;

- humbja dhe fragmentimi i habitateve, përkeqësimi i gjendjes së specieve vulnerabel apo të rrezikuara, shkatërrimi i vegjetacionit dhe kullotave nga zjarret;
- futjen e specieve jo indigjene/vendase, të specieve gjenetikisht të modifikuara, si dhe futjen apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë;
- dëmtimi i livadheve të posidonias nga peshkimi, marinë-kultura, anijet, spirancat, ndotja dhe hedhja e mbeturinave të çfarëdo lloji;
- urbanizimi bregdetar-detar, ndërtimet dhe veprimtaritë social dhe ekonomike të pakontrolluara apo dhe ndërtimi i moleve të ankorimit jahteve;
- mbeturinat e ngurta, të ujërave të zeza dhe të ujërave të patrajtura;
- ndotja nga shkarkimet e anijeve, derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura;
- hedhja e inerteve dhe veprimtaritë e zhvilluara në bregdet dhe tokë;
- hedhja e mbetjeve ose lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse, të plehrave e pesticideve;
- veprimtaritë ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, të shtratit apo nëntokës së detit;
- hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lëndeje nga anijet, instalimet dhe nga bregdeti;
- fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi dhe mbeturinat të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit;
- paqartësia në titullin e pronësisë;
- përqendrimi i investimeve turistike në bregdet-det;
- mbishfrytëzimi dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i rezervave natyrore (peshkim, kullotë, bimë mjekësore, etj);
- shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë gjuetinë ilegale të tyre, mbipeshkimi dhe përdorimi i mjeteve e metodave të ndaluara janë të prekshme në zonën e mbrojtur dhe rreth saj;
- prania e marinë-kulturës, përdorimi i ushqimit, antibiotikëve dhe akumulimi i eskrementeve nga peshqit, ushtron njëtrysni të lokalizuar dhe relativisht të fortë në mjedis dhe kontribuonë në ndotjen dhe uljen e cilësisë së ujit.

Zona e mbrojtur dhe ndjeshmëria e burimeve të saj natyrore dhe kulturore ndikohet në pjesën më të madhe edhe nga lehtësia e mundësisë së hyrjes për të realizuar veprimtari të paligjshme, prania e një infrastrukture të favorshme, kërkesa e fortë e biznesit për burimet natyrore e ndërtime dhe të pamundësisë për të kontrolluar territorin.

4. Vizioni dhe objektivat për ZMBD

Zona e mbrojtur bregdetare-detare (ZMBD) krijohet për të ruajtur larminë biologjike, ekosistemet bregdetare-detare të përfshira, speciet, peizazhin tokësor,

detar, bregdetar e nënujor dhe mirëadministrimin e funksioneve dhe të shërbimet e tyre.

Zona e mbrojtur do të sigurojë burime për kushte të qëndrueshme jetese për popullsinë, të palëve të interesuara dhe për brezat e ardhshëm.

Zona e mbrojtur do të mirëmenaxhohet me pjesëmarrjen e qeverisjes lokale, me përfshihen grupet vendore të interesit në mënyrë që të kontribuojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të natyrore dhe të peizazhit, duke siguruar ekuilibrin ndërmjet ruajtjes së ekosistemeve bregdetare-detare dhe zhvillimit të veprimtarive njerëzore.

Prioriteti i zonës së mbrojtur është të sigurojë mirëmbajtjen dhe konservimin:

- a. e tipeve përfaqësuese të ekosistemeve detare dhe bregdetare me përmasa të përshtatshme dhe të pranueshme për të siguruar mbijetesën afatgjatë të tyre dhe të ruajtë shumëllojshmërinë biologjike të tyre;
- b. e habitateve që janë në rrezik për t'u zhdukur në zonat e shpërndarjes natyrore të tyre apo që kanë një zonë natyrore shpërndarjeje të reduktuar si pasojë e regresit të tyre ose për arsye të zonave të kufizuara të tyre;
- c. e habitateve kritike për të garantuar mbijetesën, riprodhimin dhe përtëritjen e specieve endemike, të rrezikuara dhe të kërcënuara të florës e faunës;
- d. e zonave me rëndësi të veçantë për interesa shkencore, estetike, kulturore, dhe edukative;
- e. e sigurimit të cilësisë së ujërave, ruajtja e proceseve të veçanta natyrore dhe biologjike dhe e sistemeve mbështetëse të jetesës.

Ruajtja dhe menaxhimi i përdorimit të zonës për qëllime çlodhëse, argëtuese, sportive, ekoturistike dhe kulturore, të lidhura me bashkëfunksionimin e objektivave të ruajtjes së natyrës e peizazhit me zhvillimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive ekoturistike.

Zhvillimi i veprimtarive të qëndrueshme social-ekonomike për fitimeve ekonomike dhe mundësi të përfitimeve të barabarta sociale brenda zonës së mbrojtur. Përmirësimi i shërbimeve të qëndrueshme të ekosistemit, nëpërmjet mekanizmave financiare që mund të rritin finacimet për rimëkëmbjen e natyrës dhe të shërbimeve që lidhen me të.

Promovimi i vlerave të natyrës, biodiversitetit, historike e kulturore të zonës së mbrojtur dhe kërkimi shkencor, nëpërmjet komunikimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit.

5. Zonimi dhe menaxhimi

Zona e mbrojtur "Gjiri i Poto Palermos-Llamani" nuk ka plan menaxhimi. Për rrjedhojë nuk mund të bëhet një vlerësim mbi zonimin, por shtjellohen disa konsiderata për t'i patur parasysh në zonimin e territorit që do të propozhet për këtë zonë e mbrojtur.

Në procesin e mirëmenaxhimit të zonës së mbrojtura dhe arrijten e objektivave në përputhje me vlerat e biodiversitetit, të habitateve e specieve të kërcënuara apo të rrezikuara, të peizazhit unik, monumenteve të natyrës e kulturore etj, shpesh nevojitet edhe ndarja e sipërfaqes në nënzona menaxhimi, ku trajtimi i tyre bëhet në mënyrë të pavarur, por të integruar në gjithë procesin e menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Zonimi është funksion i objektivave të planit të menaxhimit me pjesëmarrje dhe si i tillë mund të ndryshohet në varësi të situatës dhe planit dhjetë vjeçar të menaxhimit.

Zonimi i sipërfaqes është një formë e përdorimit të tokës dhe e ujërave (bujqësore, pyjore, kullimore, ujore, bregdetare-detare, joprodhuese, urbane-troje, etj) që përfshin ndarjen e një sipërfaqejeje apo të truallit përreth në një numur nën-njësish menaxhuese (në nënzona), që paraqiten në hartë. Kështu bëhet rregullimi publik e privat i karakterit dhe i intensitetit të përdorimit të tyre, në përputhje me ruajtjen e vlerave ekologjike, të biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm e të balancuar.

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe ujërave, është procesi i caktimit në mënyrë të qartë i përdorimeve ose funksioneve për zonën e mbrojtur, i burimeve bio-natyrore dhe i vlerave shpirtërore, historike, kulturore dhe arkeologjike. Rregullimi i përdorimit të qëndrueshëm të tyre pa shkakuar tjetërsim të mjedisit fizik, biologjik, ekonomik, social, kulturor dhe të një uljeje të papranueshme të cilësisë së shërbimeve të ekosistemit.

Objektivat përcaktohen për secilën nënzona menaxhimi. Brenda çdo nënzona jepen dhe përshkrimet menaxhuese në mënyrë të arsyeshme, uniforme dhe diferencohen në tipe ose intensitet nga nënzonat e tjera. Një sistem nënzonimi mundet gjithashtu të përdoret për të informuar gjithë pjesët e përfshira rreth qëllimeve të menaxhimit. Planifikimi hapësinor, përfshin nivelet urbane (instrumentat e planifikimit urban) në kontekstin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Shpesh ZM ka nevojë të mbrohet edhe nga faktorët dëmtes që e kanë origjinën nga jashtë saj, që çojnë në organizimin e një nënzona buferike përreth ZM. Nëse një “nënzona buferike” nuk është e mundur, atëherë një pjesë kufizuese e vetë ZM do të luajnë rolin e nënzona buferike, duke u bërë pjesë integrale e saj.

Ndryshimet e ligjit “Për zonat e mbrojtura” krijojnë mundësinë që zonimi i sipërfaqes së një zone të mbrojtur, veç atyre të cituara, mund të përmbajë edhe nënzona të tjera që i përshtaten territorit dhe qëllimeve për të cilat menaxhohen. Studimi dhe krijimi i çdo nënzona është një proces shumë delikat, i ndjeshëm për të mos dorëzuar pozicione ose mbrojtur pozicione që janë të pambrojtshme apo të pamundura për t’u zbatuar realisht në terren. Procesi i zonimit është dinamik, konsensual dhe jo i pandryshueshëm

Në përgjithësi procesi i zonimit të sipërfaqes së zonës të mbrojtur Gjiri i Poto Palermos-Llamani duhet orientuar në:

- Forcimin e zbatimit të kërkesave të dispozitave ligjore në fuqi;
- ruajtjen e elementeve të ndjeshëm ekologjik bregdetar-detar nga shqetësimi dhe keqpërdorimi për interesa publike e private;
- ndarjen e përdorimeve të papajtueshme nga njeri-tjetri dhe dhënien përparësi të përdorimeve apo qëllimeve specifike në nënzona të ndryshme;
- ndalimin e shkarkimit apo hedhjes së mbetjeve apo substancave të tjera që mund të dëmtojnë direkt ose tërthorazi integritetin e zonës së mbrojtur;
- respektin për mjediset natyrore, detar-bregdetar e nëndetar, duke synuar zhvillimin në një mënyrë të padëmshme e të qëndrueshme të tyre, përfshi vlerat ekologjike, historike, kulturore, shpirtërore dhe arkeologjike;
- konservimin/ruajtjen e ekosistemit, speciet dhe habitatet natyrore të tyre, me vlerë me anë të zonimit të hapësirës, me një ndalim të përgjithshëm zhvillimi pa lejuar cënimin e tyre, por duke lejuar vetëm proceset natyrore;
- rregullimin ose ndalimin e çdo veprimtarie ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij;
- ruajtjen e kepeve, gjireve, gadishujve, dhe të shpateve të pjerrëta, me një ndalim të përgjithshëm zhvillimi, bazuar në tërësinë e karakteristikave gjeomorfologjike në një nëzonë që shtrihet jo më afër së 20-300 m nga bregu apo i çdo karakteristike gjeomorfologjike aktive;
- krijimin e korridoreve të veçanta panoramike të peizazhit, duke synuar ruajtjen e cilësisë dhe karakteristikat nga pika të favorshme vështrimi, përfshirë të gjitha pamjet në drejtim të detit, malit, gjireve, kepeve, shpateve, grykave, etj, si nga rrugët lokale, kombëtare ato në brendësi të territorit apo duke krijuar dhe vende të posaçme të preferuar nga vizitorët dhe turistët;
- rregullimin e kalimit, ndalimit apo të ankorimit të anijeve, skafeve dhe mjeteve të peshkimit;
- identifikimi dhe marketimi i nënzona kulturore, historike, arkeologjike dhe monumentet e rëndësishme me vlerë të pazëvendësueshme. Zhvillimi i tyre bazuar në udhëzimet shoqëruese të institucioneve përgjegjëse të planifikimit të territorit;
- përcaktimi i ndalimit të veprimtarive me ndikim të ndjeshëm në mjedis. Nënzona ku do të lejohen këto veprimtari pas marrjes së lejes mjedisore.

6. Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit

Menaxhimi i efektshëm është një gjykim shumë-disiplinor, i cili përfshin çështje të biofizikës, gjendjes social-ekonomike dhe të qeverisjes. Në përgjithësi, nevojiten disa tregues të ndryshëm për të përcaktuar nëse po plotësohen qëllimet dhe objektivat. Programet afatgjata të monitorimit, që përdorin tregues të përshtatshëm janë të nevojshme për

të përcaktuar nëse veprimet zbatuese janë duke u zbatuar, sikurse përshkruhet në planin e menaxhimit dhe nëse po realizohen qëllimet (rezultatet e ruajtjes). Duhet monitoruar gjithashtu edhe shëndeti i ekosistemeve dhe biodiversitetit si dhe mirëqenia e komuniteteve vendase.

Pas përcaktimit të qëllimit të përgjithshëm të programit të Monitorim-Vlerësimit, duhen identifikuar qëllimet dhe objektivat; përcaktuar niveli dhe gama e të dhënave bazë; zgjedhur treguesit për çdo qëllim dhe objektiv; dhe rishikuar e renditur treguesit sipas prioritetit.

Po kështu, duhen identifikuar dhe hartuar metodat e monitorimit; vlerësuar nevojat për burime për të zbatuar programin e monitorimit; përcaktuar një plan i përgjithshëm dhe afatet kohore të monitorimit dhe vlerësimit.

Gjithashtu, duhet përcaktuar procesi për vlerësimin dhe përgjigjen ndaj rezultateve të programit të monitorimit. Përgjigjet e përshtatura të menaxhimit janë një mjet për të korrigjuar strategjitë apo veprimet specifike të menaxhimit që janë gjetur jo të efektshme. Në këtë mënyrë do të realizohen objektivat e menaxhimit.



Ekosistemet mesdhetare zënë vetëm 1,2% të sipërfaqes së tokës dhe kanë kufij të qartë gjeografik. Ekosistemet tokësore dhe detare të Shqipërisë janë pjesë e zinxhirit Mesdhetar të ekosistemeve natyrore. Rajoni bregdetar dhe detar i Shqipërisë është një prej zonave të nxehta të biodiversitetit në Detin Mesdhe, madje një pjesë e konsiderueshme e ekosistemeve ruhen në gjendje gati natyrore.

Ky rajon karakterizohet nga një shumëllojshmëri e konsiderueshme habitatesh, të specieve të florës e faunës, të një rëndësie të veçantë kombëtare e rajonale. Një numër i madh specimesh janë të pranishme në listën e specieve të rralla. Disa dallohen për interesin e tyre specifik shkencor, ndërkohë që shumë nga to kanë edhe një vlerë të veçantë ekonomike, mjekësore, industriale, dekorative, etj.

Rajoni është i lokalizuar në kufijtë e nën-rajoneve: pjesa Perëndimore dhe Lindore e detit Mesdhe dhe Adriatik. Bregdeti Jugor është shumë i rëndësishëm për biodiversitetin detar, pasi flora dhe fauna përfshijnë specie me origjinë të ndryshme. Njëherazi habitati detar më i rëndësishëm dhe i mbrojtur Mesdhetar, është *Posidonia oceanica*.

Bregdeti dhe deti shqiptar ka panorama të spikatura, pamje mahnitëse që mbizotërojnë Rivierën shqiptare. Përbëjnë një nga zonat më të bukura që tërheqin vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj. Arsyeja e shumicës së turistëve për të zgjedhur këtë bregdet, si destinacion turistik, lidhet drejtpërdrejt me mjedisin natyror dhe peizazhin.

Prania e një trashëgimie të shumëllojshme tradicionale dhe kulturore, rrit në mënyrë të konsiderueshme sensin atraktiv. Lejon që të zgjerohet dhe të jap shumëllojshmëri potencialit turistik, duke dhënë një gamë të gjerë mundësish për zhvillimin e ekonomik, burim të ardhurash dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.

Trashëgimia kulturore përbëhet nga arkeologjia (periudha prehistorike, Ilire, Helene, Bizanti, pushtimi Osman), të cilat shtojnë mundësitë për zhvillimin e turizmit kulturor. Po kështu, arkitektura tradicionale e fshatrave e bën bregdetin shumë atraktiv.

Mjedisi bregdetar e detar përbën burime të vlerave të larta ekonomike, sociale dhe ekologjike për vendin. Konsiderohet burimi më i madh mbi të cilin varet zhvillimi i ardhshëm i vendit.

Në vitet e fundit, trysnia nga turizmi, zhvillimi i zonave të banimit, masat ligjore të papërshtatshme dhe zbatim i dobët, kanë patur ndikim të ashpër në mjedisin

detar e bregdetar të këtij rajoni. Si rrjedhojë e menaxhimit të paqëndrueshëm të këtyre burimeve, sasi të konsiderueshme të mbeturinave vrehen të hedhura në mënyrë të paligjshme përgjatë rrugëve bregdetare ose janë zbratur në det. Burimet më të mëdha të ndotësve janë derdhjet direkte ose indirekte të ujërave të zeza të patrajtuara.

Sistemi i Zonave të Mbrojtura Detare e Bregdetare (ZMDB), diversiteti i ekosistemeve dhe habitateve detare dhe bregdetare, ende nuk janë përfaqësues. Pavarësisht se zonat detare-bregdetare në Shqipëri janë gjithashtu pika të nxehta të biodiversitetit në Detin Mesdhe, ka edhe mungesë të thellë informacioni mbi statusin e ruajtjes së specieve kryesore dhe të habitateve të tyre.

Mjaft zona detare-bregdetare, me në një gjatësi të përgjithshme prej 430 km (përgjatë detit Adriatik dhe Jonian), janë ende të pambrojtura, me gjithë rolin e tyre thelbësor ekologjik dhe social-ekonomik në nivel kombëtar, lokal apo dhe të Mesdheut.

Përpos kësaj, brezi bregdetar përbën terrenin më vulnerabel përsa i përket presionit që ushtrohet nga zhvillimi, por menaxhimi kësaj zone mbetet ende një sfida për vendin tonë. Është detyrë dhe përgjegjësi, kryesisht e organeve në nivel qendror dhe e njësive të qeverisjes vendore, por edhe e shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, individëve dhe pronarëve, që të dinë si t'i përdorin, t'i ruajnë dhe zhvillojnë, në mënyrë qëndrueshme, këto potenciale të zonës detare-bregdetare.

1. Përshkrimi i përpunimit të Planit të Menaxhimit (PIM)

Ministria e Mjedisit dhe përfaqësues të RAC/SPA (UNEP/MAP), në Maj 2012, dakordsuan zhvillimin në Shqipëri të Projektit pilot MedMPAnet në kuadër të Projektit Rajonal për Zhvillimin e një Rrjeti Mesdhetar për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare, mbeshtetur nga RAC/SPA (Qendra e Aktiviteteve Rajonale për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura). Në lidhje me këtë, në mënyrë që të ndihmojë për një koordinim të ngushtë, zbatim normal të projektit, në nivel kombëtar e lokal, bazuar dhe në një proces të përbashkët të përzgjedhjes së rajonit për t'u zhvilluar si ZMDB në Shqipëri, u caktua Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).

INCA koordinoi zbatimin e projektit “Mbështetje për planifikimin, zonimin dhe zhvillimin e Zonës së Mbrojtur Detare në Gjirin e Porto Palermos (Shqipëri), bazuar në njohuri të shëndosha shkencore dhe social-ekonomike”, në konsultim të ngushtë me të gjithë palët e interesuara, veçanërisht me komunitetin lokal, duke patur parasysh dhe rolin e tyre në zhvillimin e zonës.

Ky Plan Menaxhimi (PIM) mbulon Zonën e Mbrojtur (ZM) Gjiri i Porto Palermos-Llamani. Procesi i hartimit të tij është zhvilluar me pjesëmarrjen e aktorëve të nivelit qendror dhe vendor, për të garantuar pronësinë, mbështetjen e përbashkët të vizionit, synimeve, objektivave, politikave dhe veprimeve që identifikohen në plan. Plani është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me banorët e zonës, bizneset lokale dhe grupet e tjerë të interesuar, duke u përpjekur që të jetë një proces gjithëpërfshirës në vendimmarrjet përkatëse.

Janë zhvilluar disa seminare dhe konsultime me Drejtorinë e Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura, pranë MM, me përfaqësues të Këshillit të Qarkut, Bashkisë Himarë, institucionet shtetërore lokale, banorët, OJF-t dhe me grupe të tjera të biznesit në këtë zonë për të hartuar PIM. Në këto seminare, pjesëmarrësit identifikuan çështje të rëndësishme të planit dhe parashikuan rezultatet e mundshme që lidhen me këto çështje.

Në zonë janë zhvilluar edhe ekspedita në bashkëpunim me specialistët vendas. Synimi kryesor i këtyre veprimtarive ishte të siguroheshin vëzhgime dhe këndvështrimet e vendasve, nëpërmjet mbledhjes së informacionit në zonë, situatës aktuale, pengesave dhe sfidave. Po kështu, të identifikoheshin trysnitë, kërcënimet, mundësitë dhe vizionet për ruajtjen e natyrës unike detare-bregdetare të rajonit Jugor, veçanërisht:

- a. peizazhet natyrore-konturet e tokës dhe biodiversitetit;
- b. peizazhet kulturore-ngulimet, ndërtesat tradicionale dhe vlera të tjera trashëgimie, bashkë me prodhimet e zakonshme të pemëtarisë, agrumeve, ullinjëve dhe të degëve të tjera të bujqësisë, blegtorisë e peshkimit, të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë në funksion të formulimit të objektivave menaxhuese të preferuar të zhvillimit të qëndrueshëm e të balancuar sociale dhe ekonomike.

Për hartimin e këtij plani janë marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e përcaktuara në:

1. “Përmirësimi i Efektivitetit të Mbulimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare”(PEMMZMDB), me objektiv: “Sigurimin e mbrojtjes së biodiversitetit unik bregdetar dhe detar të Shqipërisë për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm”, mbështetur nga Qeveria Shqiptare, GEF dhe UNDP.
2. “Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare e Bregdetare (PSZMDB)”, përgatitur me mbështetjen e UNDP, në kuadër të projektit “Shtimi i sipërfaqes dhe përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura detare e bregdetare”.
3. “Projekti Rajonal për Zhvillimin Detar të Mesdheut dhe Rrjetit të Zonave të Mbrojtura Bregdetare (ZMB) përmes nxitjes së Krijimit dhe Menaxhimit të ZMB-ve («Projekti MedMPAnet»).

4. “Studimi ekologjik i Gjirit të Porto Palermos dhe zonave përreth”².
5. “Analiza socio-ekonomike dhe studimi mbi zhvillimin e turizmit”.

2. Përshkrimi i strukturës së planit të menaxhimit

Hartimi i planit është bazuar në “Struktura Standarde për Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur në Shqipëri”³.

Kësisoj, plani mbështet planifikimin, zonimin dhe zhvillimin e zonës së mbrojtur detare-bregdetare, në Gjirin e Porto Palermos-Llamani, mbi njohuritë e shëndosha shkencore dhe social-ekonomike. Gjithashtu, synon zbatimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së aktorëve për menaxhimin dhe planifikimin e kësaj zone të mbrojtur dhe të qëndrueshmërisë financiare.

Plani i Menaxhimit është e ndarë në 7 pjesë:

- Në Pjesën 1 përshkruhet vendndodhja administrative, njësia e qeverisjes vendore dhe kufiri i ZM; Statusi ligjor i ZM, duke përfshirë kategorinë kombëtare të ZM dhe kategorinë e Bashkimi Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës (IUCN) për ZM; Politikat dhe legjislacionet përkatës (kombëtar dhe ndërkombëtar), duke përfshirë masterplanet, planet lokale të zhvillimit, planet e zhvillimit të turizmit, planet e pyjeve, ujërave etj. Përshkrim i shkurtër i kufizimeve kryesore për menaxhimin e ZM; Strukturimi institucional: Rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesuara; Përshkrim i sistemit natyror të ZM (duke përfshirë arsyet origjinale për krijimin e ZM, ekosistemet kryesore të zonës dhe strukturën e tyre (komponente/procese ekologjike dhe lidhjet ndërmjet tyre); Përshkrimi i sistemit social-ekonomik, përfshirë zotërimin e tokës; Struktura qeverisëse aktuale dhe ajo e parashikuar si dhe Përshkrimi i peizazhit kulturor dhe trashëgimisë.
- Në Pjesën 2 bëhet vlerësimi i zonës së mbrojtur dhe i kuadrit aktual. Vlerësimi i vlerave (ekologjike, social-ekonomike dhe kulturore) ; Vlerësimi i kornizës institucionale; Vlerësimi i kërcënimeve, duke bërë një përmbledhje të implikimeve kryesore që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të zonës së mbrojtur, cilësitë e vaçanta dhe komunitetet.
- Në Pjesën 3 Menaxhimi i zonës së mbrojtur, prezantohet vizioni, programet dhe objektivat afatgjatë dhe masat vepruese të planit. Po kështu, përshkruhen disa parime dhe veprime të menaxhimit të cilat në mënyrë gjithëpërfshirëse konsistojnë në mbarëvajtjen e veprimtarive të ndryshme të menaxhimit në zonën e mbrojtur; në parimet thelbësore të përfshirjes së komunitetet vendor, të vendimmarrjes dhe komunikimit transparent; përfshirë përshkrimi i monitorimit sasior të veprimit, në bazë të treguesve të përzgjedhur për secilin komponent të sistemit (përfshin burimet ekologjike, social-ekonomike, burimet ujore, etj).

⁽²⁾ “Mbështetje për planifikimin, zonimin dhe zhvillimin e Zonës së Mbrojtur Detare në Gjirin e Porto Palermos (Shqipëri), bazuar në njohuri të shëndosha shkencore dhe socio-ekonomike”.

⁽³⁾ Miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr. 148, datë 21.02.2013.

- Në Pjesën 4 pasqyrohet plani financiar i bazuar në veprimet e menaxhimit, në llogaritjen e nevojave financiare dhe të burimeve njerëzore.
- Në Pjesën 5 jepet kuadri i monitorimit dhe vlerësimit të menaxhimit, për realizimin e rezultateve të përshkruara, sipas prioriteteve të veprimit të paraqitura në Planin e Veprimit të Menaxhimit.
- Në Pjesën 6 jepen referencat bibliografike.
- Në Pjesën 7 pasqyrohen shtojcat, hartat, tabelat, grafikët dhe të dhënat gjeografike.

3. Kujt i drejtohet plani ?

Ministria e Mjedisit ka përgjegjësinë ligjore, sipas neni 15 të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, të udhëheqë dhe të hartojë për secilën zonë të mbrojtur plane menaxhimi. Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur doemos duhet të përfshihet në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë qeveritare, që lidhen me to, dhe në vendimmarrjet në nivele kombëtare, rajonale dhe vendore.

Siç është pranuar, një nga praktikatat më efektive për mirëmenaxhimin e zonave të mbrojtura, krahas rregullimeve ligjore, si pjesë e sistemit të menaxhimit, mbetet hartimi dhe zbatimi praktikë i planit të menaxhimit. Plani i menaxhimit orienton dhe ndrejton të gjitha veprimet dhe burimet brenda kufijve të zonës së mbrojtur, por dhe rreth saj, në përputhje e mbështetje të statusit dhe objektivave të ruajtjes.

Praktikat më të mira të menaxhimit, legjislatoni, politikat dhe udhëzimet ndërkombëtare, kërkojnë përgatitjen e planit të menaxhimit. Plani duhet të ndihmojë, të drejtojë autoritetet shtetërore qendrore e lokale, administratën e zonës së mbrojtur (AdZM), shoqërinë civile e OJF, komunitetin e biznesit, grupet e peshkimit artizanal dhe banorët lokal, për një menaxhim të dëshiruar dhe afat-gjatë të përdorimit dhe realizimit të objektivave të caktuara, në kuadër të veprimeve shumë qëllimëshme dhe të përbashkëta. Plani i menaxhimit gjykon mirëpërdorimin e territorit jo vetëm bazuar në aspektet ekologjike, por dhe tek potencialet ekonomike që ka për të kompensuar sakrificat e bëra në drejtim të kushtëzimit të përdorimit të territorit.

Plani i menaxhimit dhe programet e mbrojtjes zbatohen nga administrata e ruajtjes së zonës. Për të ndjekur hartimin dhe zbatimin e tij duhet të krijohet edhe Komiteti i Menaxhimit (KoM). Kësisoj, personeli i zonës së mbrojtur dhe komuniteti duhet të kenë një qasje tjetër kundrejt natyrës dhe vizitorëve, lidhur me shkallën e njohurive, mënyrat e komunikimit, të demonstrimit, të funksioneve dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre.

Plani i menaxhimit nuk mund të jetë pronë vetëm e Ministrisë së Mjedisit, por e të gjithë aktorëve ku përfshihet zona e mbrojtur. Suksesi i PIM varet nga ndërveprimi bashkëpunues i të gjithë aktorëve që janë palë për zonën e mbrojtur, të cilët janë njëhërazi përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e politikave në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

Ç’është më e rëndësishme, jo vetëm nga strukturat e MM, por edhe palët e tjera të interesuara duhet që PIM t’a konsiderojnë instrument të rëndësishëm pune, udhëzues për zonën e mbrojtur, t’i vihet në dispozicion publikut, të jetë i hapur për të gjithë grupet kryesore të interesit dhe përdoruesit brenda territorit dhe pranë zonës së mbrojtur. Plani shërben edhe për planifikimin vjetor të punës së administratës së ZM dhe të analizave të KoM.

4. Qëllimi i planit

Plani i Menaxhimit është dokumenti i vetëm më i rëndësishëm për zonën e mbrojtur dhe për të gjithë ata që do t’a përdorin atë. Ai udhëzon përdoruesit për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe ekologjike zonat me vlera të veçanta natyrore dhe kulturore, nëpërmjet krijimit të Zonës së Mbrojtur.

Plani bashkërendon dhe ndërthur veprimet që ndikojnë në qëllimet e zonës së mbrojtur. Nuk mund të merret asnjë vendim që ndikon të ardhmen e zonës së mbrojtur pa iu referuar Planit të Menaxhimit apo që bien ndesh me objektivat, veprimet e parashikuar për konservimin e natyrës, të biodiversitetit, të përdorimit të mençur të të gjitha burimeve natyrore, të peizazhit nga komuniteti dhe bizneset.

Plani përcakton vizionin, specifikon programet, objektivat, veprimet dhe rezultatet për dhjetë vitet e ardhshme. Ky plan përmban një kuadër të politikave planifikuese për menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe biodiversitetin, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e veçorive ekologjike të zones. Ndërkohë nxit përmirësimin e kushteve sociale, nëpërmjet veprimtarive të përdorimit të qëndrueshëm të tokës, ujërave dhe veprimtarive të treta të lidhura me to, si turizmi. Përcaktohen veprimet menaxhuese për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar speciet e kërcënuara ose të rrezikuara të florës dhe faunës së egër, nga pikëpamja shkencore. Nëpërmjet këtyre veprimeve identifikohen dhe inventarët e komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike bregdetare e detare, që konsiderohen të rëndësishëm për konservimin, përdorimin e qëndrueshëm, integrimin e tyre në sektorët përkatës dhe në politikat ndërsektoriale.

Plani promovon zbatimin e koordinuar, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre veprimtarive së bashku përmes rrjetit të gjerë të partnerëve dhe grupeve të interesit. Në thelb, krijon një kuadër për menaxhimin e ZM, duke orientuar vendimmarrjen dhe përcaktuar prioritetet e aktorëve të përfshirë. Në këtë plan jepen udhëzime për procesin e monitorimit të komponenteve të shumëllojshmërisë biologjike, identifikimin e proceseve dhe kategoritë e veprimtarive, të cilët kanë apo kanë të ngjarë të kenë ndikime negative të rëndësishme në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike dhe si të vleresohen efektet e tyre.

Plani sjell në vëmendjen e përdoruesve të tij se zona e mbrojtur përmbanë disa nga vlerat më të mëdha të rajonit ku gjendet nga pikëpamja ekologjike dhe ekonomike.

Përveçse mbrojtëse dhe garantuese të larmisë së botës së gjallë, shërbenë si burim ekzistence të mirash materiale dhe të ardhurash për komunitetin.

Vlera e këtij plani menaxhimi do të realizohet nëse menaxherët e lidhur me të i referohen atij çdo ditë, promovojnë përmbajtjen në terren me pronarët e ndryshëm të tokës, me mbështetësit dhe grupet e përdoruesve që operojnë në zonën e Gjirit të Porto Palermos-Llamani.


5. Kohëzgjatja e planit


Plani i Menaxhimit është dokumenti që përcakton vizionet, qëllimet afatgjata për zonën e mbrojtur, të cilat

administrata dhe Komiteti i Menaxhimit do të përpiqen t'i realizojnë në të ardhmen.

PIM përcakton synimet që janë më realiste të realizueshme për një periudhë kohore të paracaktuar. Për rrjedhojë, plani përvijon një kuadër të hollësishëm të veprimeve që do të zhvillohen brenda zonës së mbrojtur në 10 vitet e ardhshme (2015-2024), kohë në të cilën plani do të rishikohet dhe korrigohet, sikurse parashikohet.

Suksesi i tij mund të garantohet nëse të gjithë aktorët mbështesin planin dhe punojnë së bashku në partneritet për të zbatuar politikatat dhe veprimet menaxhuese të cilat janë caktuar





I. PËRSHKRIMI I ZONËS SË MBROJTUR BREGDETARE-DETARE (ZMBD)

1.1 Kriteret e përzgjedhjes së ZMBD

Përzgjedhja e zonës së mbrojtur Gjiri i Palermos-Llamani është bazuar në studimin, analizën dhe rekomandimet e shprehura për kriteret e përzgjedhjes së zonave bregdetare-detare, të caktuara në “Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare e Bregdetare (PSZMDB), i përgatitur nga INCA, me mbështetjen e UNDP, në kuadër të projektit “Shtimi i sipërfaqes dhe përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura detare e bregdetare”.

Lista e kriterëve të përmendura ofron një kuadër të qëndrueshëm konceptual, i cili mund të zbatohet në Shqipëri. Kërkon një identifikim sistematik të llojeve të habitateve detare dhe kaktimin e kufijve, sipas një klasifikimi të qëndrueshëm. Sistemi i përfaqësimit, i mbështetur në shkencën e saktë dhe planifikimin e kujdesshëm, është thelbi i rrjetit të një zone të mbrojtur që plotëson kërkesat e kriterëve ndërkombëtare për përzgjedhjen e ZMDB.

Peizazhi bregdetar sipas “Plani dhe Studimi për Menaxhimin e Integruar Bregdetar”⁴, ndahet në 8 zonal njësi detare bio-geografike në rajonin bregdetar Jugor. Këto njësi u përcaktuan sipas gjeomorfologjisë, orientimit, gjeologjisë, substratit dhe ekspozimit ndaj erërave e rrymave detare. Në njësinë 6 përfshihet rajoni nga Dhërmiu deri në Porto Palermo, duke propozuar Porto Palermon si zonë të mbrojtur. Zonat e Ndjeshme Mjedisore (ZNM/ESA) u identifikuan sipas kriterëve të më poshtëme:

- Kompleksiteti i lartë i ekosistemeve;
- biodiversiteti i pasur;
- burime të rëndësishme natyrore për përdorim human;
- cilësia apo “natyraliteti” i mjedisëve bregdetare-detare e tokësore;
- bukuria natyrore;
- nevoja për një zhvillim të integruar dhe të saktë mjedisor;
- ekzistenca e rrënojave kulturore dhe arkeologjike;
- ekzistenca e përdorimeve tradicionale;
- potenciali për qëllime argëtuese dhe edukative.

Në përcaktimin e zonës së Porto Palermo-Llamanit me status mbrojtës janë marrë parasysh:

- Kriteret ekologjike
 - *Diversiteti i madh natyror dhe biologjik*: Përfshin habitate interesante detare dhe bregdetare me shumëllojshmëri të pasur të habitateve dhe specieve.
 - *Përfaqësimi*: Përfaqësohet nga bregdet shkëmbor dhe stad infra-bregor të Detit Jon.
 - *Prodhimtari*: Prodhimtari e lartë në drejtim të prodhimit natyror dhe gjysëm-natyror (marinë-kultura e peshkut).
 - *Rëndësia për një specie*: Foka mesdhetare.
- Prioriteti
 - *Speciet apo habitatet e rrezikuara, të pakësuara ose të kërcënuara për t'u zhdukur*: Posidonia, Shkëmbinjtë nënujorë.
 - *Rëndësia për një habitat/biotop*: Posidonia, Shkëmbinjtë nënujorë, Euforbia/Ryelli.
 - *Rëndësia për specie të ndryshme*: Pavarësisht të dhënave të kufizuara, shumë specie detare dhe tokësore përbëjnë shqetësim ndërkombëtar.
 - *Ndjeshmëria*: Livadhet Posidonia preken nga veprimtaritë e marinë-kulturës në zonë dhe nga veprimtaritë njerëzore (banjat, varkat e peshkimit, etj); ato paraqesin shënja të trysnisë. Efekti negativ mund të vërehet edhe në habitatet tokësore (veçanërisht në euhporbia) të dëmtuara gjatë ndërtimeve dhe zjarreve në stinën e verës.
 - *Natyrshtëmëria*: Në zonë është ndërhyrë rëndë nga njeriu rreth viteve '60, gjatë ndërtimit të tuneleve nën det. Megjithatë, duke qenë një zonë ushtarake qysh atëherë, ajo e ka përtërirë dhe e ka ruajtur natyrshmërinë e saj.
- Konsiderata praktike
 - *Sipërfaqja*: Sipërfaqja e propozuar është relativisht e vogël. Megjithatë, ajo përfshin një peizazh natyror të mirë përcaktuar, me kufij të qartë, gjë që e bën të përsosur për t'u ruajtur. Kalaja dhe kisha të ndërtuara nga Ali Pashë Tepelena në fund të shekullit të 18-t ia shtojnë vlerat kësaj zone.
 - *Potenciali për përtëritje*: Duke qenë një zonë e mbyllur për një kohë të gjatë dhe nën kërcënimet e njeriut

⁽⁴⁾ PAP/RAC-SOGREAH: “Plani dhe Studimi për Menaxhimin e Integruar Bregdetar”, 2005

vetëm në 20 vitet e fundit, ka potencial të lartë për t'u përtërirë. Prania e bazës ushtarake, edhe pse nuk është shumë aktive, mund të jetë një element pozitiv përkrah procesit të përtëritjes.

- *Niveli i pranimit*: Zona ka qenë e izoluar për vite dhe komunitetet vendase janë ambjentuar me idenë e një zone të mbrojtura (pa akses). Mund të pritet kundërshtimi i krijimit të ZM-së nga investitorët e marinë-kulturës.
- *Mundësia e suksesit të masave të menaxhimit*: Zona është e njohur për bukurinë natyrore, vlerat kulturore (Kështjella e Ali Pashës, Kisha e Shën Nikollës dhe amforat nëndetare) dhe potencialin ekonomik (turizëm, marinë-kulturë, etj). Masat e menaxhimit do të integrohen në fusha të ndryshme me synim për të përtërirë aspektet natyrore. Roli i autoriteteve vendore është shumë i rëndësishëm.

Mbështetur në informacionin dhe analizën më sipër, zona emërtohet Zona e Mbrojtur Detare dhe Bregdetare "Gjiri i Porto Palermo-Llamanit". Objektivat e zonës janë së pari, kontributi në paprekshmërinë e biodiversitetit, ekosistemit dhe peizazhit të rrjetit të ZMDB-ve në përgjithësi, dhe së dyti, mirëmbajtja e biodiversitetit natyror, ekosistemeve, mallrave e shërbimeve të ekosistemit brenda zonës së specifikuar.

Gjiri i Porto Palermos-Llamanit plotëson mjaft nga këto kritere për të patur statusin mbrojtës "Rezervat Natyror i Menaxhuar (Park Natyror)", kategoria e IV-të, sipas IUCN. Mbështetur në nenin 9 të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar: Territorët që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen "Rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve)/Park natyror".

Kjo kategori përfshin pjesë toke/bregdeti/deti në pronësi publike ose private dhe qendra banimi, brenda të cilave zhvillohen veprimtari si bujqësia-blegtoria, agopylltaria, bimët mjekësore, peshkimi tradicional, qendrat e plazheve, të shërbimeve dhe të pritjes së vizitorëve, ato ushake dhe kulturore, etj. Zonë e mbrojtur dhe e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e natyrës, të biodiversitetit dhe rekreacion (çlodhje, argëtim). Qëllimi është që të ruhet edhe cilësia e peizazheve dhe bashkëveprimi harmonik i veprimtarive njerëzore në to, dhe diversiteti biologjik që ato përmbajnë.

1.2 Vendndodhja

Vendi: Shqipëri

Qarku: Vlorë

Bashkia: Himarë

Sipërfaqja e përgjithshme: 2,067.75 ha, nga e cila 315.36 ha (15.25 %) tokësore dhe 1,752.39 ha (84.75 %) detare.

Zona e mbrojtur Gjiri Porto Palermos-Llamanit gjendet tërësisht brenda territorit administrativ të Bashkisë

Himarë. Shtrihet në Jug-Lindje të qytetit të Himarës. Kufizohet me Kepin e Alpunit (Prato) të Gjirit të Llamanit, në Veri, dhe përfundon në pjesën Jugore, me Kepin e Spinasarit. Ndërsa në Perëndim me sipërfaqen detare, e cila shtrihet në një distancë nga bregu (nga kepet kryesore: Alpunit, Kavadorit, Panormës dhe Spinasarit) 1 milje detare (1853 m).

Kufiri topografik i zonës së mbrojtur:

1. Në Veri, kufizohet me pikën 1, me koordinata 43 91 937.1L/44 38 146.4V, e cila ndohej 1853m (1 milje detare) larg bregut të Kepit të Alpunit (Gjiri Llamanit), vijon përgjatë kurrizit në drejtim të k. Ullirit të Hollë, zbrer në drejtim të rrugës Himarë-Qeparo, deri tek pika 2, me koordinata 43 95 093.6L/44 39 875.2V, bashkimi i rrugës kryesore me rrugën që zbrer tek plazhi i Llamanit;
2. Në Lindje, pika 2, me koordinata 43 95 093.6L/44 39 875.2V, vijon në krahun e djathtë (poshtë) rrugës automobilistike Himarë-Qeparo, deri tek pika 3, me koordinata 43 98 722.3L/44 35 525.0V;
3. Në Jug, pika 3, me koordinata 43 98 722.3L/44 35 525.0V, vijon në drejtim të Kepit të Spinasarit deri tek pika 4, me koordinata 43 98 519.7L/44 33 685.7V, në distancë 1 milje detare nga kepi;
4. Në Perëndim, pika 4, me koordinata 43 39 519.7L/44 33 685.7V, ndjek izohipset në distancën 1 milje detare, deri tek pika 1, me koordinata 43 91 937.1L/44 38 146.4V.


Brenda sipërfaqes së ZM gjenden k.Ullirit të Hollë, plazhi i Llamanit, q. Lerës, kuotat 123,8m e 75.2m; gadishulli i madh i Kavadorit, rrënojat e ndërtesave ushtarake, fortifikime dhe tuneli, stanet, moli, ndërtesa të peshkatarëve, kisha e Shën Nikollës, Kalaja e Aliut, në kuotën 28.2m; pika të vogla për plazhe; kuota 104,7 m (m. Palermos), në të cilën janë vendosur antenat e komunikimit, një bimësi mesdhetare dhe të kullotave.

Mjediset bregdetare-detare e nënujor karakterizohen nga shkëmbinjë dhe gjiret. Takohen Gjiri i Llamanit, Gjiri i Porto Palermos, i cili përbëhet nga dy gjire: Armeridhës dhe Shën Nikollës si dhe Gjiri i Gravës, në Jug.

Livadhët me *Posidonia oceanica* formojnë lëndina nëndetare, hapsirë e pastër detare-bregdetare dhe nënujore ende të paprishura, fantastike për zhytjen, prania e mbetjeve arkeologjike (amforat) të shekullit II para krishtit, si dhe tri qendra të rritjes së peshkut (marinë-kulturë).

Brenda territorit gjenden disa rrugë dytësore jo të mirëmbajtura si ato që të çojnë tek Kepi i Alpunit, Gjiri i Llamanit, tek Kepi i Kavadorit, tek gadishulli dhe Kepi i Panorës, tek rrënojat e Kalasë së Kukumit, dhe tek Kepi i Spinasarit, etj.


Territori i ZM rrethohet me fshatin Himarë (Potom), rrugën automobilistike Himarë-Qeparo, kuota 642.1m (m.Gjomit) dhe 547.0m (m.Vrriut), q.Kukumit dhe q.Sukës, përroi i Qeparoit, mali i veshur me bimësinë e kullotave, disa njolla të valanidhit dhe të agaves, me dy lokale dhe qendrën ekologjike.



Harta 1: Zona e Mbrojtur "Gjiri i Porto Palermos-Llamani"

Tabela 1: Përdorimi i territorit të zonës së mbrojtur "Gjiri i Porto Palermos-Llamani"

Nr.	Përdorimi i territorit	Sip. Ha	%/Totalit
1.	Sipërfaqe pyjore, shkurre, tokë me bimësi pyjore	101.45	4.91
2.	Sipërfaqe kullosore	184.67	8.93
3.	Sipërfaqe bujqësore	0.78	0.04
4.	Sipërfaqe ujore (detare)	1,752.38	84.75
5.	Sipërfaqe joproduuese (shkëmbore)	13.72	0.66
6.	Sipërfaqe me troje dhe urbane	14.77	0.71
	TOTALI	2,067.75	100.00



Harta 2: Përdorimi i Territorit të Zonës së Mbrojtur "Gjiri i Porto Palermos-Llamani"

1.3 Statusi ligjor i ZM

Kushtetuta Shqiptare ka për qëllim të garantojë "... Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tashëm dhe të ardhshëm; dhe shfrytëzim racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm...". Kjo garanci kushtetuese justifikon përpjekjet për të menaxhuar biodiversitetin, të mirat dhe shërbimet e ekosistemit që ky biodiversitet mbështet.

Menaxhimi i zonave të mbrojtura është bazuar në Ligjin nr. 8906, date 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar. Ligji ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

Ligji mbështetet kryesisht në politikën evropiane të mbrojtjes së natyrës dhe të biodiversitetit, sipas kategorive e kritereve të Bashkimit Ndërkombëtar të Konservimit të Natyrës (IUCN). Ligji, përgjithësisht, lidhet me përafrimin e Direktivës së Habitaveve (Direktiva 92/43/EEC e Këshillit të 21 Majit 1992, për ruajtjen e habitaveve natyrore dhe të florës e faunës së egër). Njëkohësisht, sigurohet transpozimi i Direktivës Kuadër për Strategjinë Detare (Direktiva 2008/56/ EC e 17 Qershorit 2008 për krijimin e një kuadri për veprimin e Komunitetit Evropian në fushën e politikave mjedisore detare, për pjesën që lidhet me mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitaveve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore.

Ky ligj rregullon mbrojtjen e zonave të mbrojtura, nëpërmjet 6 kategorive të menaxhimit, të cilat zbatohen në

territorin e Republikës së Shqipërisë. Kategorizimi i zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë mbështetet në kriteret IUCN-së. Zonat e mbrojtura detare-bregdetare konsiderohen mjete të rëndësishme për menaxhimin e ekosistemit. Kur menaxhohen mirë, ato: mbrojnë

strukturën, funksionin, dhe paprekshmërinë e një segmenti të ekosistemit; rrisin njohjen dhe kuptimin e ekosistemeve detare; dhe funksionojnë si një zbutës kundër shfrytëzimit nga njeriu, keqmenaxhimit, ndotjes, dhe dëmtimeve të integritetit ekologjike.

Tabela 2: Krahasimi i përkufizimeve të kategorive të menaxhimit të zonave të mbrojtura

KATEGORITË E MENAXHIMIT	Sipas IUCN/CNPPA	Sipas legjislacionit shqiptar
KATEGORIA I. REZERVË STRIKTE NATYRORE/ REZERVAT SHKENCOR.	Për të mbrojtur natyrën dhe ruajtur proceset natyrore në gjendje të pashqetësuar, me qëllim që të kemi shëmbuj ekologjikisht përfaqësues të mjedisit natyror për studime shkencore, monitorim mjedisor, edukim, dhe për ruajtjen e resurseve gjenetike në gjendje dinamike dhe evolucion.	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
KATEGORIA II. PARK KOMBËTAR.	Për të mbrojtur zona natyrore dhe të një bukuri të veçantë skenike, të një rëndësie kombëtare dhe ndërkombëtare, për qëllime shkencore, edukimi dhe rekreative (shlodhje dhe argëtim). Parqet kombëtare janë zona të gjera natyrore të pandryshuara materialisht nga veprimtaritë njerëzore, dhe ku nuk lejohet ekstraktimi i resurseve.	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
KATEGORIA III. MONUMENT NATYRE.	Për të mbrojtur dhe ruajtur tipare natyrore të një rëndësie kombëtare, për shkak të interesit të veçantë dhe karakteristikave të tyre unike (të papërsëritshme). Ato janë zona relativisht të vogla të fokusuar për mbrojtjen e tipareve të veçanta.	Formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallen monument natyror.
KATEGORIA IV. ZONË E MENAXHIMIT TË HABITATEVE DHE LLOJEVE/ REZERVAT NATYROR I MENAXHUAR	Për të siguruar kushte natyrore të nevojshme për të mbrojtur lloje, grup llojesh dhe komunitete biotike me rëndësi kombëtare ose veçori fizike të mjedisit, për të cilat kërkohet një manipulim i veçantë nga ana e njeriut. Një shfrytëzim i kontrolluar i disa resurseve mund të lejohet.	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve).
KATEGORIA V. PEIZAZHE TOKËSORE DHE DETARE TË MBROJTUR	Për të ruajtur peizazhe natyrore me rëndësi kombëtare të cilat janë karakteristike e një ndërveprimi harmonik të njeriut me tokën dhe mjedisin gjatë përdorimit të tyre për turizëm, çlodhje dhe argëtim brenda një stili jetese dhe veprimtarie normale ekonomike në këto zona. Zonat që bëjnë pjesë në këtë kategori janë peizazhe të përziera kulturore dhe natyrore të një vlere të lartë skenike dhe ku ruhen përdorimet tradicionale të tokës.	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
KATEGORIA VI. ZONË E MBROJTUR E RESURSEVE TË MENAXHUAR/ REZERVË E RESURSEVE	Për të mbrojtur resurset natyrore të zonës për përdorim në të ardhmen dhe parandaluar veprimtaritë e zhvillimit që mund të dëmtojnë resurset. Kjo është një kategori e përkohëshme e përdorur derisa të arrihet në një klasifikim të përherëshëm.	Zonat që përfshijnë territore të gjera e, relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Sipas ligjit shqiptar “Zona të mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore, për të cilët zbatohen kategoritë e përshtatura të IUCN-s.

Në Ligjin nr. 9868, datë 04.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, sqarohet se territori i zonës së mbrojtur ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to. Zonimi i brendshëm mund të përmbajë zonën qendrore, zonën e rekreacionit, zonën e përdorimit tradicional, zonën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe nënzona të tjera që i përshtaten territorit. Gjithashtu, zonimi përputh shkallën e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në natyrë.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave, që miraton zonën e mbrojtur, përcaktohen emërtimi, sipërfaqja dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave të saj. Njëherazi të rëndësishëm janë: VKM nr. 267, datë 24.4.2003 “Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike”, i cili plotëson kuadrin ligjor për shpalljen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore biologjike; VKM nr. 86, datë 11.2.2005 “Krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura” dhe VKM nr. 897, datë 21.12.2011 “Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes” (ZVR), në kuadër të rrejtit Natura 2000, ku ZVR shpallen ato territore që përfshihen në ZM, janë brenda rrejtit përfaqësues të ZM, si dhe ekosistemet, habitatat dhe peizazhet jashtë këtij rrejeti.

1.4 Politikat dhe legjislacionet

Mbrojtja e natyrës dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore përbën një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare. Frenimi i degradimit të mjedisit, humbja e vlerave të mëdha natyrore, niveli i lartë i ndotjes së ajrit në qendrat urbane dhe industriale, erozioni masiv i tokës, dëmtimi i pyjeve, ndotjet e ujërave nën e mbi tokësore e detare, zonat e mbrojtura, etj, përbëjnë disa nga problematikat kryesore në rrugën e zhvillimit afatgjatë të vendit.

Ruajtja e natyrës, brenda sistemit të ZM-ve, po vlerësohet gjithnjë e me shumë si instrument i rëndësishëm për ruajtjen e vlerave më të larta të biodiversitetit në vend. Zgjerimi dhe forcimi i rrejtit të zonave të mbrojtura, bazë për krijimin e Rrejtit Ekologjik (RrE) të vendit, vlerësohet si një nga objektivat më të rëndësishme të Programeve dhe Planeve të Veprimtimit të Qeverisë Shqiptare.

Mbrojtja e Natyrës është një prej nënfushave prioritare që lidhen me acquis communautaire në fushën e mjedisit. Siç përcaktohet nga MSA (neni 70/3 dhe neni 108), përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis në fushën e mjedisit, lidhet direkt me standardet mjedisore, detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky objektivi,

është përfshirë në dokumentet strategjike sektoriale: Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) dhe Strategjia dhe Plani i Veprimtimit për Biodiversitetin (SPLVB).

Objektivat kryesorë të kësaj fushe konsistojnë në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, nëpërmjet mirë administrimit në 3 nivelet përbërëse të tij: lloje, habitate dhe ekosisteme si dhe arritjen e statusit të favorshëm për llojet e florës dhe faunës së egër që do të sigurojnë mbijetesën e tyre. Këto objektiva themelore parashikohet të arrihen nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së ZM-ve dhe zbatimit me efikasitet të planeve të tyre të menaxhimit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Administratave të Zonave të Mbrojtura (AdZM).

Në fushën e mbrojtjes së natyrës procesi i përafrimit të direktivave kryesore të Bashkimit Evropian (BE) është tashmë në një fazë të avancuar. Direktiva e Shpendëve e përafruar me ligjin “Për mbrojtjen e faunës së egër”, nr.10006, datë 23.1.2008, u përafua më tej me ligjin “Për gjuetinë”, nr. 10253, datë 11.3.2010. Ndërsa përafrimi i plotë është parashikuar nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të dy ligjeve të lartpërmendura në periudhën afatmesme.

Direktiva e Habitave është transpozuar nëpërmjet dy ligjeve përkatësisht Ligjit “Për mbrojtjen e biodiversitetit” të vitit 2006, të ndryshuar dhe Ligjin “Për zonat e Mbrojtura”, të vitit 2002, të ndryshuar.

Konkretisht Direktiva e Shpendëve (versioni i kodifikuar 2009/147/EC) dhe Direktiva e Habitave (92/43/EC) janë transpozuar në masën 85-90 % të dispozitave të tyre.

Legjislacioni shqiptar është frymëzuar dukshëm nga standartet e BE-së. Gjithashtu, parimet kryesore të ligjeve të BE mbi mjedisin gjenden tashmë edhe në legjislacionin shqiptar. Ky legjislacion është e po hartohet me asistencën e ekspertëve të huaj, dhe pasqyron kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.

Korniza ligjore për mbrojtjen e natyrës bazohet sipas kësaj hierarkie: Kushtetuta, legjislacioni dhe aktet normative mbështetëse si: aktet nënligjore, vendimet e qeverisë, urdhërat e ministrave, udhëzimet dhe standartet.

Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe aktorët e interesuar, po bën përpjekje për harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar në lidhje me zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin me legjislacionin evropian. Legjislacioni aktual, për mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, plotësohet edhe nga një sërë aktesh nënligjore, vendime dhe urdhëresa të Këshillit të Ministrave (KM) apo Ministrive, që lidhen me studimin, shpalljen dhe administrimin e zonave të mbrojtura.

Konceptet e reja të menaxhimit të zonave të mbrojtura bazohen në bashkërendimin e veprimeve për ruajtjen e vlerave natyrore me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore nga banorët lokal dhe aktorët e interesuar. Këto koncepte me banorët dhe përdoruesit e burimeve natyrore i shohin si pjesë mjaft e rëndësishme e procesit të menaxhimit të integruar të ZM.

Tabela 3: Përshkrim i shkurtër i kufizimeve kryesore për menaxhimin e ZM

LEGJISLACIONI	Kufizimet/mundësitë përkatëse për menaxhimin e ZM
LIGJI NR. 8906, DATË 06.06.20202 "PËR ZONAT E MBROJTURA", TË NDRYSHUAR.	Qëllimi i ligjit është që të sigurojë një mbrojtje të veçantë për shumë përbërës të rëndësishëm të zonave natyrore, biodiversitetit dhe natyrës, nëpërmjet krijimit të rrjetit të zonave të mbrojtura të bazuar në sistemin e kategorive të Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Ligji gjithashtu parashikon masat për një zhvillim dhe zbutje të "turizmit mjedisor", përfitimeve të tjera ekonomike dhe për dhënien e informacionit dhe edukimit të publikut.
LIGJI NR. 9587, DATË 20.7.2006 "PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT", TË NDRYSHUAR.	Synon mbrojtjen dhe ruajtjen e larmisë biologjike, të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të saj, nëpërmjet integritimit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.
LIGJI NR.9867, DATË 31.01.2008 "PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR".	Synon mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër, me synim për të ruajtur llojet, popullatat, habitatet ku ato jetojnë, rrugët e shtegimit, si dhe për të siguruar kërkesat e tyre për ushqim, strehim dhe shumim.
LIGJ NR. 10253, DATË 11.02.2010 "PËR GJUEJINË".	Përcakton rregulla dhe kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj.
LIGJI NR.9867, DATË 31.01.2008 "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR"CITES.	Përcakton rregullat dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të konventës CITES, në mënyrë që tregtia e tyre ndërkombëtare të mos ua rrezikojë mbijetesën dhe të shmangë keqtrajtimet e tyre gjatë tregtimit ndërkombëtar.
LIGJI NR. 64, DATE 31.05.2012 "PËR PESHKIMIN".	Rregullon veprimtarinë e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në veprimtaritë në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.
LIGJI NR. 111/2012 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE".	Synon mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre.
LIGJI NR.8905, DATE 06.06.2002 "MBROJTJA E MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE DËMTIMET".	Synon mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.
LIGJI NR. 107/2014 "PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT".	Qëllimi kryesor është që të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të territorit përmes përdorimit racional të tokës, burimeve natyrore, dhe për të siguruar një funksionim më efikas të sistemit përmes përfshirjes së publikut në procesin e vendimmarrjes dhe zhvillimit të planeve për kontrollin e territorit.
PLANI STRATEGJIK I QARKUT VLORË.	Parashtron 3 skenarë të rëndësishëm për një zhvillim ekonomik të larmishëm të territorit, ku zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm zë vendin e parë (ndjekur nga zhvillimi rural dhe i industrisë së lehtë), si dhe vlerësimin e atraksioneve ekzistuese kulturore dhe natyrore.
PLANI TERRITORIAL I HAPËSIRËS SË BASHKISË, HIMARË.	Vizioni për zhvillimin territorial e cilëson turizmin bazë të zhvillimit lokal dhe burimet natyrore dhe kulturore si bazë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm me standardet e cilësisë më të lartë. Gjithashtu, duhet të zhvillohen forma të buta të turizmit masiv dhe forma të qëndrueshme të turizmit në lidhje me burimet natyrore dhe kulturore. Vlerat e peizazhit të zonës trajtohen me rëndësi të veçanta, dhe të mbrojtura nga ndërtesa/zhvillimet.
DIREKTIVA E KËSHILLIT 92/43/EEC "PËR PËR RUAJTJEN E HABITATEVE NATYRORE DHE TË FAUNËS DHE FLORËS SË EGËR".	Qëllimi kryesor i Direktivës së BE për Habitatet është që të mbrojë biodiversitetin në Evropë. Krijimin e zonave të veçanta të ruajtjes.
DIREKTIVA 2009/147/EC "PËR RUAJTJEN E ZOGJVE TË EGËR".	Synon krijuar një skemë të plotë të mbrojtjes për të gjitha llojet të shpendëve të egra natyrisht që ndodhen në Bashkimin Evropian. Krijimi i zonave të veçanta të mbrojtjes.
DIREKTIVA 2000/60/EC, KUADËR E BE PËR UJIN.	Përcakton një kuadër për veprim në fushën e politikës së ujit, arritjen e statusit më të mirë sasior dhe cilësor e të gjithë tërësisë ujore (duke përfshirë ujërat detare deri në disa kilometra nga bregu).
KONVENTA MBI DIVERSITETIN BIOLOGJIK.	Kërkon të vendoset një sistem zonash të mbrojtura, dhe menaxhimi i tyre të bëhet në mbështetje të ruajtjes, përdorimit të qëndrueshëm dhe ndarjes së barabartë të përfitimeve. Zonat e Mbrojtura i njeh si institucione ekonomike, të cilat luajnë një rol kyç në lehtësimin e varfërisë dhe ruajtjen e sistemeve jetësore kritike për banorët.
KONVENTA BOTËRORE PËR ZONAT E MBROJTURA (KBZM) E IUCN-SË.	Misioni i KBZM është "Të nxisë ngritjen dhe menaxhimin efektiv të një rrjeti përfaqësues mbarëbotëror të zonave të mbrojtura tokësore dhe detare", duke dhënë një kontribut shtesë në misionin e IUCN-së.
KONVENTA E BERNËS "PËR RUAJTJEN E FLORËS DHE FAUNËS SË EGËR DHE MJEDISIN NATYROR NË EUROPË".	Ka për objekt të garantojë ruajtjen e florës dhe faunës së egër si dhe të vendbanimeve të tyre natyrore.
KONVENTA E BONIT "PËR RUAJTJEN E LLOJEVE SHTEGËTARE TË BOTËS SË EGËR"	Synon të ruajë të gjitha llojet migratore detare, tokësore dhe ujore, në tërë zonat ku bëhet migrimi
KONVENTA E BARCELONËS "PËR MBROJTJEN E MESDHEUT NGA NDOTJA".	Mbron ujërat e detit Mesdhe nga ndotjet, hidrokarburet dhe lëndët e tjera të dëmshme. Në vijim të kësaj konvente u nënshkruan dhe protokollat "Për zonat veçanërisht të mbrojtura" dhe "Për mbrojtjen e biodiversitetit në Mesdhe".
KONVENTA E CITES (PËR TREGËTINË NDËRKOMBËTARE TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FLORËS DHE FAUNËS SË EGËR).	Shtetet anëtare janë të detyruar të zbatojnë detyrimet për të gjitha speciet e rrezikuara për zhdukjen që janë ose mund të ndikohen nga tregtia.

Burimi: Ministria e Mjedisit

1.5 Strukturimi institucional

Ministrisë së Mjedisit i është dhënë roli parësor politik-bërës dhe mbikëqyrës për zonat e mbrojtura në Shqipëri. Detyrat kryesore të MM janë:

- Harton dhe publikon planin e zonave, që do të shpallen të mbrojtura, pasi merr edhe mendimin e organeve të qeverisjes vendore;
- përgatit procedurat ligjore për të propozuar dhe miratuar një zonë të mbrojtur si dhe rregullat e menaxhimit;
- jep njoftime publike për zonat e mbrojtura, të miratuara, për monumentet natyrore, për llojet e bimëve dhe të kafshëve, veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre;
- miraton dhe shpall planet për menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe programet për mbrojtjen e llojeve të bimëve dhe kafshëve, veçanërisht të rrezikuara, për burimet ujore dhe liqenet natyrore e artificiale në këto zona;
- ndjekë monitorimin në vazhdimësi të planit të menaxhimit dhe të veprimtimit për habitatet dhe speciet.

Planet e menaxhimit dhe programet e mbrojtjes hartohen në bashkëpunim me institucionet administruese dhe me pronarët e objekteve të përfshira në zonat e mbrojtura.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, krijuar në shkurt 2015, me strukturat e saj rajonale (Administratat e Zonave të Mbrojtura) është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit dhe të zonave të mbrojtura si dhe për zbatimin e planit të menaxhimit. Administrata e zonës së

mbrojtur luanë një funksion koordinues dhe informues për të siguruar një zbatim më të mirë të praktikave ligjore, në lidhje me ruajtjen e natyrës, të biodiversitetit, të zonave të mbrojtura dhe të peizazhit.

Planet e menaxhimit dhe programet e mbrojtjes zbatohen nga administrata e ruajtjes së zonës. Administrata e zonës së mbrojtur, veç detyra e përgjegjësitë të caktuara me dispozitat e ligjit “Për zonat e mbrojtura” kryen detyra dhe shërbime të caktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 266, datë 24.4.2003 “Për administratat e zonave të mbrojtura”.

Për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura krijohen Komitetet e Menaxhimit. Përbërja, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve janë të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 11.02.2005.

Me VKM nr. 103, datë 04.02.2015 është krijuar Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), i cili ka mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve. Është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Grupet e interesit, si në nivel qendror dhe vendor, kanë rol dhe përgjegjësi për ruajtjen, mirë-menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonën e mbrojtur. Përfshirja e grupeve të interesit njihet gjerësisht si mekanizëm që mund të ndihmojë në mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në mënyrë efektive. Një marrëdhënie bashkëpunuese midis autoritetit të menaxhimit të zonës dhe grupeve vendore të interesit mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për të zgjidhur çështje të ndërlikuara të planifikimit e menaxhimit.

Tabela 4: Grupet e interesit, roli i tyre në administrimin e burimeve natyrore

INSTITUCIONET	MISIONI DHE ROLI NË ADMINISTRIMIN E ZM
KËSHILLI I MINISTRAVE	Është organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv dhe vendim-marrës me rëndësi për mjedisin, autoriteti kombëtar i planifikimit të territorit dhe krahas kompetencave të tjera, nxit politikat e planifikimit e të zhvillimit në territor, mbështet hartimin e planeve territoriale kombëtare nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe siguron që ato të përmbushin standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në ligj.
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT (KKT)	Është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit dhe funksionon pranë Këshillit të Ministrave.
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT (KKU)	Është organi më i lartë koordinues dhe vendimmarrës në nivel qendror për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i kryesuar nga Kryeministri.
MINISTRIA E MJEDISIT (MM)	Ka për mision të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve, ujërave në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik.
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT (AKM)	Në varësi të MM është përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, ushtron funksionet e ngarkuara nga ligjet “Për mbrojtjen e mjedisit”, “Për lejet e mjedisit”, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA (AKZM)	AKZM është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin e zonave të mbrojtura.
INSPEKTORATIT SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE (ISHMP)	Në varësi të MM ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve, ndërkohë që është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë për mjedisin.

INSTITUCIONET	MISIONI DHE ROLI NË ADMINISTRIMIN E ZM
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT (MZHUT)	Është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, të strategjive e të politikave në fushat e përgjegjësisë shtetërore që mbulon. Fushat kryesore të veprimtarive të së cilës, janë ngushtësisht të lidhura me mirëqenien mjedisore, është e vendosur të vërë në themel të veprimtarisë së saj: parime dhe politika të mbrojtjes mjedisore dhe përmirësimin e sjelljes institucionale, në mbrojtje të mjedisit.
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT (AKPT)	Ka përgjegjësi zbatuese në planifikimin e territorit në nivel kombëtar. Kryen studime dhe vlerësime për zhvillimet në territor dhe, mbi këtë bazë, i sugjeron Këshillit të Ministrave përmirësimin e sistemit ligjor për planifikimin e territorit dhe instrumentet e kontrollit të zhvillimit ose nevojën e ndërmarjes së proceseve planifikuese apo të masave të tjera të nevojshme.
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT (AKB)	Objekt i saj është mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare. Zbatimi i politikave për menaxhimin e intergruar të zonës bregdetare, bashkërendimi i programeve dhe nxitja e investimeve.
INSPEKTORIATI NDËRTIMOR URBANISTIK KOMBËTA (INUK)	Ka rolin kyç në kontrollin e territorit.
MINISTRIA E KULTURËS (MK)	Ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore: Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritimit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore.
MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE (MBZHRAU)	Ka për mision menaxhimin e qëndrueshëm dhe efektiv të tokës bujqësore, të sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmybtja.
MINISTRIA E ENERJITIKËS DHE INDUSTRIËS	Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjitike dhe minerale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin.
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES (MZHETS)	Misioni i saj është përgatitja dhe aplikimi i politikave të qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë dhe sipërmarrjes, për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik.
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS (MTI)	Është përgjegjëse për realizimin e shërbimeve publike si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave etj. si dhe të rrjetit kombëtar të rrugëve.
MINISTRIA E ÇËSHTJEVE VENDORE (MÇV)	Është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor dhe ndarjen territoriale të vendit.
MINISTRIA E MBROJTJES	Ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
QENDRA NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD)	Është një institucion ndërkasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.
KËSHILLI I QARKUT, VLORË	Ndërton dhe zbaton politika të zhvillimit rajonal dhe siguron harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, duke shërbyer si koordinator midis qeverisjes qendrore dhe njësisë bazë të qeverisjes vendore, bashki dhe komuna. Ka synim kryesor plotësimin sa më të mirë të nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar rajonal me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nënadministrim.
KËSHILLI I BASHKISË, HIMARË	Ushtron funksionet e veta midis të tjerash ato që lidhen me ujësjellësat, kanalizimet, ujërat e zeza, kullimin dhe ujitjen, ndërtimet, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale, të transportit publik, menaxhimin e ndotjeve, planifikimin, mundësia që niveli lokal të zgjerojë të drejtat dhe kompetencat e tij.
BIZNESI	Përdorimi i territoit për ndërtim dhe veprimtari ekonomike-sociale dhe turistike. Përdorimi territorial detar e bregdetar për pushime, argëtime, veprimtari sportive ujore e tokësore, etj.
BARINJËT	Ka interesa për kullotjen e bagëtime, përmirësimin dhe shtimin e kapaciteteve të kullotës.
PESHKATARËT, MARINË-KULTURA	Përdorim të hapësirës detare për peshkim dhe rritjen gjysëm natyrore të llojeve të peshqeve, duke përfshirë peshkatarët vendas, grupet e peshkimit artizanal (peshkatarët e vegjël), dhe për të promovuar ekoturizmin dhe turizmin e peshkimit (peshkimin rekreativ) si një mënyrë për të rritur të ardhurat dhe interesimin për zonën.
SHOQËRIA CIVILE, OJF-T MJEDISORE	Komunikimi, ndërgjegjesi dhe edukimi për çështjet e ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe të peizazhit.

1.6 Përshkrim i sistemit natyror të ZM

Zona e mbrojtur është pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë, dhe përfshin pjesë detare dhe tokësore të territorit të Himarës. ZM krijohet për të ruajtur funksionet esenciale të ekosistemeve, habitateve dhe specieve detare e bregdetare, të cilat i shërbejnë jetesës së popullsisë lokale.

Kufijtë e kontekstit fizik të zonës shtrihen mbi ekosistemet kryesore përgjatë bregdetit Jonian.

Gjeomorfologjia: Bregdeti Jonian është kryesisht shkëmbor, të cilët në mjaft raste bien direkt në det. Pjerrësia është krijuar kryesisht nga shkëmbinjtë gëlqeror. Pjerrësitë përgjatë bregdetit janë të mbuluar me bimësi të ndryshme. Depozitat e zhavorrit janë të pranishme në rrymën e deltës së bregdetit. Këto dukuri kanë krijuar plazhet të bukura. Në zonën e mbrojtur nuk dallohen dukuri negative gjeologjike dhe fizike të theksuara.

Struktura gjeologjike e rajonit bregdetar Jugor përbëhet nga depozitimet e periudhës Jurasike deri në periudhën Kuarternar.

Rrjeti hidrografik: Zona bregdetare përshkohet nga një disa lumenj dhe përrenj. ZM përgjithësisht është e varfër në burime ujore. Në Jug të saj gjendet përroi i Borshit, i cili buron nga Lindja e fshatit të Borshit dhe derdhet në detin Jon. Në gjirin e Lllamanit, në pjesën Jugore të tij, gjenden edhe disa burime ujore nëndetare. Burime të tilla gjenden dhe në gjirin e Portopalermos (Armeridhës).

Klima: Klima është shumë e ndryshme për shkak të pozicionit gjeografik, amplitudës së madhe të lartësisë mbi nivelin e detit dhe kryesisht për shkak të relievit. Në përgjithësi, zona e mbrojtur ka klimë mesdhetare, për shkak të pozicionit gjeografik dhe shtrirjes së saj. Reshjet mesatare vjetore janë vlerësuar nga 1,000 deri në 1,200 mm. Ato bien kryesisht në formën e shiut, ndërkohë që dëborat janë të rralla. Shumica e rreshjeve bie në periudhën Nëntor-Prill, 70-80 % e sasisë vjetore. Në pranverë regjistrohet vetëm 20 % e sasisë vjetore të rreshjeve.

Temperatura: Mesatare vjetore luhet midis 16.1-17.7°C. Në Janar temperatura e ajrit është midis 8 dhe 10°C, kurse në Gusht luhet midis 24 deri 26°C.

Era: Duke qënë se është një zonë bregdetare, era e detit ndikon drejtpërdrejt në kushtet klimatike, në veçanti në periudhën e verës. Nga Nëntori deri në Mars drejtimi kryesor i erës është Lindja, ndërsa gjatë pranverës drejtimi i erës është Jug-Veriperëndim.

Biodiversiteti: Të dhënat studimore dhe ato të mbledhura nga kërkimet e fundit në rajonin bregdetar Jugor të Shqipërisë tregojnë një florë të pasur dhe diversitet të madh të habitateve, shoqërimeve bimore, të specieve me një rëndësi të veçantë kombëtare, nga pikëpamja shkencore, ekologjike dhe socio-ekonomike.

Tipet kryesore të bimësisë (Tabela 5: Llojet e bimëve të rregjituara në zonën e Porto Palermos-Lllamani) që gjenden në pjesën tokësore të zonës së mbrojtur, janë si më poshtë:

- Vegetacioni i zonave të ulëta apo pyjet dhe shkurret gjithmonë të gjelbra. Shtrihet nga ultësira bregdetare deri në lartësinë 900 m, i pranishëm dhe në rajonin Palasë-Himarë.
- Pyjet gjethegjere gjithmonë të gjelbër (*Asoc. Orno-Quercetum ilicis*), gjenden edhe në rajonin e Himarës dhe Qeparoit, në afërsi të zonës së mbrojtur.
- Komunitetet bimore të dominuara nga *Euphorbia dendroides*, *Pistacia lentiscus-Allianca Oleo-Ceratonion* (*Assoc. Pistacxio- Euphorbietum dendroides*). Kjo lloj bimësie takohet në pjesë të veçanta përgjatë zonës bregdetare si dhe në Porto Palermos. Ekspozohet në lartësi të ulëta (50-100 m). Shoqërimet e *Euphorbia-s* janë konsideruar më interesante dhe afërsisht unike në Shqipëri.
- Vegetacioni i pseudo-stepës Mesdhetare, që dominohet nga *Brachypodium ramosum* (*Assoc. Brachypodium ramosi*). Degradimi që shkaktohet nga mbikullotja apo zjarret ka sjellë një vegetacion të tipit pseudo-stepë, i cili dominohet nga barërat, kryesisht *Brachypodium ramosum*, mbi shkëmbinjtë gëlqeror. Pjesë të livadheve janë të zakonshme në lartësi 0-900 m, përgjatë gjithë bregdetit jugor, përfshirë dhe rajonin Himarë- Qeparo.
- Pyje lisi që rrezojnë gjethet (*Assoc. Quercetum frainetto*). Takohen dhe në shpatet perëndimore të rajonit Vuno-Himarë.
- Pyjet e dominuara nga *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis* (i njohur lisi i Vlorës), është specie dominuese e pyjeve të lisit: shtresa e pemëve mbulon 60-70 %, lartësia 7 m; shtresa e shkurreve mbulon 50-60 %, lartësia 1-2 m; shtresa e barit mbulon rreth 30 %, lartësia 0,3 m; diametri maksimal i trungut 30-40 cm. Ky tip pylli gjendet aty-këtu në rajonin Himarë-Porto Palermo dhe konsiderohet specie relikte që prej periudhës Terciare.
- *Phrygana/Frigana*. Është i përbërë nga shkurre të ulëta, rreth 60 cm të larta, jo shumë afër me njëra-tjetrën dhe të dominuar nga *Phlomis fruticosa* (*assoc. Chrysopogono-Phlometum fruticosae*). Edhe shoqërimet me *Salvia fruticosa L.* janë karakteristike e bashkësisë së kësaj zone. Edhe shoqërimet me *Salvia fruticosa L.* janë karakteristike e bashkësisë së kësaj zone.

Përbërja floristike e kësaj bashkësie konsiston kryesisht edhe në speciet: *Anagyrris foetida*, *Salvia triloba*, *Lotus cytisoides*, *Phlomis fruticosa*, *Glaucium flavum*, *Galium aparine*, *Pistacia terebinthus*, *Salvia triloba*, *Calicotome villosa*, *Spartium junceum*, *Ruscus aculeatus*, *Asparagus acutifolius*, *Urginea maritima*, *Asphodelus aestivus*, *Chrysopogon gryllus*, *Acanthus spinosus*, *Trifolium angustifolium*, *Brassica incana*, *Paliurus spina-christi*.

Bimësia e shkëmbinjtë bregdetare. Bimësia xero-halophytic e klasës *Crithmo-Limonietea* dominon shtresën më të ulët mbi nivelin e veprimt të valëve. Llojet më të zakonshme në këtë zonë janë *Crithmum maritimum*, *Limonium anfractum*, *Elymus pycnanthus*, *Desmazeria marina*, *Lotus cytisoides*, etj., të cilat përfaqësojnë bashkësitë endemike *Crithmo-Limonietum anfracti*.

Barërat e detit janë të llojeve Magnoliophytes detare. Formojnë shtretërit nënujor, të cilat janë habitate të rëndësishme për ekosistemet detare. Ato ofrojnë ushqim dhe strehim për një numër të madh të specieve detare. Gjithashtu parandalojnë erozionin në plazh, duke stabilizuar sedimentet me rizomat e tyre.

Në zonë janë të pranishme tre lloje bimësh: *Posidonia oceanica*, *Cymodocea nodosa* dhe *Halophila stipulacea*. *Posidonia oceanica* ose bari i detit është lloji më i bollshëm, që formon livadhe të mëdha në thellësi të cekët dhe të mesme. Livadhet me *Posidonia oceanica* janë ndër habitatet më të rëndësishme të Mesdheut, dhe ruajtja e tyre është një prioritet i lartë kombëtar dhe ndërkombëtar (Direktiva për Habitatet BE 92/43/CEE, 21 maj 1992). *Posidonia oceanica* është përfshirë gjithashtu në Listën e Kuqe të Florës Shqiptare (2013).

Në ujërat e cekët (2-3 m) brenda gjirit, janë identifikuar zona të vogla të mbuluara me njolla *Cymodocea nodosa*, pjesërisht të shoqëruara me *Halophila stipulacea*.

Shoqërimet e biocinosave të koralogjeneve. I përkasin zonës së cirkalitoral, por në mënyrë të veçantë mund të gjendet si një enklavë në biocenozën e algave infralitoral, që favorizojnë hije/nuanca. Ky habitat është vërejtur në vende të ndryshme mes 20-60 m thellësi.

Biocenosat e shkëmbinjve të ulët mediolitoral. Është pjesë e zonës bregdetare që i nënshtrohet lëvizjes së valëve. Organizmat që popullojnë këtë skenë mediolitoriale janë shumë të adaptueshëm për ndryshimet e papritura të temperaturës dhe kripësisë.

Habitati Lithophyllum byssoides. Karakterizohet nga prania e formacioneve gjelqerore kryesisht algat e

kuqe (*Lithophyllum byssoides*), që janë të zakonshme në pjesët veriore dhe qendrore të Mesdheut perëndimor dhe në detin Adriatik. Fragmentet (jastëkë të izoluar) janë të pranishëm vetëm përgjatë bregut të zonës në veri të zonës së Porto Palermos.

Biocenosis i shpellave mediolitoral. I korrespondojnë të çarave ose hyrjeve të shpellave që janë pjesërisht jashtë ujit. Disa prej këtyre habitateve janë të pranishme brenda gjirit dhe përgjatë brigjeve të zonës veriore të zonës së studiuar, ku rriten lloje si: *Hildenbrandia prototypus*, *Phymatolithon lenormandii*, *Peyssonelia spp.*, etj.


Faza infralitorale është një mjedis benthic, përherë i zhytur. Kufiri i sipërm karakterizohet zakonisht nga prania e bimëve që nuk mund të tolerojnë shfaqjen e gjatë, (p.sh. *Cystoseira*), ndërsa kufiri më i ulët është fiksuar normalisht në thellësi maksimale ku është e mundur për bimët detare vaskulare ose “fanerogame” (p.sh. *Posidonia oceanica*) për të mbijetuar.

Biocenoza e algave infralitorale, përfshin macroalga në ngjyrë kafe, të kuqe dhe të gjelbër, të cilat janë prodhuesit primar të rëndësishëm dhe sikurse barërat detare këta mund të ofrojnë ushqim, substrate dhe strehim për një shumëllojshmëri të gjerë të kafshëve.

Shoqërimi me Cystoseira amentacea var. spicata, është i vendosur në rradhë të parë të lartësisë të infralitoralit dhe krijon rripa kryesisht në brigjet e ekspozuara të zonës në veri të zonës së Porto Palermos. Ky shoqërim, përfshin shumë shtresa, dhe karakterizohet nga specie të larta e të pasura. Strehon organizmat epibionit dhe organizma të tjerë benthic, të cilët kryesisht i përkasin algave, polychaetes, molusqeve dhe krustaceve

Tabela 5: Habitata detare kryesore te zones

Nr.	TIPET E HABITATEVE	Sip - Ha	%/Totalit
1	Shoqërimet me <i>C. nodosa</i> dhe <i>Halophila stipulacea</i>	0.1	0.02%
2	Biocenoza të algave infralitorale/fund deti pjesërisht i zhveshur	186.5	39.34%
3	Shtretër të <i>Cymodocea nodosa</i>	0.8	0.17%
4	Shtresë e vdekur e <i>Posidonia</i>	18.9	3.98%
5	Shoqërimet parakoraligjene	5.9	1.24%
6	Livadhe me <i>Posidonia oceanica</i>	227.6	47.99%
7	Livadhe të ralla me <i>Posidonia</i>	33.2	7.00%
8	Rërë	1.3	0.27%
	Totali	474.2	100.00%



Harta 3: Habitatet kryesore detare të ZM

1.7 Përshkrimi i sistemit social-ekonomik, përfshirë zotërimin e tokës

Krahina e Himarës është e përbërë nga qyteti i Himarës së bashku me fshatrat Palasë, Gjilek, Dhërmi, Iliaz, Vuno, Qeparo, Kudhës dhe Pilur. Në këtë krahinë përfshihen 9,938 banorë, nga këta Bashkia Himarë rreth 4,800 banorë. Disponon 715 ha tokë bujqësore, 121 ha pemishte-agrumë, 34 ha vreshta dhe 532 ha ullinj.

Veprimtaritë kryesore social-ekonomike lidhur me zonën e mbrojtur dhe rreth saj, sidomos veprimtaritë rurale, kanë një rëndësi të madhe për rajonin, për qëndrueshmërinë e tij ekonomike. Burimet kryesore janë: toka bujqësore, blegtoria, bimët mjekësore, pylltaria e kullotat, gjuetia, peshkimi e akuakultura, përdorimi i ujërave, turizmi e ekoturizmit dhe veprimtaritë tradicionale e kulturore. Pjesa më e madhe e ndërtimeve dhe shërbimeve janë të përqendruara në qytetin e Himarës.

Pronësia mbi tokën, ndahet në pronë shtetërore, bashkiake dhe private. Një sipërfaqe prej 185 ha kullotë është

në pronësi dhe administrim të Bashkisë Himarë. Ndërsa sipërfaqja rreth 4 ha me Euphorbia dhe 100 ha shhkurre mesdhetare janë në administrim të DSHP Vlorë.

Bujqësia dhe produktet bujqësore, merr një rëndësi të veçantë, sepse toka bujqësore është përgjithësisht e pakët. Toka është klasifikuar me një cilësi të mirë dhe e frytshme. Gjithashtu, kushtet klimatike janë të favorshme për kultivimin e bimëve bujqësore e pyjore.

Prodhimi bujqësor kryesisht konsumohet nga tregu lokal. Prodhuesit përballen me vështirësi në mundësitë e përpunimit të produkteve dhe mungesa e një vendi të organizuar për tregtimin e tyre.

Blegtoria, mbarështimi i llojeve blegtorale është përshtatur mirë kushteve të rajonit. Dominohet nga tufat e deleve dhe dhive. Ndërsa numri i gjedheve është i kufizuar. Sistemet tradicionale vazhdojnë të jenë baza për rritjen e tyre. Kushtet e favorshme të kullotave, nga ku sigurohet baza ushqimore për blegtorinë, ndodhet thuhet në gjithë territorin e ZM.

Rritja në zhvillimin e blektorisë ka ardhur si pasojë e kërkesës për produkte blegtorale dhe në rritjen e kërkesës për konsum më të madh të mishit e të produkteve të tyre. Në këtë zonë rriten edhe kafshë si shpendë, kuajt dhe bletët. Kuajt, shpendët, bletaria janë veprimtari të kufizuar, por me potencial për t'u zhvilluar më shumë në të ardhmen.

Kullotja shpesh ka prekur ndjeshëm habitatet dhe është përhapur shumë afër vijës bregdetare. Ndonëse ndikimi i kullotjes nuk është vlerësuar në këtë fushë, është një kërcënim i ndjeshëm e potencial për habitatet dhe speciet në rrezik nëse nuk kontrollon dhe menaxhohet sa më shpejt të jetë e mundur.

Kodrat rreth gjirit të Porto Palermos janë djegur shpesh nga barinjët, të cilët besojnë se djegja e kullotave është mënyra më efektive dhe më e lehtë për t'i përmirësuar ato. Ky është një risk i lartë, i herëpashershëm që mund të pengojë rishfaqjen e bimësisë natyrore, duke përfshirë këtu dhe specie të rralla, të rrezikuara dhe që janë me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Bimët mjekësore, rajoni ka edhe burime natyrore që mund të mbliken dhe që përfaqësojnë një burim shtesë të ushqimit ose të ardhurave për popullsinë lokale, si bimët mjekësore. Edhe pse një zonë me potencial të lartë ka një interes të ulët për bimët mjekësore për shkak të menaxhimit kryesisht për kullotje dhe djegje së vazhdueshme.

Pylltaria dhe kullota, ka një zvogëlim të sipërfaqes së zënë me pyje në zonën e ZM. Pjesa më e madhe e kësaj sipërfaqe është kullotë.

Gjuetia, është një praktikë e vjetër. Përveç të qenit një veprimtari e rëndësishme rekreative është dhe një veprimtari e rëndësishme ekonomike, për një pjesë të banorëve apo dhe të vizitorëve. Llojet më të kërkuar janë lepuri i egër, thëllëza e malit, turtulli, shapka, llojet e rosave të egra, etj.

Peshkimi dhe marinë-kultura, zona e Porto Palermos-Llamanit, sidomos gjiret janë një burim shumë i rëndësishëm për peshkimin dhe marinë-kulturën.

Veprimtaria e peshkimit në det kryhet kryesisht nga flota e peshkimit. Shumëllojshmëria e llojeve të peshkut është relevante. Në këtë zonë peshku i detit mund të konsiderohet i një cilësie mjaft të mirë, për shkak të pozitës gjeografike të rajonit dhe të brigjeve të detit Jon.

Veprimtaria e mbarështimit të peshkut në det kryhen në zonën e Porto Palermos. Marinë-kultura detare (prodhimi me kosha në det i kocës dhe levrekut) po zhvillohet vitet e fundit. Peshkimi praktikohet në mënyrë individuale, në nivele të ulëta.

Përdorimi i ujërave, sistemi ujitës dhe kullues në ZM nuk përdoret, për vetë kushtet gjeomorfologjike dhe të përdorimit të territorit. Shfrytëzohen ujërat detare për peshkim, sporte, argëtim dhe pushime.

Turizmi, ekoturizmi dhe veprimtari të çlodhëse, është një burim i rëndësishëm i të ardhurave ekonomike për zonën. Në të vërtetë zona ofron vlera natyrore, kulturore dhe historike. Turizmi gjatë viteve të fundit në qytetin e Himarës, rrethinat e saj dhe Gjirin e Porto Palermos-Llamanit ka parë disa përmirësime. Kohët e fundit, turizmi ka zgjeruar potencialet natyrore dhe kulturore të zonës duke ofruar një shumëllojshmëri të lartë të mundësive për turizim si: për plazh, sporte ujore, marshime, ngjitje, ecje në natyrë, kulturor, etj.

Ekoturizmi është një mënyrë e turizmit të natyrësme qëllim një përjetim të qëndrueshëm të trashëgimisë natyrore, duke inkurajuar ruajtjen e saj, si dhe për krijimin e një vetëdije mjedisore, nëpërmjet interpretimit të mjedisit, duke promovuar mirëqenien që përfitojnë popullatat lokale.

Edukimi dhe kërkimi shkencor, është pa dyshim zonë e rëndësishme për kërkime shkencore dhe eksplorime të mbetjeve prehistorike dhe arkeologjike nënujore.

Përdorime të tjera në zonë:

Transporti. Rruga Himarë-Qeparo kalon përbri territorit të ZM.

Ushtria. Ish-bazat ushtarake ndodhet brenda territorit të ZM, por janë ende nën juridiksionin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Transporti me mjet lundruar kryhet nëpërmjet një moli të vogël, kryesisht për peshkim dhe nga ushtria në Gjirin e Porto Palermos.

Shërbim hotelerie dhe restorantet. Nuk janë të shumtë, përveç qendrave të shërbimit të vizitorëve dhe të pushuesve.

1.8 Struktura qeverisëse aktuale dhe ajo e parashikuar

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar, përcakton gjashtë kategori të ndryshme të zonave të mbrojtura, që përkohë me ato të IUCN.

Në bazë të tij, dhe siç është analizuar dhe argumentuar tek Pjesa 1: Përshkrimi i zonës së mbrojtur bregdetare-detare", pika 1.1. Kriteret e përzgjedhjes, zona "Gjiri i Porto Palermos-Llamanit" plotëson kriteret për të patur statusin mbrojtës "Rezervat Natyror i Menaxhuar (Park Natyror)", kategoria e IV-të, sipas IUCN, ku përcaktohet se:

"Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve)/park natyror".

Për këtë zonë të mbrojtur ndalohen:

- a. ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- b. depozitimi i kimikateve;
- c. lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;
- d. mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;
- e. ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje;
- f. vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;
- g. ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara.

Veprimtaritë e tjetëra, që nuk ndalohet nga ky nen, mund të ushtrohen, pasi të pajisen me leje mjedisi.

Autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e Parkut Natyror është Administrata e Zonave të Mbrojtura të Parkut Vlorë. Staf i kësaj administrate duhet të plotësohet urgjentisht me të paktën dy roje mjedisore që të përgjigjen për ruajtjen dhe kontrollin e aktiviteteve në parkun natyror “Gjiri i Porto Palermos-Gjiri i Llamani”

1.9 Përshkrimi i peizazhit kulturor dhe trashëgimisë.

Marrëdhëniet simbiotike të bashkëzistencës së njeriut me natyrën i japin një vlerë të veçantë dhe mjaft domethënëse e parkut natyror të Gjirit të Porto Palermos-Llamani, në kuptimin kulturor, historik, arkeologjik dhe shpirtëror.

Është një zonë me bukuri natyrore të shquar. Peizazhi është tejet i bukur me malet e lartë, bregdet shkëmbor, gjire, gadishuj, det të kaltër e të pastër. Ndërhyrjet njerëzore janë ende në harmoni me natyrën, nuk e dominojnë atë, me përjashtim të disa dukurive të kohëve të fundit. Përdorimi i tokës dhe ekonomia lokale reflektohen në peizazh, përveç disa rasteve të zjarreve. Gjithashtu, të dhënat e ekspertëve të peshkimit dhe blegtorisë tregojnë ekzistencën e rrjetave të peshkimit dhe përdorimit të tokës për kullotje, që në kohë të hershme. Kasollet

dhe stanet i përkasin traditës dhe i japin një tjetër dimension ndërhyrjes njerëzore në formimin e peizazhit.

Trashëgimia kulturore e bregdetit jugor është e rëndësishme për nga vlerat që lidhen me identitetin dhe të kaluarën. Himara është një vendbanim i lashtë qysh në shekullin e V p.e.r. Burimet e shkruara, dëshmojnë se Himara, në lashtësi, ishte vendi i fisit të Kaonëve, fisi rëndësishme i Epirit, krahas Mollosëve dhe Thesprotëve. Fiset Kaone zotëronin Epirin para Mollosëve. Plini (referon se emri Kaoni, vinte nga Kaonët e bregdetit të Akrokeraunëve, ku ndodheshin fortesat Himara, poshtë së cilës ndodhej burimi i ujit mbretëror dhe më tej Meandria (qyteti antik në Borsh), Kestrina etj.


Në territorin e parkut ndodhen disa objekte të rëndësishme historike si Kalaja e Porto Palermos (Ali Pashë Tepelenës) dhe Kisha e Shën Nikollës. Kalaja gëzon statusin e Monumentit të Kulturës, qysh prej vitit 1948.

Gjithashtu në territorin e rajonit të Himarës janë një sërë objektesh, të cilat përbëjnë pasuri kulturore, historike dhe artistike si p.sh.: Në Dhërmi: Manastiri i Panajasë (Shën Mërisë), Manastiri i Shën Thodhorit, Kisha e Shën Stefanit, shpella e Piratëve, shpella e Parashqevisë, Kisha e Shën Nikollës, lagja e vjetër e fshatit Dhërmi, me shtëpitë e ndërtuara me arkitekturën karakteristike, Kulla e fisit Vreto dhe të fisit Kumi etj. Në fshatin Iliaz: Manastiri i Stavridhit.

Në fshatin Vuno: Shtëpitë me arkitekturën karakteristike të zonës. Në fshatin e vjetër Himarë: Kalaja e Himarës, një fortifikim që i përket shekullit të 3-të para erës sonë dhe vazhdon në periudhën e mesjetës, Kisha e Akipeshkopisë, Kisha e Kasiopisë, Kisha e Shën Pandonit, Kisha e Athalit, lagja e vjetër me shtëpitë me arkitekturë karakteristike. Në qytetin Himarë: Shpella e Omerit, e cila i ka dhënë dhe emrin qytetit (Spile), Kisha e Shën Marinës.

Në Qeparo: Fshati i vjetër Qeparo, me shtëpitë e ndërtuara me arkitekturën karakteristike; shtëpia e Ali Pashës, Manastiri i Shën Dhimitritit, Këmbanaria e kishës së fshatit Qeparo, Kalaja e Vjetër etj.

Bukuritë e natyrës dhe shpirti i njerëzve janë pasqyruar me tërë forcën e tyre edhe në këngët polifonike të rralla të Bregut. Këto vlera historike dhe kulturore e bëjnë më tërheqëse këtë krahinë për turistët e huaj dhe shqiptarë. Bukuria natyrore së toku me këto vlera, bëhet akoma më e bukur e më madhështore.





II. VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR DHE I KUADRIT INSTITUCIONAL

2.1 Vlerësimi i Vlerave

2.1.1 Vlerat ekologjike

Habitatet dhe flora e zonës së peizazhit të mbrojtur⁵.

Përshkrimi i habitateve dhe specieve, në lidhje me zonën e Porto Palermos-Llamani, është bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga “Studimi ekologjik i Gjirit të Porto Palermos dhe zonave përreth”.

a. Habitatet tokësore

Shkurret sklerofile (Matorral)

Shkurret termo-mesdhetare dhe para-shkretëtirë Formacionet Euphorbia

Shoqërimet me formacionet e Rryellit/Flomit (*Euphorbia dendroides*) janë konsideruar më interesante dhe afërsisht unike në Shqipëri. Është habitat natyror me rëndësi i Komunitetit me kodin 5330 EUNIS (sipas Direktivës së BE-së për Habitatet).

Përbërja floristike e kësaj bashkësie konsiston kryesisht në: *Anagyrris foetida*, *Salvia triloba*, *Lotus cytisoides*, *Phlomis fruticosa*, *Glaucium flavum*, *Galium aparine*, *Pistacia terebinthus*, *Salvia triloba*, *Calicotome villosa*, *Spartium junceum*, *Ruscus aculeatus*, *Asparagus acutifolius*, *Urginea maritima*, *Asphodelus aestivus*, *Chrysopogon gryllus*, *Acanthus spinosus*, *Trifolium angustifolium*, *Brassica incana*, *Paliurus spina-christi*.

Phrygana/Frigana

Është i përbërë nga shkurre të ulëta, rreth 60 cm të larta, jo shumë afër me njëra-tjetrën dhe të dominuar nga *Phlomis fruticosa* (assoc. *Chrysopogono-Phlometum fruticosae*). Edhe shoqërimet me *Salvia fruticosa* L, janë karakteristike e bashkësisë së kësaj zone.

Bimësia e pseudo-stepave Mesdhetar

Ky formacion i dominuar nga *Brachypodium ramosum* (assoc. *Brachypodietum bronkial*) mbi shkëmbinj të gëlqeror paraqitet i degraduar si rezultat i shfrytëzimit të pakontrolluar ose i djegjes së vazhdueshme të tij.

Pyjet e dominuara nga *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis*

Bimësia e *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis*, i njohur si dushku i Vlorës, konsiderohet si një specie relike

që prej periudhës Terциare dhe është e pranishëm në kodrat e zonës veriore e lindore të zonës.

Bimësia e shkëmbinje bregdetare

Brigjet e zonës së Porto Palermos janë kryesisht shkëmbore. Bimësia xero-halophytic e klasës *Crithmo-Limonietea* dominon shtresën më të ulët mbi nivelin e veprimt të valëve. Llojet më të zakonshme në këtë zonë janë *Crithmum maritimum*, *Limonium anfractum*, *Elymus pycnanthus*, *Desmazeria marina*, *Lotus cytisoides*, etj., të cilat përfaqësojnë bashkësitë endemike *Crithmo-Limonietum anfracti*.

Shtresa e sipërme e kësaj bimësie (nga 5-6 m në 50 m në raste të caktuara) periodikisht e pluhrosur nga një tym i thatë kripe i kristalizuar gjatë stuhive të forta aerosoline, është e përfaqësuar nga një bimësi shumë e rrallë dhe e përhapur e grupit *Capparo-Putorion*. Karakteristikë e llojeve të këtij brezi janë: *Capparis orientalis*, *Putoria calabrica*, *Ephedra foemina*, etj.

Në këtë shtresë të një bimësie të rrallë janë strehuar disa lloje relike subendemike si *Acis ionica*, *Athamanta macedonica*, *Brassica incana subsp. egea*, etj.

Në zonën e Palermos, sipas studimeve të deri sotme, janë regjistruar 54 specie, prej tyre 10 specie cilësohen të rëndësishme dhe 13 specie përfshihen në Librin e Kuq të Florës dhe Faunës Shqiptare (shih Aneksin 2: Lista e shoqërimeve bimore të rëndësishme në zonën e Porto Palermos).

Në zonën e Porto Palermos janë regjistruar dy lloje bimësh invasive/pushtuese, *Agave americana* L. dhe *Ailanthus altissima* (Mill.) Swingle. A. americana, dikur e kultivuar për fibrat, në fakt është natyralizuar dhe zgjeruar, duke mbuluar sipërfaqe të mëdha në shpatin e kodrës mbi rrugën kombëtare nga Himara në Qeparo.

b. Komunitetet Detare benthic dhe habitatet

Shtretërit e fortë dhe shkëmbinjë

I. Pjesa e Mediolorale

Faza mediolorale është pjesë e zonës bregdetare që i nënshtrohet lëvizjes së valëve. Organizmat që popullojnë këtë skenë mediolorale janë shumë të adaptueshëm për ndryshimet e papritura të temperaturës dhe kripësisë.

⁵ Lefter Kashta, Sajmir Beqiraj, Arjan Gace, Xhemal Mato- “Studim ekologjik i gjirit të Porto Palermos dhe zonave përreth”, Nëntor 2013.

Biocenosat e shkëmbinjve të ulët mediolitoral

Masa të ngurtësuar të bregut organogjenik mbështetës (*Lithophyllum byssoides*). Ky habitatit, karakterizohet sidomos nga prania e formacioneve gëlqerore algal, kryesisht algat e kuqe (*Lithophyllum byssoides*), që janë të zakonshme në pjesët veriore dhe qendrore të Mesdheut perëndimor dhe në detin Adriatik. Fragmentet (të izoluar) janë të pranishëm vetëm përgjatë bregut, në Veri të zonës së Porto Palermos.

Biocenosis i shpellave mediolitoral

Shpellat Mediollitoral i korrespondojnë të çarave ose hyrjeve të guvave që janë pjesërisht jashtë ujit. Disa prej këtyre habitateve janë të pranishme brenda gjirit dhe përgjatë brigjeve të zonës veriore, ku rriten lloje si: *Hildenbrandia prototypus*, *Phymatolithon lenormandii*, *Peyssonelia spp.*, etj.

II. Pjesa e Infralitorale

Faza infralitorale është një mjedis benthic që është përherë i zhytur. Kufiri i sipërm karakterizohet zakonisht nga prania e bimëve që nuk mund të tolerojnë shfaqjen e gjatë, (p.sh. *Cystoseira*). Ndërsa kufiri më i ulët është fiksuar normalisht në thellësi maksimale ku është e mundur për bimët detare vaskulare ose “fanerogame” (p.sh. *Posidonia oceanica*) për të mbijetuar.

Biocenosa e algave infralitorale

Biocenosa përfshin macroalga në ngjyrë kafe, të kuqe dhe të gjelbër, të cilat janë prodhuesit primar të rëndësishëm. Sikurse barërat detarë këta mund të ofrojnë ushqim, substrate dhe strehim për një shumëllojshmëri të gjerë të kafshëve.

Shoqërimi me *Cystoseira amentacea* var. *spicata*

Shoqërimi është i vendosur në rradhë të parë të lartësisë së infralitoralit. Krijon rripa kryesisht në brigjet e ekspozuara të zonës në Veri Porto Palermos. Shoqërimi përfshin shumë shtresa dhe karakterizohet nga specie të larta e të pasura. Strehon organizmat epibionit dhe organizma të tjerë benthic, të cilët kryesisht i përkasin algave, polychaetes, molusqeve dhe krustaceve. Në këtë zonë janë regjistruar gjithsej 12 (dymbëdhjetë) specie algash të gjelbra, 14 (katërmëdhjetë) të algave kafe dhe 26 (njëzetëgjatë) të algave të kuqe. (Shiko Aneksi 3: Leshterikët e Porto Palermos).

Livadhjet me bar deti

Barërat e detit janë të llojeve Magnoliophytes detare, që formojnë shtretërit nënujor, të cilat janë habitate të rëndësishme për ekosistemet detare. Ofrojnë ushqim dhe strehim për një numër të madh të specieve detare. Gjithashtu, parandalojnë erozionin në plazh duke stabilizuar sedimentet me rizomat e tyre.

Në zonë janë të pranishme tre specie bimësh: *Posidonia oceanica*, *Cymodocea nodosa* dhe *Halophila stipulacea*. *Posidonia oceanica* ose bari i detit është lloji më i bollshëm, që formon livadhe të mëdha në thellësi të cekët dhe të mesme në zonën e Porto Palermos.

Livadhjet me *Posidonia oceanica*

Livadhjet me *Posidonia oceanica* janë ndër habitatat më të rëndësishme të Mesdheut. Ruajtja e tyre është prioritet i lartë kombëtar dhe ndërkombëtar (Direktiva për Habitatet BE 92/43/CEE, 21 maj 1992). është përfshirë në Shtojcën I (Llojet e Florës së mbrojtur në mënyrë rigoroz) të Konventës së Bernës, dhe Shtojca II (Lista e llojeve të rrezikuara ose të kërcënuara) të Konventës së Barcelonës. *Posidonia oceanica* është përfshirë gjithashtu në Listën e Kuqe të Florës Shqiptare (2013).

Livadhjet me *Posidonia oceanica* kanë një rol shumëfunktional brenda sistemeve bregdetare, në drejtim të prodhimit primar, ciklit të lëndëve ushqyese, stabilizimit të sedimenteve, modifikimit të shkallëve të pjerrësisë të energjisë së valëve dhe sigurimit të «çerdheve» habitatit për peshqit dhe jovertebrorët.

Kufiri i sipërm i livadheve me *Posidonia oceanica* në zonë është identifikuar në 3.5 m thellësi dhe në kufirin më të ulët në 28 m. Një grup i ngushtë me *Posidonia oceanica*, me gjatësi të shkurtër gjendet në një zonë të poshtme shkëmbore, përballë kështjellës, në 23 m thellësi. Në zonat, ku pastërtia e ujit është më e lartë, janë vërejtur shtretër me *Posidonia oceanica* në thellësinë 25-27 m. Në përgjithësi, zona tregon një regres të këtij kufiri të poshtëm me thellësi që shkon në 18-20 m.

Rezultatet e hulumtimi sugjerojnë se, *Posidonia oceanica* ka përjetuar një rënie në gjirin e Porto Palermos. Prania e sipërfaqeve të vdekuara nxjerr në pah se shtretërit zënë një hapësirë shumë më të madhe se në të shkuarën. Kjo rënie është e lidhur kryesisht me ankorimin e anijeve dhe ndërtimeve të fermave (marinë-kultura) të peshkut brenda gjirit.

Në ujërat e cekët 2-3 m, brenda gjirit, janë identifikuar zona të vogla të mbuluara me njolla *Cymodocea nodosa*, pjesërisht të shoqëruara me *Halophila stipulacea*.

Shoqërimet e biocinosave të korologjeneve

Korologjenët i përkasin zonës së cirkalitoral, por në mënyrë të veçantë mund të gjendet si një enklavë në biocenosisin e algave infralitoral. Shpesh ky habitat është vërejtur në vende të ndryshme 20-60 m thellësi.

Përshkrimi i habitateve benthic për secilën zonë

Bazuar në studimin ekologjik gjiri i Porto Palermos-Llamani dhe rrethinat përreth, duke shkuar drejt Veriut dhe Jugut, të ndarë në tre pjesë:

- Zona Veriore – Gjiri i Llamanit;
- Zona Qendrore – Gjiri i Porto Palermos;
- Zona Jugore – Gadishulli i Panormës dhe Kepi i Spinarasit.

a. Zona Veriore: Gjiri i Llamanit. Përfaqëson disa veçanti në krahasim me zonat e tjera të zonës, në drejtim të shpërndarjes së biocenosave benthike. Medio-litorali ka një bashkësi të mirë zhvilluar të *Cystoseira*-s dhe *Lithophyllum* përgjatë pothuajse të gjithë vijës bregdetare. Në pjesën e tyre

më të ulët, shpesh janë të shoqëruara me njolla të algave fotofile me dominimin e koraleve.

Zonat shterpë mbulojnë një pjesë të madhe të zonës së sipërme të infralitoralit, duke arritur nga 5-11 m thellësi. Ky përfaqësim i madh i zonave të zhveshura në këtë fushë, përveç efektit të pushtimit nga iriqët e detit, mund të jetë i lidhur dhe me praninë e shkëmbinjve, gurëve që janë hedhur së fundmi në det nga ndërtuesit pa leje përgjatë vijës bregdetare dhe të ndikimit të lartë nga veprimtaria njerëzore.

Gjatë verës gjiri i Llamani është një nga zonat me presionin më të lartë turistik. Popullsia e rrallë makrobentike përfaqësohet nga alga mucilagjinose, fotofile të tjera, iriq të zinj (*Arbacia lixula*) dhe sfungjerë të dominuar nga *Chondrilla nucula*.

Në këtë zonë është evidentuar një fragmentizim i fortë i livadheve të *Posidonia oceanica*. Është regjistruar një livadh i mirë zhvilluar në pjesën Jugore, në kufirin maksimal në 7 m thellësi dhe në kufirin e poshtëm në 21 m thellësi. Në bregun Lindor mungon krejtësisht livadhi me *Posidonia*. Në këtë pjesë, në thellësitë 11-27 m, shkëmbinj të fundorë përfaqësohen nga një reliev shumë i thyer e me shpatet të thepisura, që mund të jenë të pafavorshëm të zhvillimit të livadheve me *Posidonia*.

Kryesisht në këto thellësi makrobentosi dominohet nga makroalga, shpesh mucilagjinose dhe shoqërime të sfungjerëve. Një tjetër arsye e mundshme për mungesën e *Posidonias* në këtë pjesë mund të jetë e lidhur dhe me hyrjen e ujërave të ëmbla e të ftohtë nga burimet nëntokësore. Në pjesën Veriore dhe Perëndimore të zonës, livadhet me *Posidonia* përfaqësohen relativisht në gjendje të mirë, përkatësisht të vendosura midis thellësive 8-28 m.

Poshtë livadhit me *Posidonia*, nga 26-30 m thellësi, janë regjistruar formacione të zhvilluara të pre-koraligjene dhe koraligjene, me një prani dhe diversitet të lartë të sfungjerëve, makroalgave duke përfshirë ato të mucilagjinë dhe *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea*. Në 30-35 m thellësi, pjesa fundore është e mbuluar kryesisht me rërë të ashpër, ndërsa në thellësi më të ulëta nga 40-50 m, shtrati përbëhet nga një fund i butë me praninë e formacioneve të pre-koraligenous dhe koralligenous, sasi të larta të sfungjerëve, echinoderms (kryesisht *Asteroidea* dhe *Crinoidea*) dhe lëvozhga molusqesh të ngordhur.

b. Zona Qendrore: Gjiri i Porto Palermos. Ujërat e cekta të midio-litoralit dhe të sipërme të infalitoralit të bregdetit nga 0 deri në 3-4 m thellësi. Karakterizohen nga një fund me përbërje gurore, kryesisht shterpë. Në pjesën qendrore të kësaj zone, përmasat e habitatit shterpë shkojnë deri në 6 m thellësi. Në këto thellësi makrobentosi është i dominuar nga popullata me alga fotofile, sfungjerë (*Chondrilla nucula*) dhe iriqët e zi të detit (*Arbacia lixula*). Në pjesën Veriore përgjatë bregdetit, shtrihen shiritat të *Cystoseira*, deri në 1 m thellësi.

Livadhet me *Posidonia oceanica* janë degraduar kryesisht në pjesën më të madhe të zonës, sidomos në pjesën e Jugore. Në këtë pjesë kufiri i sipërm i livadhit ndryshon 5-8,5 m thellësi. Degradimi i livadhit është më i dukshëm nga 12-16 m dhe kufiri më i ulët është regjistruar në 18 m. Në

këtë pjesë shiritat e gjatë të zhveshur në fund, brenda livadhit të *Posidonia-s*, mund të jenë për shkak të veprimtarive ndërtimore të njeriut për krijimin e marinë-kulturës.

Në pjesën Veriore, livadhi me *Posidonia* duket se është në një gjendje më të mirë, me një mbulesë dhe dendësi më të madhe në kufirin maksimal që varion nga 4,5-7 m dhe në kufirin e poshtëm nga 20-26 m thellësi. Në këtë pjesë brenda livadhit të *Posidonia-s* është regjistruar prania relativisht e madhe e sfungjerëve dhe e *Codium sp.* dhe *Pinna nobilis*.

Circulari i sipërm, rreth në 26-70 m thellësi, është i dominuar nga funde të butë, por me një shumëllojshmëri të lartë të mikro habitateve. Mes të tjerash rërë, sendimente balte të zhveshura ose të mbuluara nga makro-alga, gjethe të thata të barërave detar nën dekompozim, guacka të ngordhura të molusqeve, bivalvorë, formacionet koralogjene dhe pre-koralogjene të dominuar nga sfungjerë dhe alga gëlqerore, shkëmbinj organogjenik, etj.

Prania e formacioneve pre-koralogjene, sidomos koralogjene në këtë fushë, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e biodiversitetit, pasi këto janë habitate të përshtatshme për strehimin e një numri të konsiderueshëm të llojeve të makroalgave, makro invertebrorë dhe peshqve. Në zonat fundore, makro fauna më e zakonshme është përfaqësuar nga sfungjerë, ascidian, gastropodë (*Natica*, *Turritella*, *Hexaplex*, *echinoderms* *Ophidiaster*, *Echinaster*, *cnidarian Pennatula*), etj.

Në pjesën Jugore, në afërsi të kufirit të poshtëm të livadhit me *Posidonia*, janë regjistruar edhe shumë alga të tjera invazive të *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea* (hardhi të *Caulerpes*).

Pranë kësaj zone në fund të pjesës jugore të saj është parë prania e amforave antike, që mund të konsiderohen një vlerë e shtuar për zhvillimin e turizmit lokal, përmes veprimtarive të zhytjeve, që gjithashtu edhe mund jenë të tërhequra nga formacionet koralogjene, pre-koralogjen, nga shpatet e pjerët nënujor, që mund të arrijnë ndonjëherë deri në 40 m thellësi, menjëherë poshtë vijës bregdetare.

Bashkësitë *Cystoseira* janë të pranishme në disa pjesë midis medio-litoralit dhe infra-litoralit të sipërm me mbizotërim të *C. amentacea*, në pjesën Lindore dhe *C. compressa*, në pjesën Perëndimore të kësaj zone.

Zonat bregdetare shterpë shtrihen deri në 3.5 m dhe ndonjëherë deri në 7 m thellësi. Karakterizohen nga një prani e lartë e iriqëve të zinj detar (*Arbacia lixula*), ku efekti i kullotjes është i dukshëm në të gjithë zonën. Makrobentosi i rralla në këto vendbanime përfaqësohen nga algat photophilic *Acetabularia*, *Jania*, *Padina*, të sfungjerëve (*Chondrilla nucula*), të gastropodit (*Cerithium vulgatum*) dhe echinodermës (*Arbacia lixula*) dhe *Holothuria tubulosa*.

Sfungjerë janë prezentë në shpella të vogla dhe të çara në ujërat e cekët që shkojnë nga 1-3 m thellësi, në pjesën Juglindore.

Në thellësi, në pjesën Juglindore dhe Veriperëndimore janë regjistruar njolla të fanerogameve *Cymodocea nodosa* (bari i vogël i Neptunit). Në pjesën Juglindore është vërejtur prezenca e lartë e athozoan (një lloj knidari) në pjesët me *Cymodocea*.

Në ujrat e cekëta të kësaj zone janë regjistruar dy lloje të panjohura: prani e vogël e barërave detar (*Halophila stipulacea*), brenda parcelës me *Cymodocea* në pjesën Juglindore në 1-2 m thellësi, dhe alga hardhi (*Caulerpa racemosa* var. *cylindracea*), në pjesën Perëndimore në 4 m thellësi.

Hyrjet e ujërave të ëmbla janë të pranishëm në bregdetin e pjesës Juglindore dhe kanë gërryer bregdetin, duke krijuar shpella të vogla dhe të çara. Pak më tutje në Veri, në bregun Lindor, është i dukshëm ndikimi i ujërave të ëmbla, me anë të një brezi të sedimenteve (zhavorrit dhe rërës) që shtrihet nga bregdeti e deri në 15 m thellësi në fund të detit.

Shpërndarja e livadheve me *Posidonia* tregon një shumëllojshmëri në kufijtë e sipërm dhe të ulët të thellësisë së zonës. Kufiri i saj i sipërm varion nga 3.7 m në bregun lindor deri në 6-7 m në bregun perëndimor të kësaj zone. Ndërsa kufiri i thellësisë më të ulët varion nga 21-28 m. Në pjesën më të madhe, mbulimi dhe dendësia e livadheve me *Posidonia* duket e lartë deri në thellësinë 12 m.

Degradimi dhe fragmentarizimi i livadhit është më i dukshëm në thellësinë 13-16 m. Njollat me *matte morte* (bimë të *Posidonia*-s të vdekura) janë relativisht të bollshme brenda livadhit, midis thellësisë prej 11-18 m. Degradimi më i lartë i livadhit ka rezultuar në pjesën Veriperëndimore, ku fragmente të mëdha të zhveshura dhe *matte morte* kryqëzojnë livadhin nga 9-16 m thellësi. Në ujrat e cekët të kësaj pjese, në thellësinë 5 m, *Cymodocea* dhe *Caulerpa*, shpesh janë rritur në *matte*, në afërsi të kufirit të sipërm të livadhit me *Posidonia*.

Në bregdetin Perëndimor të Kalasë mungojnë livadhe me *Posidonia*, ndoshta për shkak të thellësisë së menjëhershme dhe shpatit shumë të pjerrët. Në këtë zonë janë gjetur edhe algat photophilice deri në 18 m thellësi. Ndërsa *Posidonia* është gjetur në pjesë të vogla në shkëmbinj në 23 m thellësi, ku gjendej i rrallë dhe me gjethe të shkurtër.

Kryesisht në pjesën Veriore dhe Perëndimore, shoqërimet e makroalgave, sfungjerëve dhe ascidian janë relativisht të zhvilluara mirë në livadhet me *Posidonia*, që është gjithashtu karakterizuar me një mbulesë të lartë e organizmave epibiont dhe algave mucilagjinose.

Disa mikro-habitate janë regjistruar më në thellësi, nën kufirin e poshtëm të livadheve *Posidonia*, deri në 70 m thellësi. Circalitorali në pjesën e sipërme menjëherë nën livadhin me *Posidonia* deri në 30 m thellësi, karakterizohet nga funde të buta të zhveshur, funde të buta me macroalga, *matte morte* të mbuluara me macrolaga, *matte morte* të mbuluara nga sedimente dhe funde të buta të mbuluara nga molusqe deti të ngordhura. Nga 30-56 m thellësi, përveç disa mikro-habitatëve të përmendura më lartë, formacione pre-koraligjenë dhe koraligjenë, është rregjistruar dhe një pasuri e

lartë e specieve të makroalgave, sfungjerëve (*Agelas*, *Axinella*), knidarëve (*Parazoanthus*, *Caryophyllia*) dhe ascidianëve. Fundet e butë me gjethe dhe barëra detar nën dekompozim, ascidian, sfungjerë, dhe funde të buta të zhveshura janë të zakonshme në thellësinë 40-50 m. Në thellësitë më të ulëta, deri në 70 m fundet e butë janë më homogjenë me zona të zhveshura dhe me pak prani të sfungjerëve dhe ascidian.

c. Zona Jugore: Gadishulli i Panormës-Kepi i Spinarasit. Mediolorali karakterizohet nga një prani e vazhdueshme e algave *Cystoseira* amentacea dhe fotofileve të tjera, që ishin shumë evidente deri në 6 m thellësi, të dominuara nga *Padina*, *Acetabularia* dhe *Dyctyota*.

Për shkak të thellësisë së menjëhershme dhe shpateve shumë të pjerrët në pjesën Perëndimore të zonës, livadhet me *Posidonia* fillojnë në 11 m thellësi në pjesën Veriore dhe në thellësi 13 m në pjesën Veriperëndimore. Kufiri më i ulët i livadheve në këtë zonë është regjistruar në 20 m thellësi.

Në pjesën qendrore dhe lindore të zonës kufiri i sipërm i livadhit me *Posidonia* është i pranishëm në 7 m thellësi, ndërsa kufiri më i ulët është në 19 m thellësi. Në pjesën Lindore është regjistruar një fragmentim i lehtë i livadhit në 12 m thellësi.

Në pjesën Lindore, pranë kufirit më të ulët të *Posidonias*, në 18-19 m thellësi, janë të pranishme formacionet coralligjenë, të dominuar nga macroalgat dhe sfungjerët nga gjinia *Axinella*, *Agelas* dhe *Spongia*. Në pjesën qendrore, poshtë livadheve me *Posidonia*, në 22-23 m thellësi, shtrati është i mbuluar nga *matte morte* dhe sedimente të buta e të zhveshura (pa makro vegjetacion).

Gjithashtu, në pjesën Veriperëndimore të zonës janë regjistruar formacionet koraligjene me diversitet të lartë të sfungjerëve dhe makroalgave në 31-33 m thellësi. Në pjesën qendrore dhe Lindore, në 30-32 m thellësi, fundi përbëhet nga sedimente të buta homogjene, pa makro vegjetacion.

d. Habitatet detare dhe specie me interes të konservimit

Vëmendje e veçantë i është kushtuar habitatëve të rrezikuara të Mesdheut dhe specieve me interes të konservimit që janë publikuar në dokumentetet në vijim:

- “Libri i Kuq” Mesdhetar i bimësisë detare, bashkësitë dhe peizazhi i detit të Mesdheut (UNEP/IUCN/GIS, 1990).
- Direktiva e Habitatëve (92/43) EU, me shtojcat:
 - I- Speciet Natyrore të Habitatëve në Interes të Komunitetit;
 - II- Speciet e kafshëve dhe bimëve në Interes të Komunitetit;
 - III- Speciet rreptësisht të mbrojtura;
 - IV- Speciet për të cilat shfrytëzimi është i rregulluar.
- Konventa e Barcelonës (1995) lidhur me Protokollin, përsa i përket Zonave Veçanërisht të Mbrojtura dhe Diversitetit Biologjik në Mesdhe, me shtojcat:

II- Specie të rrezikuara ose të kërcënuara;

III- Speciet për të cilat shfrytëzimi është i rregulluar

- Takimi i Alghero (1995) mbi biodiversitetin bregdetar dhe detar në Mesdhe.
- Konventa e Bernës (1996), me anekset:
 - I- Specie të florës të mbrojtura në mënyrë rigorozë;
 - II- Specie të faunës të mbrojtura në mënyrë rigorozë;
 - III- Specie të faunës të mbrojtura.
- Lista e Kuqe Kombëtare e florës dhe faunës së Shqipërisë (2013).

Ndër habitatet më të ndjeshme të Mesdheut (UNEP, RAC/SPA.1997) duhen përmendur *Lithophyllum byssoides* (të ndjeshëm ndaj hidrokarbureve) për zonat mediolitorale, komunitetet *Cystoseira* si një indeks hidrodinamik në zonën e sipërme littorale dhe livadhet me *Posidonia oceanica*, në zonën infralitorale.

Shoqërimet me *Lithophyllum byssoides*

Në zonat mediolitorale shfaqen pllaka të bardha, të kuqe të zbehta dhe jastëk të rhodophytes gëlqeror të *Lithophyllum byssoides*. Habitatet tipike të pellgut të Mesdheut përfshijnë detin Adriatik janë tregues të cilësisë së lartë të ujit. Statusi Ndërkombëtar: «Libri i Kuq» Mesdheut (habitate të rrezikuara), dhe Direktiva e Habitaveve EU 92/43 (Shtojca I, shkëmbinj të nënujorë); Takimi Alghero (habitate të rrezikuara); Konventa e Barcelonës (Shtojca II); Konventa e Bernës (Shtojca I, mbrojtja e rreptë e florës).

Statusi Kombëtar: Lista e Kuqe e Florës dhe Faunës (2013) EN B1.

Shoqërimet me *Cystoseira amentacea* var. *spicata*

Karakteristikat e këtij brezi janë vëzhguar në disa fusha shumë të ekspozuar shkëmbore, 0 deri në 1 m thellësi. Habitat shumë kompleks, biodiversiteti i lartë strukturor dhe funksional. Indikatorët BIO në një nivel të lartë përsa i takon cilësisë së ujit.

Statusi Ndërkombëtar: «Libri i Kuq» i Mesdheut. Direktiva e Habitaveve EU 92/43 (Shtojca I, shkëmbinj të nënujorë). Takimi Alghero. Konventa e Barcelonës (Shtojca II). Konventa e Bernës (Shtojca I, mbrojtja e rreptë e florës).

Statusi Kombëtar: Lista e Kuqe e florës dhe faunës (2013) VU B2C.

Livadhet me *Posidonia oceanica*

Ky komunitet endemik në detin Mesdhe përfaqëson kulmin e shtretërve fundorë të butë infralitoral dhe ndër habitatet më të rëndësishëm të Mesdheut. Ruajtja e tyre është një prioritet i lartë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Statusi Ndërkombëtar: «Libri i Kuq» i Mesdheut; Direktiva e Habitaveve (Shtojca I: *habitati prioritet); Konventa e Barcelonës (Shtojca II); Konventa e Bernës (Shtojca I, mbrojtja e rreptë e florës).

Statusi kombëtar: Lista e Kuqe e florës dhe faunës (2013) VU A2d.

Shoqërimet me *Cymodocea nodosa*

Ky fanerogam i rëndësishëm, kolonizon rërën dhe baltë-rërën fundore. Nganjëherë zëvendëson rënien e livadheve me *Posidonia oceanica*, por në zonën e mbrojtur është i pranishëm vetëm në një sipërfaqe të vogël, kryesisht në ujërat e cekta të gjirit.

Statusi Ndërkombëtar: «Libri i Kuq» i Mesdheut; Konventa e Bernës (Shtojca I, mbrojtja e rreptë e florës). (Shih aneksin 4 Lista e specieve të rregjistruara në zonën e Porto Palermos, sipas statusit të kërcënimit të Listës së Kuqe të Florës e Faunës së Egër në Shqipëri dhe Aneksin 5 Lista e specieve detare me rëndësi ndërkombëtare për Porto Palermon, të listuara në Konventat më të rëndësishme.

Në zonën e Porto Palermos-Llamani është gjetur një diversitet i madh peshku, por ato më të zakonshmet janë: *Chelon sp.*, *Mullus surmulletus*, *Diplodus sp.*, *Coris julis*, *Serranus cabrilla*, *Oblada sp.*, *Chromis sp.*, etj. Brenda dhe përreth gjirit të Porto Palermos-Llamani takohen 26 lloje të peshqëve. (Aneksi 6: Lista e llojeve të peshkut ekonomikisht të rëndësishëm).

Lista e disa prej llojeve me rëndësi ndërkombëtare, si specie të rralla ose të rrezikuara që kërkojnë mbrojtje dhe ruajtje të veçantë të habitatit të tyre, sikurse është dhe parashikuar në disa marrëveshjeve dhe konventa ndërkombëtare, paraqitet si më poshtë:

- *Hippocampus hippocampus* - Short snouted seahorse - Kal deti turishkurtër;
- *Isurus oxyrinchus* - Shortfin mako - Peshkaqen tonil
- *Lamna nasus* - Porbeagle - Tonil
- *Rostroraja alba* - White skate - Raxha
- *Sciaena umbra* - Brown meager - Korb i zi
- *Sphyrna zygaena* - Smooth hammerhead - Peshk karabiner
- *Syngnathus abaster* - Black-striped pipefish - Gjilpërëza shiritazezë
- *Umbrina cirrosa* - Shi drum - Korb i bardhë
- *Xiphias gladius* - Swordfish - Peshku shtizë.

Lista e disa nga llojet e huaja/invazive që shfaqen në Gjirin e Palermos-Llamani:

- *Caulerpa* (*Caulerpa racemosa* var. *cylindracea*)
- *Halophila stipulacea*
- Gaforre (*Percnon gibbesi*).

2.1.2 Vlerat social-ekonomike

Himara⁶ është konsideruar vendbanimi kryesor për numrin e banorëve, familjeve dhe tokës bujqësore. Mjaft nga fshatrat e zonës së Himarës: Palasa, Dhërmiu, Ilias, Vunoi dhe Qeparo janë të shpërndarë përgjatë rrugës kombëtare bregdetare. Ndërsa dy fshatrat e tjerë, Piluri është i vendosur në ultësirë e malit të Çipit dhe Kudhësi i vendosur në kodrinën e malit të Gjinvlashit.

Struktura e moshës në zonën e studimit është e dominuar nga një popullsi e re. Kjo ndikon në moshën mesatare të popullsisë, e cila është 31.2 vjeç. Ky është një potencial shumë i mirë për zhvillimin e zonës së projektit. Familja e mesme, me një mesatare prej 3.9 anëtarësh dominon në aspektin e strukturës për përbërjen familjare, dhe pritet që rritja e popullsisë në zonë të jetë normale. Zona ka patur dhe ka ende një jetë dinamike sipas popullsisë. Sipas të dhënave të fundit publike, norma mesatare vjetore e rritjes së popullsisë, në 10 vitet e fundit, rezulton në 6.3 % për vit .

Ekonomia e zonës së mbrojtur mund të fokusohet më së shumeti në sektorët e më poshtëm:

- a. Përdorimi i territorit, ndërtimet dhe shërbimet;
- b. bujqësia e blegtoaria;
- c. sektori i peshkimit;
- d. eko-turizmi dhe turizmi kulturor.

Zhvillimi i qëndrueshëm i përdorimit të territorit është thelbësor, brenda parkut natyror. Përparësi do t'i jepet ndërtimeve të integruara dhe shërbimeve për qëllime të pritjes së vizitorëve dhe pushuesve. Kjo infrastrukturë do të bëhet në përshtatje me mjedisin, vizionin dhe objektivat e menaxhimit, konform standarteve dhe normave të lejuara, sipas ngarkesës, tipit të ndërtimeve dhe kapacitetit mbajtës mjedisor të zonës së mbrojtur.

Pjesa relativisht e lartë e tokës private e ndarë në përmasa të parcelave relativisht të vogëla, dominon aktualisht në rajon. Hapësirat e parcelave publike të zonave ushtrake kanë garantuar deri tani mbrojtjen e një hapësire të madhe tokë. Këto prona të ushtrisë përbëjnë zonat parësore për ndërtime e shërbime turistike me përfitim, përfshirë edhe Porto Palermon.

Përdorimi tradicional i këtyre burimeve natyrore ofron mundësinë e rritjes së të ardhurave për popullsinë vendase. Tradita e produkteve bujqësore, nënprodukteve blegtoarale dhe të peshkimit përbëjnë një prej burimeve kryesore financiare për popullsinë vendase. Sektori i peshkimit është burimi kryesor i të ardhurave lokale së bashku me turizmin.

Parku Natyror konsiderohet një zonë me potencial të lartë turistik. Ekoturizmi dhe turizmi kulturor janë

faktorë të rëndësishëm të zhvillimit të mundshëm të qëndrueshëm dhe rritjes së mëtejshme të nivelit ekonomik për komunitetet vendore zonës së mbrojtur.

Bashkia Himarë ka miratuar dokumentin Politik për Zhvillimin Territorial (PZHT) dhe Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV). Vizioni për zhvillimin territorial e cilëson turizmin bazë të zhvillimit lokal dhe burimet natyrore e kulturore bazë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm me standardet e cilësisë më të lartë. Ky plan është i bazuar në dokumentin politik të Programit të Menaxhimit të Integruar dhe të Pastrimit të Zonës Bregdetare, të përgatitur nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.

Sipas Bashkisë Himarë, parashikohen të zhvillohen forma të buta të turizmit masiv dhe të qëndrueshme, në lidhje me burimet natyrore dhe kulturore. Në zonën e Porto Palermos është planifikuar ndërtimi i një porti turistik dhe resorti në zonën ekzistuese ushtarake. Vlerat e peizazhit të zonës trajtohen me rëndësi të veçanta, dhe të mbrojtura nga ndërtesa e zhvillimet pa kriter.

Zona e Himarës ka një shumëllojshmëri të atraksioneve turistike (trashëgimisë kulturore, burimeve natyrore, peizazheve, traditave dhe ushqimit), që i japin mundësi për të zhvilluar forma të ndryshme të turizmit duke e integruar me pjesët e tjera të rajonit. Në zonën e Porto Palermos janë ndërtuar 10 shtëpi njëkatëshe, të cilat përdoren kryesisht nga turistët huaj.

Kryesisht vizitorët e preferojnë zonën për qëllime pushimi e argëtimi dhe strehohen në hotele.

Ndjenja e një menaxhimi të integruar të bregdetit dhe ujërave detare qëndron në faktin se cilësia e ujërave në bregdet mbështetet kryesisht në mënyrën sesi veprimtaria menaxhohet, sidomos në rastet e hoteleve, restoranteve apo banesave.

Shërbimet turistike dhe të infrastrukturës nuk ekzistojnë ose janë të pamjaftueshme. Vënia në dispozicion e informacionit, sidomos në internet shpesh është e fragmentuar dhe e parregullt.

2.1.3 Vlerat kulturore

Turizmi me interes të veçantë është i bazuar mbi trashëgiminë natyrore dhe identitetin kulturor, duke e konsideruar zonën një destinacion turistik. Në zonë ka disa objekte kulturore dhe historike, të cilat së bashku me objektet fetare krijojnë një peizazh interesant dhe tërheqës.

Porto Palermo formon një qendër relativisht të rëndësishme urbane me specifikën e tij historike, gjeografike dhe kulturore e që ka patur një ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e identitetit lokal, dhe rolit të tij në kontekstin rajonal. Është gji i mbyllur, pak i zhvilluar e me një bazë ushtarake detare, në pjesën Veriore.

⁶ Thanas Goga&Franka Paloka "Analiza socio-ekonomike dhe studimi mbi zhvillimin e turizmit", Janar, 2014.

Në Porto Palermo, gadishulli i vogël, ku gjendet dhe Kalaja e Ali Pashës, e ndan gjirin në dy pjesë. Porto Palermo përbën një nga monumentet më të rëndësishëm kulturor në Jug të Shqipërisë dhe është një destinacion i rëndësishëm turistik. Në pjesën Veriore të gjirit është e vendosur baza ushtarake, e cila është një nga arsyet e paprekshmërisë së zonës nga ndërtimet pa leje.

Përveç kësaj, prania e ndërtesave të braktitura ushtarake dhe pajisjeve, dëmton vlerën e peizazhit të parkut dhe ruajtjen bukur të Kalasë së Ali Pashës. Kalaja në vetvete nuk është e mobiluar për përmbushjen e vlerës turistike dhe duke mos qenë në ruajtje të vazhdueshme, është e ekspozuar ndaj akteve të vandalizmit dhe shkatërrimit.

Vendet e trashëgimisë kulturore në pjesën malore të rajonit janë më të lëna pas dore, për shkak të përqendrimit të veprimtarive të turizmit në bregdet. Nëse kjo lihet pas dore në mënyrë të vazhdueshme, mund të çojë në shkatërrimin e plotë të monumenteve dhe në humbjen e pakthyeshme të tërheqjes së turizmit kulturor në zonat e brendshme.

2.2 Vlerësimi i Kornizës Institucionale

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është institucioni kryesor përgjegjës për administrimin e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura në Shqipëri, nëpërmjet Administratave të Zonave të Mbrojtura në qarqe. AKZM ka për mision: “Ruajtjen e natyrës, biodiversitetit dhe ZM, nëpërmjet zbatimit të praktiave më të mira ndërkombëtare e kombëtare të përdorimit të qëndrueshëm dhe promovimi i vlerave të tyre me pjesëmarrjen e palëve të interesuara”.

Institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal të përfshira për menaxhimin e ZM janë:

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), është përgjegjëse për përgatitjen e instrumentave të planifikimit të territorit dhe turizmit. Këto plane miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT).

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), është përgjegjëse për investimet në impiantet e menaxhimit të mbetjeve, furnizimin me ujë dhe kanalizimeve.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MZHRAU), është i rëndësishëm për administrimin e burimeve ujore që përdoren për ujitje dhe për peshkim.

Ministria e Kulturës (MK), zhvillon dhe zbaton strategjinë sektorale të trashëgimisë kulturore dhe siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Ministria e Mbrojtjes (MMb), administron zonën ushrike në Gjirin e Porto Palermos.

Bashkia e Himarë kryen funksionet në bazë të ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (2000). Është përgjegjëse për hartimin e planeve

vendore mjedisore në përputhje me strategjitë kombëtare mjedisore. Gjithashtu ka të drejtë të ndërmarrë çdo nismë për zhvillimin ekonomik në interes të banorëve, me kusht që këto veprimtari të mos bien ndesh me politikat themeltare qeverisëse.

Komuniteti, organizatat jofitimprurëse, shoqëria civile, biznesi, pronarët, luajnë një rol aktiv në fushën e ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve natyrore.

2.3 Vlerësimi i Kërcënimeve

Vlerësimi i kërcënimeve, në zonën e peizazhit të mbrojtur, është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me aktorët vendorë. Vlerësimi i situatës aktuale është arritur si rezultat i studimeve shumëdimensional në terren, i seminareve të organizuara me përfaqësues të administratës së shërbimit pyjor, të bashkisë, OJF-ve mjedisore, bizneseve private dhe palëve të tjera të interesuara.

Gjithashtu, vlerësimi i kërcënimeve është bazuar në analizën e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (S.W.O.T) në zonën e mbrojtur. Kjo analizë ka shërbyer për të theksuar potencialet e zonës; për të evidentuar aspekte që duhet të përmirësohen ose të shmangen në menaxhimin e ardhshëm; për të përcaktuar kërcënimet ekologjike dhe social-ekonomike; mundësitë për zhvillim në të ardhmen, dhe për të krijuar një panoramë të prioriteteve kryesore në zonën e mbrojtur.

Ndikimet e zhvillimit bregdetar janë ndër kërcënimet kryesore, të intensifikuara gjatë viteve të fundit. Ky ndryshim i rëndësishëm në rritjen demografike bregdetare kontribuon në degradimin e peizazhit; në humbjen dhe fragmentimin e habitateve; përkeqësimin e gjendjes së specieve vulnerabël apo të rrezikuara; shkatërrimin e vegjetacionit, pyjeve e kullotave nga zjarret apo dhe futja e specieve invazive. Dukuri me të cilat ballafaqohet dhe zona e mbrojtur.

Urbanizimi bregdetar përfaqëson masën e rritjes së popullsisë dhe të veprimtarive social-ekonomike me pasoja shumë të rënda, shumica e të cilave janë të lidhura fort me shfrytëzimin turistik të territorit.

Ndonëse, në përmasa të vogëla, zona e mbrojtur ndeshet me tendencën e zhvillimit turistik si brenda territorit dhe në afërsi të saj, me shtim të numrit të përdoruesve të tokës dhe burimeve natyrore. Në zonat e përdorimit aktual për turizëm, në gjirin e Llananit dhe të Porto Palermos, vrëhet mungesa e sistemeve të menaxhimit të mbeturinave, të ujërave të zeza dhe të ujit të pijshëm. Pra, rritja e shkarkimit të mbeturinave dhe të ujërave të ndotura dhe të patrajtuara në bregdet-det.

Gjithashtu, veprimtaritë e ndërtimit janë jashtë kontrollit, veçanërisht përgjatë bregdetit, përfshi dhe paqartësinë në titullin e pronësisë. Sikurse në të gjithë bregdetin Shqiptar, ndërtimet pa leje dhe të pakontrolluara turistike kanë ndodhur edhe në zonën e Porto Palermos,

por me një presion më të ulët, në krahasim me zonat e afërta, të tilla si: Himara. Veprimtaritë e ndërtimit përgjatë bregdetit shkaktojnë ndryshim të përhershëm, shkatërrimin e habitateve natyrore, rënie të madhësisë e fragmentim të habitateve dhe shëmtim të peizazhit.

Ndërtimet e fortifikimet ushtarake të dëmtuara, materialet e mbeturinat e ndryshme të shpërndara kudo, përbëjnë problem për zonën e mbrojtur, kryesisht në Porto Palermos dhe në gadishullin e Panormës.

Përqendrimi i investimeve turistike në bregdet, në vitet e fundit, nuk janë paraprirë ose shoqëruar nga infrastrukturën e nevojshme si furnizimi me ujë, kanalizimi i ujërave të zeza, mbledhja, transporti dhe eliminimin higjienik të mbetjeve të ngurta. Këto probleme kanë pasojat të rënda për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, duke përfshirë rreziqet e larta të shëndetit për njerëzit, kafshët dhe cilësi të ulët të nivelit të jetës. Më të theksuar këto në Gjirin e Porto Palermos, por dhe në zonat ku janë ndërtuar qendrat e pritjes së vizitorëve si në Llamant dhe tek gadishulli i Panormës.

Veprimtaritë e turizmit janë një element kyç në urbanizimin e bregdetit (zona të reja apo zona të rikontvertuara) prekin dhe zonën e mbrojtur, të cilat nxisin rritjen e ekonomisë lokale, por që përballen me vështirësi në menaxhim. Të tilla dukuri vrehen në ish ndërtesat e ushtrisë, stanet, apo hapja e pikave të reja për pushime, të cilët ndodhen brenda sipërfaqes së zonës të mbrojtur.

Mbishfrytëzimi dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i rezervave natyrore (peshkim, kullotë, bimë mjekësore, gjuetia), shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë gjuetinë ilegale të tyre, mbipeshkimi dhe përdorimi i mjeteve e metodave të ndaluara janë të prekshme në zonën e mbrojtur dhe rreth saj.

Prerjet e paligjshme dhe pa kriter i shkurreve dhe i bimësisë mesdhetare që gjenden në ZM, përbëjnë kërcënim serioz për ruajtjen e zonës së mbrojtur, ndonëse në zonën e Portopalermos-Llamani pyjet mungojnë. Po kështu, kullotja e bagëtive, llojet dhe numri i tyre mbi kapacitetin mbajtës kullor, mbetet shqetësim dhe ka ndikim negative, duke shkaktuar zhdukjen dhe copëzimin e habitateve, kërcënim për speciet e të florës dhe faunës.

Kodrat rreth gjirit të Porto Palermos-Llamani janë djegur shpesh nga barinjët, të cilët besojnë se djegja e kullotave është mënyra më efektive dhe më e lehtë për t'i përmirësuar ato. Ky është një risk i lartë, i herëpashershëm që mund të pengojë rishfaqjen e bimësisë natyrore, duke përfshirë këtu dhe speciet e rralla, të rrezikuara dhe që janë me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjuetia brenda zonës, por në mënyrën si zhvillohet, ka qënë një nga faktorët kryesorë që kanë shkaktuar

pakësimin e popullatave të kafshëve dhe shpendëve të gjahut si Lepur i egër (*Lepus europaeus*), Dhëlpër (*Vulpes vulpes*), Turtulli (*Streptopelia turtur*), Shapka (*Scolopax rusticola*), thëllëzës së malit (*Alectoris graeca*), Thëllëzës së fushës (*Perdix perdix*), Pëllumba të egër (*Columbia livia*), në disa guva të gadishullit të Panormës, disa lloje të rosave të egra, etj. Sjellja e gjuetarëve dhe e komunitetit vendas në përgjithësi nuk është shumë miqësore.


Prania e marinë-kulturës, në zonën e mbrojtur, ushtron një trysni të lokalizuar dhe relativisht të fortë në mjedis në varësi të zonës dhe zhvillimit të saj. Gjiri i Porto Palermos është i përshtatshëm për zhvillimin e marinë-kulturës detare. Gjiri është i mbrojtur, relativisht i thellë, dhe mundëson zhvillimin e saj. Aktualisht, në Gjirin e Palermos funksionojnë tri qendra të rritjes së peshkut (marinë-kulturë). Përdorimi i ushqimit, antibiotikëve dhe akumulimi i eskrementeve nga peshqit mund të kontribuojnë ndotjen dhe uljen e cilësisë së ujit. Kultivimi i peshkut ushtron trysni shtesë mbi burime peshkore dhe për disa peshq jep një rezultat të ulët duke konsideruar volumin dhe peshën e ushqimit që nevojitet për të ushqyer peshkun e kultivuar.


Njëherazi në zonën e Porto Palermos-Llamani, peshkimi i paligjshëm është kërcënim serioz për peshkun, krustacet dhe komunitete të tjera të habitateve bregdetare dhe detare. Situata e peshkimit të paligjshëm është ende larg të qenit nën kontrollin e duhur. Mbledhja e paligjshme dhe shkatërruese e daterit (*Lithophaga*), ka shkaktuar dëmtimin e brigjeve shkëmbore në zonën e Porto Palermos.

Zona e mbrojtur nuk ka ndikim nga katastrofat natyrore, më tepër do të ketë lidhje me ndryshimet e klimës së rajonit. Ndryshimi i klimës është një kërcënim i njohur dhe duhet të konsiderohet pjesë e sfidës së zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global. Zona e mbrojtur mund të preket nga thatësira, zjarre, valët e të nxehtit, pakësim të vegjetacionit dhe të rezervave ujore. Kësisoj dhe flora e fauna duhet t'u përshtaten kushteve të ndryshuara, në mënyrë që të mund të ndryshojë struktura e ekosistemit. Specie të reja të huaja mund të shfaqen, duke i kolonizuar dhe duke shkaktuar zhdukjen e specieve të tjera.

është e rëndësishme marrja në konsideratë e ndjeshmërisë së sistemeve detare dhe bregdetare dhe balancimi i aspekteve sociale, ekonomike dhe kulturore të grupeve tradicionale të interesit në një kontekst të tillën trysni, për të garantuar si aftësinë ripërtëritëse të këtyre ekosistemeve, ashtu edhe promovimin e praktikave tëshfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve të ripërtëritshme.

Zona e mbrojtur, ndjeshmëria e burimeve të saj natyrore dhe kulturore ndikohet në pjesën më të madhe edhe nga lehtësia e mundësisë së hyrjes për të realizuar veprimtari tëpaligjshme, prania e një infrastrukture të favorshme, kërkesa e fortë e biznesit për burimet natyrore dhe të pamundësisë për tëkontrolluar territorin.





III. MENAXHIMI ZONËS SË MBROJTUR

3.1 Vizioni dhe Objektivat

3.1.1 Vizioni, misioni dhe funksionet

Të bëhet një destinacion i rëndësishëm për konservimin e biodiversitetit, i njohur për peizazhin dhe mjediset e tij tokësore, bregdetare e detare, ku ndërveprimi i njerëzve me natyrën konsiderohet trashëgimi dhe identitet natyror dhe kulturor, ku ruajtja e integritetit të këtij bashkëveprimi është jetike për ruajtjen e zonës e të këtyre vlerave, nëpërmjet mirëintegritimit në një ekosistem që siguron mirëqenie për banorët tij.

Misioni

Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit, nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm me banorët, dhe forcimi i bashkëpunimit me palët e interesuara.

Funksionet

a. Mbrojtja e Natyrës

Territori përmban vise të tëra të begatshme me vlera të shumta të biodiversitetit dhe estetike. Ky funksion përfshin ruajtjen e ekosistemeve detare e bregdetare, të habitateve dhe të specieve të kërcënuara e të rrezikuara. Mbrojtja e tyre nuk nënkupton ndalimin e shfrytëzimit të vlerave natyrore, por përdorimi të bëhet në pajtim me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së mbrojtur.

b. Turizmi

Territori posedon kushte të jashtëzakonshme të zhvillimit të veprimtarive posaçërisht për sportet ujore detare, por edhe për pushim e rekreacion të qytetarëve dhe pushuesve në natyrë. Kushtet e volitshme klimatike, konfiguracioni, pasuritë historike e kulturore mundësojnë zhvillimin e një turizmi gjatë tërë vitit.

c. Funksioni kulturor

Bukuritë natyrore dhe veshja karakteristike, doket dhe zakonet, polifonia e vallja e afirmuar dhe të njohura të zonës së Bregut, paraqesin përjetim të jashtëzakonshëm kulturor për çdo vizitor e pushues. Ka një numër të madh të objekteve të vjetra të kultit dhe monumente me rëndësi historike të popullatës vendase.

d. Funksioni shkencor

Territori ka tipare të shumta burimore të ruajtura që paraqesin objekte mjaftë interesante për hulumtime shkencore dhe për njohjen e ligjshmërive të zhvillimit të

natyrës. Këtu para së gjithash vlen për llojet endemike dhe relikte të florës dhe të faunës detare e bregdetare, dhe të njohurive jo të plota në këtë fushë.

e. Funksioni edukativ

Territori paraqet një vend mjaft të përshtatshëm për veprimtaritë konkretizuese edukative, ndërgjegjësuere dhe informuese. Pasuria me tipet e habitateve, të specieve të florës dhe të faunës, vendbanimet, popullsia, historia e bujshme e këtij rajoni janë kontribut i rëndësishëm në procesin edukativ të rinisë shkollore dhe pjesës së re të popullatës, por dhe për vizitorët.

Objektivat e konservimit dhe menaxhimit duhet të përcaktohen qartë, të përbëjnë bazën për vlerësimin e mjaftueshmërisë së masave të marra, të efikasitetit të zbatimit në rishikimin planit të menaxhimit dhe të sigurojë mbrojtjen veçanërisht të:

- a. Tipeve përfaqësuese të ekosistemeve detare-bregdetare me përmasa të përshtatshme, të pranueshme për të siguruar mbijetesën afatgjatë të tyre dhe të ruajë shumëllojshmërinë biologjik të tyre;
- b. habitateve që janë në rrezik për t'u zhdukur në zonat e shpërndarjes natyrore të tyre apo që kanë një zonë natyrore shpërndarjeje të reduktuar si pasojë e kthimit prapa në gjendje të pazhvilluar ose për arsye të zonave të kufizuara të tyre;
- c. habitateve kritike për të garantuar mbijetesën, riprodhimin, përtëritjen e specieve endemike, të rrezikuara dhe të kërcënuara të florës e faunës;
- d. zonave me rëndësi të veçantë për interesa shkencore, estetike, kulturore dhe edukative.

3.1.2 Programet dhe Objektivat afatgjatë të menaxhimit

Mbështetur në këtë vizion, tek funksionet, burimet dhe mjediset kyçe detare-bregdetare të identifikuar dhe në çështjet kritike, objektivat afatgjatë për menaxhimin e Zonës së Mbrojtur, përqendrohen sipas këtyre programeve:

1. Forcimin e administrimit dhe të menaxhimit;
2. Ruajtjen ekosistemit, habitateve, biodiversitetit dhe peizazhit detar e bregdetar;
3. Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore bregdetare-detare përfshi dhe ato historike e kulturore;
4. Zhvillimin e veprimtarive të qëndrueshme çlodhëse, argëtuese, sportive e shëndetësore;

- Promovimin e vlerave, monitorimin dhe kërkimin shkencor, ndërgjegjësimin dhe edukimin.

Objektivat afatgjata përbëjnë bazën për menaxhimin e ZM, pasi ato janë synime specifike të përcaktuara një periudhë 10 vjeçare dhe synojnë:

Programi 1: Forcimi i administrimit dhe i menaxhimit të zonës së mbrojtur

Objektivi: Për të siguruar administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit unik detar, bregdetar, të peizazhit dhe për të mirëmbajtur proceset kryesore ekologjike të zonës së mbrojtur, duke lejuar ndërkohë veprimtaritë sociale, ekonomike dhe ekoturistike afatgjata, në përputhje me vizionin e saj.

Programi 2: Ruajtja e ekosistemit, habitateve, biodiversitetit dhe peizazhit detar e bregdetar

Objektivi: Për të siguruar konservimin afatgjatë të ekosistemit, habitateve, peizazhit detar e bregdetar të zonës së mbrojtur, veçanërisht të tipeve të habitateve dhe specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara.

Mbrojtja e shoqërimeve të formacionit Rryellit/Flomit (*Euphorbia dendroides*); bimësia e *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis*, dhe llojet relike subendemike si *Acis ionica*, *Athamanta macedonica*, *Brassica incana subsp. egea*, etj. Po kështu habitatet detare dhe specie me interes të konservimit si të *Lithophyllum byssoides* dhe livadhet me *Posidonia oceanica*. Vëmendje duhet të tregohet dhe për biocenozin e shpellave mediolitoral, shoqërimet e biocinosave të koralogjeneve, të disa prej llojeve me rëndësi ndërkombëtare si specie të rralla ose të rrezikuara të peshqëve, breshka e deti, foka, delfinët, etj.

Programi 3: Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore bregdetare-detare, përfshi dhe ato historike e kulturore

Objektivi: Për të siguruar forcimin e sistemit të menaxhimit dhe përdorimin afatgjatë të burimeve natyrore, të veçorive të peizazhit dhe të vlerave kulturore e historike, në përputhje me kapacitetin ekologjik të zonës së mbrojtur.

Më të spikatura për ZM që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe paprekshmëri janë: Kepi i Alpunit, plazhi i Llamani, Kepi i Kavadarit, Gjiri i Armeridhës, tuneli i ushtrisë, shpella, Gadishulli dhe Kalaja e Aliut, amforat, formacioni me Euphorbia, Kisha e Shën Nikollës, Gjiri i Shën Nikollës, Kepi i Panormisë, Gjiri i Gravës dhe Kepi i Spinarasit, etj.

Programi 4: Zhvillimi i veprimtarive të qëndrueshme çlodhëse, argëtuese, sportive dhe shëndetësore

Objektivi: Për të siguruar zhvillimin e veprimtarive ekoturistike, çlodhëse, argëtuese dhe shëndetësore, nëpërmjet nxitjes së komunitetit dhe të bizneseve, pa cënuar vizionin dhe objektivat e ZM, duke sjellë përmirësimin e cilësisë së jetesë së banorëve dhe të vizitorëve.

Zona e Himarës ka një shumëllojshmëri të atraksioneve turistike (trashëgimisë kulturore, burimeve natyrore,

peizazheve, traditave dhe ushqimit), që i japin mundësi për të zhvilluar forma të ndryshme të turizmit duke i integruar me pjesët e tjera të rajonit.

Programi 5: Promovimi i vlerave, monitorimi e kërkimi shkencor, ndërgjegjësimi dhe edukimi

Objektivi: Për të siguruar promovimin e vlerave mjedisore e kulturore, nxitjen e kërkimit shkencor, të monitorimit, të veprimtarive ndërgjegjësuere dhe informuese në procesin edukativ të rinisë, popullatës dhe për vizitorët.

3.1.3 Objektivat afatshkurtër të menaxhimit

Janë formuluar gjatë konsultimeve me të gjitha grupet përkatëse të interesit, dhe kontribuojnë në realizimin e vizionit, të objektivave afatgjatë dhe do të përcaktojnë veprimet specifike për ZM.

Për secilin nga objektivat afatshkurtër korresponduese janë identifikuar dhe u është llogaritur kostoja një sërë veprimesh për të siguruar realizimin e këtyre objektivave.

Objektivi 1: Krijimi i strukturave dhe forcimi i menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Zona e mbrojtur duhet menaxhuar në mënyrë të saktë, nëpërmjet krijimit të strukturave të përshtatshme, duke përfshirë grupet vendore të interesit në një proces të qëndrueshëm të pjesëmarrjes së tyre në mënyrë që të kontribuojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore. Kështu, do të ruhet ekuilibri i përshtatshëm ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të veprimtarive njerëzore.

Me përmbushjen e këtij objektiivi synohet:

- Të miratohet shpallja e rajonit të Gjirit të Palermos-Llamani, zonë e mbrojtur, me status “Rezervat Natyror i Menaxhuar (Park Natyror)”, kategoria e IV-t, IUCN.
- Të miratohet, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar Planin i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”.
- Forcimin e zbatimit të ligjit, planit të menaxhimit, masave të caktuara dhe i vlerësimit të veprimtarive njerëzore.
- Në mbështetje të strukturës dhe organikës së DSHP Vlorë (Qarku) të miratohet krijimi i administratës së peizazhit të mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”.
- Administrata, në bashkëveprim me institucionet e tjera vendore shtetërore, lokale, shoqërinë civile, OJF, biznesin dhe private, të hartojë programe për njohjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore të ZM.

6. Të rritet efektshmëria e sistemit të menaxhimit nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të planit të menaxhimit të ZM “Gjiri i Porto Palermos-Llaman”.
7. Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë, administratës së zonës të mbrojtur dhe grupeve të tjera vendore të interesit.
8. Të sigurohen mjetet e nevojshme të punës dhe të logjistikës për kryerjen e detyrës së personelit të administratës së zonës të mbrojtur.
9. Përcaktimi në terren i kufijve të ZM dhe i nënzoneve të menaxhimit.

Me përmbushjen e objektivit të mësipërme, priten rezultatet specifike të mëposhtme:

- a. Zonë të Mbrojtur të mbikqyrur dhe të menaxhuar në mënyrë profesionale dhe efektive nga administrata, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë dhe Komitetin e Menaxhimit.
- b. Staf i trajnuar në dispozicion të administratës dhe shkallë të lartë performance menaxhimi.
- c. Përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara në një proces të qëndrueshëm zhvillimi me pjesëmarrje dhe kontribut në konsolidimin e menaxhimit dhe të përdorimit të burimeve natyrore.

Objektivi 2: Mirëmbajtja dhe ruajtja e habitateve, biodiversitetit detar e bregdetar dhe peizazhit.

Mirëmbajtja e habitateve të larmishme të zonës së mbrojtur, ruajtja e larmisë së faunës dhe florës detare e bregdetare, të proceseve të veçanta natyrore dhe biologjike, të sistemeve mbështetëse të jetesës dhe ndërveprimit të mirë ndërmjet ekosistemeve (tokësore e detare).

Me përmbushjen e këtij objektiv synohet:

1. Të merret në konsideratë ndjeshmëria e sistemeve detare dhe bregdetare, balancimi i aspekteve sociale, ekonomike dhe kulturore të grupeve tradicionale të interesit për të garantuar aftësinë ripërtëritëse të këtyre ekosistemeve, dhe promovimin e praktikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve të ripërtëritshme.
2. Të merren masat e nevojshme për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe ekologjike ZM për vlerat e veçanta natyrore dhe kulturore, dhe për speciet e kërcënuara ose të rrezikuara të florës dhe faunës.
3. Të hartohen programe për konservimin e shumëllojshmërisë biologjike, për mirëmbajtjen e habitateve detare, bregdetare dhe tokësore së bashku me florën dhe faunën e tyre.
4. Të identifikohen dhe hartimi i inventarëve të komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike që konsiderohen të rëndësishëm për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

5. Të sigurohemi që diversiteti i specieve, i proceseve të ekosistemeve në zonën e mbrojtur të mos ndikohet negativisht nga veprimtaritë njerëzore.
6. Të promovohet mirëmbajtja e cilësisë së lartë të ujërave detare dhe të parandalohet degradimi dhe shkatërrimi i tyre.
7. Të mbrohen karakteristikat detare dhe bregdetare të një rëndësie ekologjike, gjeologjike, gjeomorfologjike, veçanërisht kepet, gjiret, shpellat, burimet dhe bota nënujore.
8. Të hartohen programe që rregullojnë futjen e çdo specije jo indigjene në zonën e mbrojtur, apo futjen e specieve gjenetiksht të modifikuara, si dhe futjen apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë në zonën e mbrojtur.
9. Të hartohen projekte teknike për parandalimin e përhapjes së specieve invazive dhe të restaurimit të specieve dhe habitateve të pushtuara prej tyre.
10. Të monitorohen komponentet e shumëllojshmërisë biologjike, të identifikohen proceset dhe kategoritë e veprimtarive, të cilat kanë apo kanë të ngjarë të kenë ndikime negative të rëndësishme në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike, dhe të monitorojnë efektet e tyre.

Me përmbushjen e objektivit të mësipërme, priten rezultatet specifike të mëposhtme:

- a. Pranimi nga palët e interesuara se ruajtja, rritja e bukurisë së parkut natyror, jetës së egër nëndetare dhe trashëgimisë kulturore, janë qëllimet primare dhe parimet drejtuese për të gjitha vendimet e menaxhimit që lidhen me ZM.
- b. Përmirësimin të ruajtjes, restaurimit dhe rritjes së pasurisë së mjedisit natyror, në mënyrë që bota e egër dhe sistemet ekologjike të zhvillohen mirë.
- c. Arritja e një ekuilibri dinamik dhe bashkëjetesë të qëndrueshme të veprimtarive të njerëzve lokale dhe natyrës.
- d. Ruajtjen e elementeve të ndjeshëm ekologjik bregdetar-detar nga shqetësimi dhe keqpërdorimi për interesa publike e private.

Objektivi 3: Zhvillimi i veprimtarive të qëndrueshme social-ekonomike-turistike

Sigurimi i shëndetit të mjedisit, i përfitimeve ekonomike dhe mundësive të barabarta sociale dhe ekonomike brenda zonës së mbrojtur.

Me përmbushjen e këtij objektiv synohet:

1. Të zbatohen format e zhvillimit dhe menaxhimit të veprimtarive, të cilat ruajnë integritetin natyror, social e ekonomik, gjenden e burimeve detare-bregdetare e kulturore në vazhdimësi dhe integrimin e veprimtarive tradicionale, kryesisht të peshkimit artizanal dhe ekoturizmin.

2. Të hartohen planet e programet për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike bregdetare e detare dhe integrimi i tyre në sektorët përkatës në nivel lokal apo dhe në politikat ndërsektoriale.
3. Sigurimi i mekanizmave të reja financiare që mund të rritin finacimet për rimëkëmbjen e natyrës duke ofruar një mënyrë për të përmirësuar kapitalin natyror dhe shërbimet e ekosistemit që lidhen me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore detare-bregdetare në përputhje me kapacitetin mbajtës mjedisor.
4. Të zhvillohen standartet të lehtësirave apo shërbimeve turistike që janë në harmoni me karakterin e ZM, infrastruktura që lidhet me menaxhimin e ZM duhet të ketë pamje të bukur, natyrore, të qetë dhe prezantues për identitetin e zonës së mbrojtur.
5. Planifikimi dhe rregullim të territorit nëpërmjet shfrytëzimit sa më racional të kësaj hapësirë nga njeriu në përputhje me kapacitete mbajtëse të saj.
6. Ndalimin e shkarkimit apo hedhjes së mbetjeve apo substancave të tjera që mund të dëmtojnë direkt ose tërthorazi integritetin e zonës e mbrojtur.
7. Rregullimi ose ndalimin e çdo veprimtarie ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit, të shtratit të detit apo nëntokës së tij brenda zonës së mbrojtur.
8. Rregullimi apo edhe ndalimin e çdo veprimtarie apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojnë gjendjen e konservimit të ekosistemit apo specieve apo që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore apo kulturore të zonës veçanërisht të mbrojtur.
9. Rregullimi apo ndalim të peshkimit e marinë-kulturës, gjuetisë së specieve të florës dhe faunës së egër, të daterit, koraleve dhe specieve të tjera të mbrojtura apo shkatërrimin e habitatit e të shkëmbinjëve si dhe çdo masë tjetër që ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së proceseve ekologjike e biologjike dhe të peizazhit.
10. Nxitjen gjerësisht të kujdesit nga vetë komuniteti, angazhimit për ruajtjen e biodiversitetit, të peizazhit dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore e kulturore, në kudër të zhvillimit të turizmit dhe të peshkimit të qëndrueshëm.
11. Të mbrohet cilësia e ujit detar-bregdetar përmes zhvillimit të infrastrukturës së sistemit të kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të zëza dhe ato të përdorura, për sigurimin e ujit të pijshëm, të menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, etj.

Me përmbushjen e objektivit të mësipërme, priten rezultatet specifike të mëposhtme:

- a. Arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të veprimtarive social-ekonomike në zonën e mbrojtur.

- b. Përmirësimi i shërbimeve të qëndrueshme ekonomike të ekosistemit dhe biodiversitetit detar e bregdetar.
- c. Promovimin e vlerave natyrore, sociale, ekonomike, turistike dhe kulturore, të përfitimit nga komuniteti, duke u kujdesur për ndikimet sociale dhe ekonomike në zonën e mbrojtur.
- d. Shtim të punimeve artizanale, shitja e ushqimeve dhe prodhimeve tipike të zonës, organizim të panairove, ekspozitave, festivaleve folklorike, manifestimeve historike me vlerë lokale.

Objektivi 4: Përdorimi për qëllime çlodhëse, argëtuese dhe ekoturistike.

Sigurimi dhe menaxhimi i përdorimit të zonës për qëllime çlodhëse dhe kulturore, në kuadër të bashkëfuzionimit të objektivave të mbrojtjes së natyrës me zhvillimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive ekoturistike.

Me përmbushjen e këtij objektivit synohet:

1. Të arrihet balancimi i aspekteve sociale, ekonomike, turistike dhe kulturore të grupeve tradicionale, duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e ekosistemeve detare, bregdetare dhe peizazhit.
2. Krijimi i korridoreve të veçanta panoramike të peizazhit, duke synuar ruajtjen e cilësisë dhe karakteristikat nga pika të favorshme vështrimi, përfshirë të gjitha pamjet në drejtim të detit, malit, gjireve, kepeve, shpateve, grykave, etj, si nga rrugët lokale e kombëtare në brendësi të territorit, apo duke krijuar vende të posaçme të preferuar nga vizitorët dhe turistët.
3. Përcaktimi i rrugëve/shtigjeve të lëvizjes në natyrë, të qendrimeve sipas kërkesave të vizitorëve, kampingjet, nyjet sanitare, vend grumbullimi i mbeturinave, shërbimi mjekësor, parking, vendet e peshkimit sportiv dhe të zhytjeve nënujore.
4. Vlerësimi i pasurisë kulturore dhe ruajtjen e karakterit të domethënies historike origjinale, nëpërmjet ndalimit apo kufizimit të veprimtarive jo koherente në zonën përreth, të lidhura me zakonet dhe traditat e rajonit.
5. Krijimi i qendrës muzeale (tuneli, fortifikimet dhe ndërtime të tjera ushtarake), rikualifikimi i disa fortifikimeve ushtarake (bunkerëve) në kuadër të turizmit kulturor, zonat arkeologjike, libraritë dhe dyqanet e lidhura me muzeumin, argëtimin, pritjen e vizitorëve, për të promovuar burimet natyrore-kulturore dhe prodhimet tradicionale lokale.
6. Sigurohemi që veprimtaritë çlodhëse, argëtuese dhe ekoturistike të mos ndikojnë negativisht në vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonës së mbrojtur.

Me përmbushjen e objektivit të mësipërm, priten rezultatet specifike të mëposhtme:

- a. Bashkëjetesë të ruajtjes me cilësi të lartë të burimeve natyrore, trashëgimit kulturor dhe zhvillimit

- të turizmit, duke mbështetur infrastrukturën, shërbimet që plotësojnë nevojat e vizitorëve dhe gjenerojnë të ardhura për komunitetin.
- b. Informacionin që u mundësohet vizitorëve të mësojnë më tepër për parkun, për ecjet në natyrë, zhytjet, botën e egër, zakonet tradicionale komunitetin dhe trashëgiminë e kulturore.
 - c. Shtimin e veprimtarive me karakter natyror, çlodhës, argëtues, sportivë e kulturor tradicional, gjatë gjithë vitit.
 - d. Shtimin e veprimtarive sociale me ndikim të ulët në mjedis.

Objektivi 5: Promovimi i kërkimit shkencor dhe edukimit

Mbështetje e kërkimit shkencor mbi vlerat biologjike, peizazhore dhe kulturore të zonës së mbrojtur si kontribut i rëndësishëm në proceset edukative, ndërgjegjësuere dhe informuese të vlerësimit të natyrës dhe biodiversitetit.

Me përmbushjen e këtij objektivi synohet:

1. Nxitja, rregullimi, inkurajimi i zhvillimit të kërkimit shkencor në lidhje me qëllimet e menxhimit të zonës së mbrojtur.
2. Kërkimi dhe çdo veprimtari shkencor të sigurojë njohjen e vlerave, formën e menxhimit të zonës së mbrojtur, përdorimin e qëndrueshëm dhe menxhimin e specieve të mbrojtura.
3. Vlerësimi i veprimtarive që kanë efekte negative në speciet apo habitatet e tyre, të përcaktohen masa të tjera për sigurimin e një gjendjeje të favorshme konservimi të specieve të mbrojtura të florës e faunës së egër dhe të produkteve të tyre.
4. Kontributi në hartimin e programeve monitoruese të nevojshme për identifikimin, vlerësimin e nënzonave, specieve të mbrojtura, të efektivitetit të masave të marra në zbatimin e planit të menxhimit dhe përmirësimin e statusit të ruajtjes, me qëllim mirëmbajtjen e tyre në një gjendje të favorshme konservimi.
5. Identifikimi i habitateve dhe specieve problematike, statusit mbrojtës i tyre, përcaktimi i zonave prioritare për ruajtje dhe i specieve me interes për komunitetin.
6. Përcaktimi i indikatorëve matës dhe i parametrave kryesor për monitorimin e situatës mjedisore të ZM.
7. Identifikimi dhe hartimi i listës së specieve të kërcënuara, të rrezikuara të florës e faunës dhe përcaktimi i statusit të mbrojtjes së tyre.
8. Përcaktimi i masave të nevojshme për rregullimin e futjeve të qëllimta apo aksidentale të specieve jovendase, të modifikuar gjenetikisht në habitatet natyrore dhe të ndalohet futja e specieve që mund të kenë ndikime të rënda në ekosistem, habitat apo dhe tek speciet e zonës së mbrojtur.
9. Studimi gjithëpërfshirës i shpërndarjes dhe i përcaktimit të statusit të llojeve të ndryshme të shkëmbinjve nënujore.
10. Përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut, të kuptuarit, vlerësimi i mjediseve, burimeve natyrore të zonës së mbrojtur dhe ndikimi i mundshëm i veprimtarive të njerëzore në këto mjedise.
11. Informimi i publikut për interesin, vlerat, habitatet, speciet e zonës së mbrojtur, për dijet shkencore që mund të fitohen nga pikëpamja e ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe këndvështrime të tjera.
12. T'i jepet publiciteti i duhur krijimit të zonës së mbrojtur, kufijve, vlerave natyrore, tradicionale e kulturore, rregullave që duhen zbatuar, speciet e mbrojtura, habitatet e tyre dhe rregullat që duhet të zbatohen subjektet private dhe vizitorët.
13. Hartimin e programeve edukative-ndërgjegjësuere.
14. Nxitjen e pjesëmarrjes së publikut dhe e organizatave të tjera në veprimet që janë të nevojshme për mbrojtjen e nënzonave, të specieve e habitateve të tyre, duke përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Me përmbushjen e objektivit të mësipërme, priten rezultatet specifike të mëposhtme:

- a. Studime dhe vlerësime të ndryshme të ekosistemeve tokësore dhe detare të kryhen duke përfshirë projekte në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- b. Sigurimi i një liste gjithëpërfshirëse të studimeve e kërkimeve për të përcaktuar statusin e specieve kryesore të përfshira në ZM dhe hartografimin e tyre.
- c. Vazhdimi i përmirësimit të ruajtjes, restaurimit dhe rritjes së pasurisë së mjedisit natyror, në mënyrë që bota e egër dhe sistemet ekologjike të zhvillohen mirë.
- d. Një vlerësim të potencialit turistik të zonës së mbrojtur dhe periferisë së saj si dhe promovim i turizmit të qëndrueshëm.
- e. Njohje e mirë dhe ndërgjegjësim mbi ruajtjen dhe përdorimin e zonës së mbrojtur nga popullësisia lokale, përdoruesit dhe vizitorët.

Parimet e planit të menxhimit sigurojnë një bazë të shëndoshë për administrimi e zonës së mbrojtur. Zona e mbrojtur ruhet me pjesëmarrjen e bashkëpunimin e komunitetit lokal, dhe shërben për përmirësimin e cilësive të jetës së tyre. Kjo arrihet më mirë me sensibilizim, kuptim dhe përfshirje. Pjesëmarrja garanton që personat që preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga planifikimi i menxhimit, të jenë në gjendje të kontribuojnë me njohuritë, përvojën dhe idetë e tyre.

Përfshirja në planifikim, në proceset vendimmarrëse është një instrument i rëndësishëm që ndihmon menaxherët, vendimmarrësit që të bëjnë zgjedhje më të mira, bazuar në zgjidhjet individuale të njerëzve lokalë të informuar dhe me përvojë.

Mbrojtja e botës së egër dhe habitateve është qëllim parësor i zonës së mbrojtura. Përgjegjësia për mbrojtjen, ruajtjen e vlerave shtrihet përtej strukturave të menaxhimit në nivel lokal, duke përfshirë licencat, tarifën e qiramarrjes, autoritetet përkatëse publike dhe private, vizitorët, fqinjët dhe komunitetin e gjerë.

Kuadri dhe proceset e vendimmarrjes duhet të jenë të hapura dhe transparente. Arsyet për marrjet e vendimeve duhet të bëhen publike, përveç informacionit që duhet trajtuar si konfidencial, kur është i ndjeshëm në aspektin kulturor apo në atë tregtar.

Informacioni mbi zonën e mbrojtur, tiparet, kërcënimet, ndërhyrjet dhe çdo informacion që ka të bëjë me procesin e menaxhimit, duhet të shpërndahet me: Fletëpalosje, guida, ekspozita dhe broshura, programe trajnimim lokale, TV, gazetata dhe revistat lokale, rajonale dhe Web, etj.

Menaxhimi efektiv, i përshtatshëm i zonës së mbrojtur duhet të pasqyrojë një qasje menaxhuese të pranueshme, për të mbështetur përmirësimin dhe konsolidimin e vazhdueshëm të përdorimit të burimeve natyrore e kulturore të saj. Kjo përfshin monitorimin e rezultateve të menaxhimit, marrjen parasysh të gjetjeve të monitorimit dhe kërkimeve të tjera për të përmirësuar efektivitetin e menaxhimit. Vendimet e menaxhimit duhet të kenë bazë shkencore ose të mbështeten në përvojën e duhur. Strukturat e menaxhimit duhet të ruajnë, të përmirësojnë kapacitetet, të mësojnë nga përvoja, të vlerësojnë dhe të krijimit të stafit për ekspertizë, dhe të marrin parasysh inputet e aktorëve të tjerë.

Mbrojtja e burimeve natyrore duhet të përfshijë identifikimin, marrjen e masave të përshtatshme për menjanimin dhe menaxhimin aktiv të kërcënimeve dhe rreziqeve.

Menaxhimi efektiv duhet të bazohet mbi informacionin më të mirë të disponueshëm. Sidoqoftë, kur ka rrisje potenciale apo dëme të pakthyeshme, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen e masave për parandalimin e degradimit mjedisor apo shqetësimeve dëmtuese të vendeve natyrore.

3.2 Përcaktimi i Zonave të Menaxhimit

Zona e Gjirit të Palermos-Llamani nuk disponon zonim të territorit, pasi është një zonë rishtazi për t'u shpallur e mbrojtur. Strategjia e zonimit të territorit të saj është hapi tjetër në procesin e hartimit të planit të menaxhimit. Vizioni, principet dhe objektivat e për ruajtjen dhe përdorimin e biodiversitetit, tokës dhe ujërave, duhet të shtjellohen më tej dhe të shndërrohen në instrumenta hapësinore rajonale të veprimtarive të parashikuar për t'u zhvilluar dhe ato që përjashtohen për t'u kryer brenda territorit të zonës së mbrojtur.

Zona e mbrojtur përfaqëson mjedise të ndjeshme, prandaj veprimtaritë duhet të jenë të qeta, bazuar në kapacitetin mbajtës të tyre, me një ndikim të ulët dhe gjithnjë

në ekuilibër me natyrën. Kapaciteti mbajtës përfaqëson nivelin e përdorimit të zonës nga vizitorët e përdoruesit e tjerë, duke përmbyshur kërkesat e tyre, por pa dëmtime të përhershme në burimet natyrore të saj. Ky kapacitet në zonën e mbrojtur duhet të vlerësohet në tre aspekte:

- **Kapaciteti mbajtës mjedisor**, përfaqëson shkallën në të cilën një ekosistem, habitat apo peizazh mund të mirëpresë ndikime të ndryshme sociale, ekonomike, turistike, vizitorë dhe infrastrukturën përkatëse shoqëruese, pa shkaktuar dëme ose pa humbur "statusin e zonës".
- **Kapaciteti mbajtës social e kulturor**, është niveli përtej të cilit zhvillimet sociale, ekonomike, turistike, numri i vizitorëve dhe infrastrukturën përkatëse shoqëruese në mënyrë të kundërt ndikojnë në komunitetin lokal dhe tek mënyrat e tyre të jetesës.
- **Kapaciteti mbajtës psikologjik**, është niveli përtej të cilit cilësitë bazë që njerëzit kërkojnë në zonën e mbrojtur mund të dëmtohen nga ky zhvillim.

Krahas kësaj përcaktimi i nënzona të menaxhimit është mbështetur dhe në instrumentet themelore të planifikimit (përfshirë politikën, planet e rregulloret) të territorit të Shqipërisë⁷.

Qëllimi kryesor i administruesve të zonës së mbrojtur është kujdesi që përdorimi i këtyre veprimtarive të jetë ambjentalisht i përshtatshëm. Në zonën e mbrojtur parësore është ruajtja e ekosistemit, habitateve, specieve, peizazhit; restaurimi i ekuilibrave natyrore dhe i kapaciteteve mbajtëse, kur ato prishen, ndërsa lejohet dhe zhvillimi. Disa veprimtari, që në përgjithësi nuk përshtaten me zonën e mbrojtur, nuk janë të këshillueshme të zbatohen, si turizmi i organizuar masiv, hotele të mëdha, komplekse për tregëti, fshatra turistike e struktura të shërbimeve sportive e argëtuese të nivelit të lartë etj. Ndërsa veprimtaritë bujqësore, agro-pylore dhe peshkimi tradicional duhet të lejohen gjithnjë në përputhje me rregullat dhe ekuilibrat natyrorë.

Qëllimi praktik i strategjisë së zonimit është të ndihmojë administratorët, përdoruesit dhe vendimmarrësit që të bëjnë zgjedhjen e tyre, sipas ndikimeve pozitive apo negative, për çdo ndërhyrje që kërkohet të bëhet në këtë zonë të mbrojtur. Në nenin 4/2, të ligjit nr. 8096, datë 06.06.2002 "Për Zonat e Mbrojtura", të ndryshuar, përcaktohet se:

- Territori i zonës së mbrojtur ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to.
- Zonimi i brëndshëm mund të përmbajë zonën qendrore, zonën e rekreacionit, zonën e përdorimit tradicional, zonën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe nënzona të tjera që i përshtaten territorit.
- Zonimi përputh shkallën e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës,

⁷ VKM nr. 1, dt 18.10.2013 "Për hartim e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), bazuar në ligjin "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar.

llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në natyrë.

Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave, që shpall zonën e mbrojtur, përcakton emërtimin, sipërfaqen dhe shkallën e mbrojtjes së nënzoneve të saj.

Zonimi i propozuar është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për zonimin e territorit të zonave të mbrojtura dhe të përvijës së deri tanishme të praktikuar në vendin tonë. Tiparet specifike të secilës nënzone janë marë në konsideratë gjatë caktimit të zonimit. Metodologjia e përdorur për caktimin e nënzoneve të ruajtjes dhe menaxhimit u mbështet edhe në “Studimin ekologjik të Gjirit të Porto Palermos dhe zonave përreth”.

Në terren u indentifikuan propozimet, vlerësimi i marrëdhënieve ndërmjet sistemeve fizike, biologjike dhe antropologjike, për të siguruar një vlerësim të përgjithshëm mbi natyrën, biodiversitetin, jetën e egër, peizazhin, historinë dhe kulturën, por dhe të shumëllojshmërisë së mardhënieve dhe të përdorimeve ndërmjet komunitetit dhe natyrës.

Në vlerësimin dhe caktimin e nënzoneve qendrore dhe të menaxhimit efektiv është marrë në konsideratë natyraliteti dhe asetet natyrore të tyre pak të shqetësuara nga veprimtaritë njerëzore. Përparësi i është dhënë ruajtjes tërësore të natyrës e biodiversitetit, tipeve të habitateve dhe specieve të rrezikuara, sipas klasifikimit Natura 2000 apo dhe ato të përfshirë në Librin e Kuq. Janë vlerësuar dhe veçoritë natyrore të jashtëzakonshme gjeromorfologjike, monumentet e natyrës, të peizazhit unik tokësor dhe bregdetar-detar. U përcaktuan veprimtaritë që mund të ushtrohet, por që nuk janë në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes, objektivat e menaxhimit, për të cilat do të zbatohet shkalla më e lartë e ruajtjes.

Vlerësimi dhe caktimi i nënzoneve të rekeacionit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm gjithashtu u mbështet tek natyraliteti, asetet përbërëse, qëllimi dhe synimet e menaxhimit si dhe tek veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara sociale, ekonomike e turistike. Në këtë aspekt nënzona duhet të garantojë që të mos çenohet ndërveprimi harmonik i natyrës me kulturën përmes mbrojtjes së cilësisë së peizazhit. Krahas kësaj të përdorimit të vazhdueshëm të tokës, ujërave, bregdetit e nëndetit, në mënyrë tradicionale, duke bashkërenduar menaxhimin e nënzoneve me zhvillimin e qëndrueshëm, të barazpeshuar ekonomik, social e turistik, dhe t’u japet mundësia popullsisë lokale, për të siguruar përfitime ekonomike që nuk vijnë ndesh me objektivat e tjera të menaxhimit.

Gjithashtu, në mbështetje të kërkesave ligjore është bërë dhe caktimi i shkallës së mbrojtjes të nënzoneve, duke marrë në konsideratë: Vlerat ekologjike, gjeomorfologjike, biodiversitetin, ato peizazhore natyrore, kulturore, ndërtimore dhe karakteristikat hapësinore e funksionale që përfshihen në zonën e mbrojtur dhe rreth saj.

Karakteristikë e nënzonimit të territorit të ZM “Gjiri i Palermos-Llamani”, e cila zhvillohet për herë të parë, është mbi vendosja e shtresave të nënzonimit, duke patur në

konsideratë sipërfaqen ujore detare dhe atë nëndetare. P.sh nënzonat e mbrojtjes të shtrirjes së posidonias janë nëndetare (në thellësi 5, 25 m e më tepër), të cilat do të trajtohen në mbështetje të objektivave të menaxhimit. Por këto objektiva janë të ndryshëm nga objektivat e nënzoneve sipërfaqësore detare, e cila do të ketë përdorime dhe shkallë mbrojtjeje të ndryshme nga ajo nëndetare, pra zhvillim të qëndrueshëm apo dhe rekreativ. Në përlogritjen e sipërfaqes së përgjithshme të zonës së mbrojtur do të merret në konsideratë vetëm sipërfaqja e sipërme detare dhe ajo tokësore.

Bazuar në metodikat dhe praktikatat më të mira të shprehura në studimet, për ZM “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”, mund të përdoret sistemi i zonimit të territorit me katër nënzona menaxhimi, si më poshtë:

Nën-Zona e Qendrore (ZQ), për të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Performanca natyrore tepër e lartë, me pak ose aspak e shqetësuar nga veprimtaritë njerëzore. Ka përparësi ruajtjen tërësore të natyrës, të biodiversitetit, të llojeve të rrezikuara, monumentet e natyrës, të peizazhit unik tokësor, bregdetar-detar, veçoritë natyrore të jashtëzakonshme gjeromorfologjike pa qenë nevoja e ndërhyrjeve përmirësuese të përhershme, të cilat menaxhohen në atë mënyrë që të ruajnë gjendjen natyrore, të mbështetin lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor.

Kjo nënzona gëzon karakterin e mbrojtjes strikte. Veprimtaritë sociale-ekonomike, turistike, sportive e argëtuese, etj, janë tërësisht të ndaluara.

Nën-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME), për të cilën zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes. Performanca natyrore e lartë, me habitate shumë të rëndësishme natyrore ose vendbanime me lloje të rralla dhe të rrezikuara. Ka përparësi ruajtjen tërësore të biodiversitetit, zonat natyrore, përfaqësues të rajoneve fiziografike dhe skenike për qëllime shpirtërore, shkencore, edukative, duke integruar menaxhimin e zonës së mbrojtur me përdorimin e qëndrueshëm e të ballancuar. Karakterizohet me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera të tjera të natyrës në të cilat, mund të ushtrohet veprimtari që nuk janë në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes dhe objektivat e menaxhimit. Lejohet vetëm ekoturizëm mjedisor, arsimor sipas rregullave dhe kufizime të qarta për nënzonen.

Nën-Zona e Rekreacionit (ZR), për të cilën zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes. Performanca natyrore e mirë. Përcaktohet si nënzona që përmban sipërfaqe tokësore, ujore e nëndetare të përshtatshme, dhe duhet të garantojë që të mos çenohet ndërveprimi harmonik i natyrës me kulturën përmes mbrojtjes së cilësisë së peizazhit, përdorimit të vazhdueshëm të tokës, ujërave, bregdetit e detit, në mënyrë tradicionale; të praktikave ndërtimore dhe manifestimeve sociale e kulturore karakteristike e tradicionale. Të eliminohet apo të parandalohet, ku është e domosdoshme, përdorimin e tokës, ujërave, bregdetit e detit, kryerjen e veprimtarive që janë të papërshtatshme në përmasa dhe në përmbajtje. Lejonë mundësi për edukim, rekreacion në natyrë të hapur dhe nëndetar, veprimtari jo masive sportive, argëtuese dhe facilitete që respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike, peizazhin natyror e atë kulturor

dhe të instrumentave të përgjithshme kombëtar e vendor të planifikimit të territorit.

Nën-Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ZZhQ), për të cilën zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes. Përforma natyrore e mjaftueshme. Ka përparësi harmonizimin e ruajtjes së natyrës, të peizazhit dhe të biodiversitetit, duke bashkërenduar menaxhimin e zonës së mbrojtur me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.


Nën-Zona krahas zhvillimi social-ekonomik duhet të sigurojë dhe të ruajë kushtet e habitatit të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve të rëndësishëm, grup-llojeve, komuniteteve

biotike ose karakteristikave fizike të mjedisit, gjë që kërkon ndërhyrje njerëzore të veçanta për menaxhim efektiv. Mbështet lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor të veprimtarive parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Nëpërmjet përdorimit afatgjatë të qëndrueshëm, të barazpeshuar nënzona duhet t'u japë mundësi popullsisë lokale, për të siguruar përfitime ekonomike që nuk vijnë ndesh me objektivat e tjera të menaxhimit.

Zhvillimet urbane, të objekteve të ndryshme apo të infrastrukturës e shërbimeve, për nevojat e banorëve, të vizitorëve dhe të biznesit, kryen në mbështetje të planeve të menaxhimit dhe të instrumentave të zhvillimit, të miratuar nga KTT-ja.

Tabela 6: Nën-zonat e menaxhimit dhe sipërfaqja

Nr.	EMËRTIMI I NËNZONËS	SIPËRFAQJA - HA	%/Totalit
1	Nën-Zona Qendrore (ZQ)	119.44	5.78
2	Nën-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)	325.83	15.76
3	Nën-Zona e Rekreacionit (ZR)	42.61	2.06
4	Nën-Zona e Zhvillimit të Qendrueshëm (ZZhQ)	1,579.87	76.41
	TOTALI	2,067.75	100.00



Harta 4: Zonimi i territorit të ZM "Gjiri i Porto Palermos-Llamani"

3.3 Veprimet Menaxhuese

Masat mbrojtëse, planifikuese dhe menaxhuese të zbatueshme për çdo nënzonë duhet të jenë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të konservimit afatshkurtër e afatgjatë dhe të marrin në veçanti parasysh kërcënimet që i bëhen. Gjithashtu, përbëjnë bazën për vlerësimin e mjaftueshmërisë së masave të marra, efikasitetin e zbatimit dhe të rishikimit të planit të menaxhimit. Veprimet menaxhuese bazohen në njohuritë e duhura të elementëve të mjedisit natyror detare, bregdetar, tokësor dhe të faktorëve social, ekonomikë dhe kulturorë që karakterizojnë çdo nënzonë.

Në përputhje me rregullat e ligjit në fuqi, planifikimi, menaxhimi, mbikqyrja dhe monitorimi duhet të përfshijnë çdo nënzonë. Në lidhje me specifikën që karakterizon zonën e mbrojtur, masat vepruse duhet të kenë parasysh aspektet bazë të mëposhtme:

1. Zhvillimin dhe miratimin e planit të menaxhimit që specifikon kuadrin ligjor, institucional, masat menaxhuese dhe mbrojtëse të zbatueshme.
2. Përfshirjen njëkohësisht të territorreve detare, bregdetare e tokësore, për të cilët duhet të sigurohet koordinimi, administrimi dhe menaxhimi si një proces i pandarë.
3. Hartimin e programit të monitorimit, i cili duhet të përfshijë identifikimin, vlerësimin e një numri parametrash të rëndësishëm për zonën, të gjendjes, mbledhjen e të dhënave, të informacionit që mungonë, efektivitetin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese që zbatohen.
4. Monitorimin e futjes ose ri-futjes së specieve invazive në zonën e mbrojtur.
5. Monitorimin e rregullave për lëshimin ose hedhjen e mbetjeve dhe substancave të tjera që direkt ose indirekt prishin integritetin e zonës së mbrojtur.
6. Pjesëmarrjen aktive të popullsisë lokale, veçanërisht të banorëve që preken nga shpallja zonës së mbrojtur dhe masat menaxhuese të caktuara.
7. Caktimin e mekanizmave për të financuar nxitjen e menaxhimit e zonës, për zhvillimin e veprimtarive që sigurojnë se menaxhimi përkon me objektivat e këtyre nënzoneve.
8. Rregullimin e çdo veprimtarie ose veprimi që dëmton ose shqetëson speciet, ose mund të rrezikojnë statusin e konservimit të ekosistemeve, habitateve, specieve që mund të prishin karakteristikat natyrore, kulturore dhe estetike të zonës.
9. Rregullimin e veprimtarive sociale, ekonomike, turistike, tradicionale dhe kulturore në përputhje me objektivat për të cilat është shpallur zona e mbrojtur dhe kushteve të lejeve përkatëse.
10. Krijimin dhe funksionimin e administratës menaxhuese të veshur me fuqi të mjaftueshme, me mjetet e burimet njerëzore për të ndaluar dhe kontrolluar veprimtaritë që mund të jenë të kundërta me qëllimet e zonës së mbrojtur.

11. Trainimin e menaxherëve, të personelit të kualifikuar teknik, në zhvillimin e një infrastrukture të përshtatshme për kryerjen e punës dhe të pritjes e informimit të vizitorëve.

Ndarja e veprimeve menaxhuese, sipas nënzoneve të menaxhimit, dhe çdo mundësi për zhvillim në të ardhmen, duhet të merren në konsideratë një sërë problemesh që kufizojnë praninë e burimeve natyrore. Këto duhet të tregohen qartë në veprimet e menaxhimit për çdo komponent të sistemit se çfarë nuk lejohet a lejohet brenda ZM. Pra, duhet të formulohet dhe zbatohet plane veprimi për mbrojtjen dhe ripërtëritjen e tyre.

Forma e tokës, pjerrësitë, cilësia e mbulesës bimore, zonat që historikisht përdoren për banim, transport dhe bujqësi, me një vlerë të lartë për shëmbëllimin e zonës; ndjeshmëria e ekosistemeve dhe habitateve tokësore e detare; përdorimi i infrastrukturës e i shërbimeve etj, duhet të mbrohen të gjitha me kujdes, gjë që mund të kufizojë edhe disponibilitetin e hapësirës së përshtatshme për ndërtime në të ardhmen, veçanërisht ato që bazohen tek turizmi, për administratorët dhe privatët, të cilët kërkojnë t'i zhvillojnë.

Vëmendje i duhet kushtuar rreziqeve që janë natyrore ose të shkaktuar nga njeriu, por që lidhen me proceset e zhvillimit aktual apo të ardhshëm të ZM. Veprimtaritë sociale, ekonomike e turistike, në këtë rast, bazohen në karakterin e veçantë të nënzoneve. Veprimtaritë të cilat janë tërësisht të ndaluara dhe që lejohen.

Objektivat e ruajtjes kombinohen me praktikat më të mira të përdorimit të natyrës dhe të biodiversitetit, me ato të zhvillimit social-ekonomik të qëndrueshëm. Kjo krijon kushtet fillestare të përdorimit, ndihmon të sigurojë ekzistencën, rritjen e cilësisë së jetesës të popullsisë lokale dhe forcimin e identitetit lokal.

Integrimi i veprimtarive tradicionale, për formulimin e masave mbrojtëse do të marrë parasysh jetesën tradicionale dhe veprimtaritë kulturore të popullsisë lokale. Ato do të bëjnë përjashtime nëse është e nevojshme për të përballuar nevoja e tyre. Por, asnjë përjashtim për këto arsye:

- a. Nuk do të rrezikojë ruajtjen, shkatërrimin apo dëmtimin e ekosistemeve, tipet e habitateve të mbrojtura dhe proceset biologjike që kontribuojnë në ruajtjen e tyre;
- b. nuk do të shkaktojë zhdukjen, ose pakësimin e ndjeshëm të numrit të individëve që përbëjnë popullatën ose speciet e florës e faunës, në veçanti speciet shtegtare ose endemike, të rrezikuara ose të kërcënuara.

Disa veprimtari sociale, ekonomike e turistike, që në përgjithësi nuk përshtaten me zonën e mbrojtur, për shkak të statusit të saj, nuk janë të këshillueshme të zbatohen si: shërbime e lehtësira të një shkalle të lartë, një turizëm i organizuar masiv, hotele të mëdha, komplekse për tregti, qendra të mëdha pushimesh, infrastrukturë jo miqësore me mjedisin, struktura dhe shërbime argëtimi e sportive të nivelit të lartë, veprimtari të zhurmshme, që lidhen me një numër të konsiderueshëm njerëzish e mjeteshe në të njëjtin vend e kohë, ose që në mënyrë të përsëritur shqetësojnë botën e egër etj .

Gjithashtu, hapësirat e përcaktuara si nënzona të mbrojtjes së peizazhit janë mjaft të përshtatshme për një rekreacion ekologjikisht të qëndrueshëm, për të cilat kërkohen masa të veçanta. Hapsira të tilla janë caktuar në gjirin e Lllamanit, pjesa lidhëse me Kalanë e Portopalermos, zona e re dhe plazhi “Panorma”, qendra e peshkatarëve dhe territori në gjirin e Gravës, të gjitha këto pjesë e gadishullit të Panormës.

Vizitorët janë të mirëpritur, por gjithashtu mund të jenë një ngarkesë e rëndë, nëse nuk menaxhohen mirë dhe nuk organizohen. Vizitorët janë grup i rëndësishëm për të arritur objektivat për edukimin mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Ata janë njësoj të rëndësishëm për përmirësimin e situatës ekonomike dhe gjendjen jetesës së banorëve. Prandaj, popullsia lokale dhe administrata duhet të kenë të njëjtat interesa për të tërhequr vizitorët.

Vizitorët ditorë janë të mirëpritur, prandaj është thelbësore që të krijohen mundësi për ta' për të përjetuar natyrën, pasuritë kulturore dhe mikpritjen e popullsisë vendase. Për të cilën kërkohet që të krijohet, ruajtur e mirëmbajtur infrastruktura më tërheqës e duhur për vizitorët e turistët dhe nga ana tjetër për të mbështetur ekonominë lokale.

Si parim themelor nënzona qendrore, të cilat janë më të ndjeshme ndaj çrregullimeve nga prania njerëzore, janë të kufizuara për vizitorët. Nga ana tjetër, duhet të identifikohen zona ku vizitorët mund të përjetojnë bukurinë e natyrës, atraktivitetin e vëzhgimit të biodiversitetit dhe karakteristika të tjera përkatëse të ZM. Kjo detyron administratën të krijojë infrastruktura specifike për vizitorët, të cilat duhet të jenë aq tërheqëse për t'i mbajtur ata larg nga zonat e ndjeshme.

Pikat dhe materialet informuese për vizitorët janë të rëndësishme për të udhëzuar ata që të lëvizin të sigurt nëpër territorin e zonës së mbrojtur dhe për të marrë informacionin e duhur. Territori është i ndarë gjeografikisht

në katër pjesë kryesore: zona e Gjirit të Lllamanit, zona e Gjirit të Armeridhës, zona e Gjirit të Shën Nikollës dhe zona e Gjirit të Gravës. Pamje mahnitëse kanë kepi i Alpunit, Kavadonit, Panormës, Spinarisit dhe gadishulli i Kalasë së Portopalermos.

Në këtë kuadër procesi i edukimit mjedisor, ndërgjegjësimi i banorëve të përhershëm dhe të të ardhurve, nëpërmjet krijimit të qendrave të informimit e muzeumeve mjedisore; vizitave, shëtitjeve e ecjeve në natyrë, zhytjeve, ski shëtitësve, vozitjeve, notimit; studime, fotografime, pikturimi të natyrës, etj., me grupe të vogla, të cilët ruajnë qetësinë e zonës, cilësitë e natyrës së egër, tokën dhe ujërat, nuk shkaktojnë dëme, shqetësime, ndotje dhe që ruajnë standartet, bazuar në kapacitetet mbajtëse mjedisore, kërkon vëmendje të veçantë.

Kompetenca dhe përgjegjësia në administrimin dhe zbatimin e masave të konservimit për zonat e propozuara duhet të përcaktohen qartë në përshkrimet dhe tekstet që hartohen në secilën nënzona. Gjithashtu, duhet të ketë një organizëm menaxhues të veshur me fuqi të mjaftueshme, me mjetet dhe burime njerëzore për të ndaluar dhe/ose kontrolluar veprimtaritë që mund të jenë të kundërta me qëllimet e sipërfaqes së mbrojtur.

Rekrutimi dhe përshkrimi i detyrave për stafin e ZM do të jetë në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, për ruajtjen e natyrës, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura, nëpërmjet zbatimit të praktive më të mira ndërkombëtare e kombëtare, të përdorimit të qëndrueshëm dhe promovimi i vlerave të tyre me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

Administratorët dhe përdoruesit e zonës së mbrojtur duhet t'i kenë parasysh këto procese, ku në tabelën 8 tregohen qartë veprimet e menaxhimit për çdo komponent të sistemit brenda zonës së mbrojtur.

Tabela 7: Zonimi i sipërfaqes së ZM "Gjiri i Porto Palermos-Llamani"

Natyralliteti/Asetet natyrore-kulturore	Veprimtaritë njerëzore/sociale-ekonomike-turistike
Nën-Zona Qendrore (ZQ)	Shkalla e I e Ruajtjes
<p>Sipërfaqja e përgjithshme 119.44 ha, nga e cila 18.76 ha tokësore dhe 100.68 ha nëndetare.</p> <p>Përshkrimi: Nën-zona përfshin gjithë gadishullin e Kalasë së Ali Pashës, duke përfshijtur ndërtesa ekzistuese, sheshin e parkimit dhe kishën e Shën Nikollës dhe rruginën që të çon tek Kalaja. Po kështu përfshihen pjesët Jugore, Perëndimore dhe Veriore të gadishullit të Panormës, si njësi gjeomorfollogjike të veçantë e tepër karakteristike për zonën e mbrojtur.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Habitet dhe specie: <ul style="list-style-type: none"> - Shkurret termo-mesdhetare dhe para-shkretëtirë, i përbërë nga shoqërimet e Rryellit (<i>Euphorbia dendroides</i>), të konsideruar më interesante, afërsisht unike në Shqipëri dhe si habitat natyror me rëndësi i KE-s. Gjithashtu takohen ilqja, ulliri, arëhindi, pistacia, konopica, shega e egër, gjineshtra, ullastra, caraci, fiku, driza, lojfata, bezga, qepë deti, rizoni i bardhë, etj. - Biocenosat e shkëmbinjve të ulët mediolitoral, kryesisht algat e kuqe (<i>Lithophyllum byssoides</i>). - Livadhet me bar deti, janë të pranishme tre lloje bimësh: <i>Posidonia oceanica</i>, <i>Cymodocea nodosa</i> dhe <i>Halophila stipulacea</i>. Në bregdetin perëndimor të Kalasë së Portopalermos mungojnë livadhe me <i>Posidonia</i>. - Rreth kësaj nënzona takohen dhe një diversitet i madh peshqish, si: <i>Chelon sp.</i>, <i>Mullus surmulletus</i>, <i>Diplodus sp.</i>, <i>Coris juli</i>, <i>Serranus cabrilla</i>, <i>Oblada sp.</i>, <i>Chromis sp.</i>, etj. • Vlerat kulturore: Zona nëndetare e amforave. Përformanca natyrore tepër e lartë. Ka përparësi ruajtjen tërësore të natyrës, biodiversitetit dhe të veçorive natyrore të jashtëzakonshme gjeomorfollogjike, të shpateve të Kalasë e të kepit të Panormës, të vlerave kulturore e arkeologjike dhe nuk duhet të ketë shqetësime nga veprimtaritë njerëzore. 	<p>Në këtë nënzona janë tërësisht të ndaluara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë sociale-ekonomike, turistike, ndërtimore dhe përdorimi i teknologjive intensive, mjetet dhe mënyrat që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, strukturën dhe funksionet e ekosistemeve tokësore e detare. • Veprimtaritë ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij. • Shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë gjuetinë ilegale të tyre, mbipeshkimi dhe përdorimi i mjeteve e metodave të ndaluara në zonën e mbrojtur dhe rreth saj. • Gërmimet, guroret, marrja e rërës apo dhe zhavorit. • Hedhja e mbetjeve të ngurta, inerteve, lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse, të plehrave dhe pesticideve. • Ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore e burimeve dhe shpellave nëndetare. • Futjen e çdo specieve jo indigjene/vendase, të specieve gjenetikut të modifikuara, apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë, dëmtimi i livadheve të <i>posidonias</i> nga marinë-kultura dhe spirancat. • Çdo veprimtari apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojë gjendjen e konservimit të ekosistemit, habitatit e specieve dhe që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore, peizazhike dhe kulturore. • Gjuetia dhe çfarë do lloj mjeti për peshkim dhe marinë-kultura. • Prerja e bimësisë pyjore dhe kullotja. • Ndezja e zjarreve në bregdet. • Ndotja nga shkarkimet e anijeve, derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura e të zeza të patrajuara. • Hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, instalimet dhe nga bregdeti. • Fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi, fuçi, mbeturinat metalesh e qelqi dhe të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit. • Lëvizja e mjeteve motorike të çfarë dolloji (veç zjarrëfikësave, të ndihmës së shpejtë dhe të administratës). • Ngritja e objekteve për veprimtaritë sportive e argëtuese, kampingjet, manifestimet e mëdha artistike dhe kulturore. • Vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi dhe organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta. • Stërvitjet dhe veprimet ushtarake. <p>Në këtë nënzona janë të lejuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërhyrjet përmirësuese të përkohshme, vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit si zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, largimin e mbetjeve të ngurta, plastike, inertet, hidrokarburet dhe të vendosjes së infrastrukturës për pritjen dhe informimin e vizitorëve dhe të turistëve. • Vizita ditore vetëm brenda territorit të Kalasë së Portopalermos, sipas guidave të miratuara. • Fotografimi, pikturimi i natyrës, peizazhit, dhe specieve të florës e faunës, vetëm në vendet e caktuara nga administrata. • Kërkimi shkencor dhe monitorimi mjedisor i kësaj nënzona, me autorizim të veçantë të administratës së ZM. <p>Nënzona mbështet lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimit mjedisor të veprimtarive parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.</p> <p>Mbrojtja sigurohet në bashkëveprim me autoritete lokale dhe palët e tjera të interesuara, nëpërmjet patrullimeve duke zbatuar rregullat apo metodikat e përdorimit të caktuara rreptësisht.</p>

Natyralliteti/Asetet natyrore-kulturore	Veprimtaritë njerëzore/sociale-ekonomike-turistike
Nën-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)	Shkalla e II e Ruajtjes
<p>Sipërfaqja e përgjithshme 325.83 ha, nga e cila 96.99 ha tokësore dhe 228.84 ha nëndetare.</p> <p>Përshkrimi:</p> <p>Në këtë nënzonë përfshihet pjesa tokësore e shpateve të pjerrët, të veshur me bimësi tipike mesdhetare dhe disa njolla të valanidhit, nga kepi i Alpunit deri tek plazhi i Lllamanit. Shpatet e pjerrët në Jug të plazhit të Lllamanit, poshtë rrugës auto Himarë-Qeparo deri tek qafa e Lerës, ku dominon bimësia tipike mesdhetare dhe disa njolla të valanidhit.</p> <p>Pjesa Veriore dhe Kepit të Kavadorit, poshtë qafës së Lerës, në një distancë 200 ml nga bregu, me shpatet të pjerrët të mbuluar me bimësi kserofite, kryesisht të kullotave deri në afërsi të tunelit të ushtrisë. Shpatet për gjatë rrugës automobilistike nga zona ushtarake deri te kepi i Spinarisit. Pjesët e kepit të Panormës dhe të gjirit të Gravës, të cilat nuk përfshihen në ZQ. Në gjirin e Lllamanit dhe të Armeridhës takohen dhe disa burime ujore nëndetare dhe shpellat.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Habitatet dhe specie: <ul style="list-style-type: none"> - Shkurret termo-mesdhetare dhe para-shkretëtirë, përbërë nga shoqërimet e Rryellit (<i>Euphorbia dendroidea</i>). Bimësia floristike: <i>Salvia triloba</i>, <i>Lotus cytisoides</i>, <i>Phlomis fruticosa</i>, <i>Glaucium flavum</i>, <i>Galium aparine</i>, <i>Pistacia terebinthus</i>, <i>Spartium junceum</i>, <i>Ruscus aculeatus</i>, <i>Asparagus acutifolius</i>, <i>Urginea maritima</i>, <i>Asphodelus aestivus</i>, <i>Chrysopogon gryllus</i>, <i>Acanthus spinosus</i>, <i>Trifolium angustifolium</i>, <i>Brassica incana</i>, <i>Paliurus spina-christi</i>. - Phrygana/Frigana, të dominuar nga <i>Phlomis fruticosa</i> (assoc. <i>Chrysopogono-Phlometum fruticosae</i>), edhe shoqërimet me <i>Salvia fruticosa</i> L., - Bimësia e pseudo-stepave Mesdhetar, i dominuar <i>Brachypodium ramosum</i> (assoc. <i>Brachypodietum bronkial</i>) mbi shkëmbinjtë gëlqeror që paraqitet i degraduar. Bimësia e <i>Quercus ithaburensis subsp. macrolepis</i>, i njohur si dushku i Vlorës, konsiderohet si një specie relikte që prej periudhës Terciare dhe është e pranishëm në formë njollash në kodrat e zonës veriore e lindore të gjirit të Lllamanit dhe të Kepit të Kavadorit. - Biocenosat e shkëmbinjve të ulët mediolitoral, kryesisht algat e kuqe (<i>Lithophyllum byssoides</i>). - Biocenosat e shpellave mediolitoral, rriten lloje si: <i>Hildenbrandia prototypus</i>, <i>Phymatolithon lenormandii</i>, <i>Peyssonelia spp.</i>, etj. - Biocenosat e algave infralitorale, me shoqërime me <i>Cystoseira amentacea var. spicata</i>. - Livadhët me bar deti, përfaqësohen nga tre lloje bimësh: <i>Posidonia oceanica</i>, <i>Cymodocea nodosa</i> dhe <i>Halophila stipulacea</i>. - Shoqërimet e biocinosave të koralogjeneve. - Në Gjirin e Lllamanit makrobentikët në thellësi përfaqësohen nga alga mucilagjinose, fotofile të tjera, iriq të zin (<i>Arbacia lixula</i>) dhe sfungjerë të dominuar nga <i>Chondrilla nucula</i>. - Në Gjiri i Porto Palermos, makrobentosi është i dominuar nga popullata me alga fotofile, sfungjerë (<i>Chondrilla nucula</i>) dhe iriqët e zi të detit (<i>Arbacia lixula</i>). Në pjesën veriore përgjatë bregdetit, shtrihen Cystoseira. Livadhët me <i>Posidonia oceanica</i> janë degraduar, sidomos në pjesën e saj Jugore, ndërsa në pjesën Veriore, janë në një gjendje më të mirë. Në këtë zonë gjendet një prani relativisht e madhe e sfungjerëve si <i>Codium sp.</i> dhe <i>Pinna nobilis</i>. Në pjesën Jugore, në afërsi të kufirit të poshtëm të livadhit me Posidonia, janë regjistruar alga të tjera invazive të <i>Caulerpa racemosa var. cylindracea</i> (hardhi të Caulerpes).. - Në zonën rreth Gadishullit të Panormës dhe Kepi të Spinarisit, mediolitorali karakterizohet nga një prani e vazhdueshme e algave <i>Cystoseira amentacea</i> dhe fotofile të tjera, të dominuara nga Padina, Acetabularia dhe Dicyyota. Në pjesën Lindore, pranë kufirit më të ulët të Posidonias, janë të pranishme formacionet koraligjene me diversitet të lartë të sfungjerëve dhe makroalgave dhe sfungjerët nga genus Axinella, Agelas dhe Spongia. - Gjithashtu brenda kësaj nënzona është gjetur një diversitet i madh peshku, por ato më të zakonshmet janë: <i>Chelon sp.</i>, <i>Mullus surmulletus</i>, <i>Diplodus sp.</i>, <i>Coris juli</i>, <i>Serranus cabrilla</i>, <i>Oblada sp.</i>, <i>Chromis sp.</i>, etj. • Vlerat kulturore: <ul style="list-style-type: none"> Nuk ka. Performanca natyrore e lartë, Ka përparësi ruajtjes të biodiversitetit, veçorive natyrore të jashtëzakonshme gjeomorfologjike, të shpateve, zonat natyrore skenike, të vlerave kulturore e arkeologjike dhe nuk duhet të ketë shqetësime nga veprimtaritë njerëzore. 	<p>Në këtë nënzonë janë të ndaluara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë ku përfshihet shfrytëzimi, modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij. • Çdo veprimtari apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojë gjendjen e konservimit të ekosistemit e habitatit, që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore, peizazhike dhe kulturore. • Çdo lloj ndërtimi në shpatet në një distancë nga bregu jo më afër se 300 m, mos çënim apo dhe tjetësim i kepeve dhe gjireve. • Derdhja e hidrokarbureve, ujërave të ndotura, të ujërave të zeza dhe ato sanitare të patrajuara. • Fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi, dhe fuçi, mbeturinat metalesh e qelqi dhe të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit. • Furtjen e çdo specijeje jo indigjene/vendase, të specieve gjenetikisht të modifikuar, apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë, dëmtimi i livadheve të posidonias nga marinë-kultura dhe spirancat. • Gërmimet, guroret, marrja e rërës apo dhe zhavorit. • Gjuetia dhe çfarë do lloj mjete për peshkim dhe marinë-kultura. • Hedhja dhe grumbullimi i mbeturinave urbane, të ndërtimeve buze rrugëve dhe në vendet skenike e të preferuara nga vizitorët. • Hedhja e mbetjeve të ngurta, inerteve, lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse, të plehrave dhe pesticideve. • Lëvizja e mjeteve motorike të çfarë doloji (veç zjarrëfiksive, të ndihmës së shpejtë dhe të administratës). • Ndotja nga shkarkimet e anijeve, derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura e të zeza të patrajuara. • Ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore e burimeve dhe shpellave nëndetare. • Ngritja e objekteve për veprimtaritë sportive e argëtuese, kampingjet, manifestimet e mëdha artistike dhe kulturore. • Prekja e cilësisë apo e natyrallitetit të peizazhit bregdetar, detare e tokësore, përfshirë dhe burimet shoqëruese biologjike dhe vlerat kulturore. • Prerja e bimësisë pyjore dhe ndezja e zjarreve në bregdet. • Shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë gjuetinë ilegale të tyre, mbipeshkimi dhe përdorimi i mjeteve e metodave të ndaluara në zonën e mbrojtur dhe rreth saj. • Stërvitjet dhe veprimet ushtarake. • Veprimtaritë sociale-ekonomike, turistike, tregtare, ndërtime dhe përdorimi i teknologjive intensive, mjetet dhe mënyrat që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, strukturën dhe funksionet e ekosistemeve tokësore e detare. • Vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi dhe organizimi i garave masive me automjete, motoçikleta e biçikleta jashtë vendeve të caktuara. <p>Në këtë nënzonë janë të lejuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e qeta, vizita në vende të trashëgimisë kulturore dhe shijimi i traditave gastronomike, nëpërmjet guidave apo dhe të organizuar në grupe të kufizuara, të cilat ruajnë qetësinë e zonës, cilësitë e natyrës së egër, ato që nxisin zhvillimin e ekoturizmit, nga agjencitë e specializuara dhe të miratuara. • Ekoturizmi me bazë në natyrë dhe arsimor sipas rregullave dhe kufizime të qarta për nënzonën. • Fotografimi, pikturimi i natyrës e peizazhit, apo dhe nëpërmjet zhytjeve, vetëm në vendet e caktuara nga administrata. • Krijimi dhe vendosja e infrastrukturës së nevojshme për pritjen dhe informimin e vizitorëve, kryesisht pranë pikave hyrëse, tërheqëse, të vendqendrimeve, në përputhje me kapacitetin mbajtës mjedisor. • Ndërtimi i moleve të vegjël për varkat e motorat e ujërave, dhe i vendeve të parkimit, në pikat e caktuara nga administrata e ZM. • Ndërhyrjet përmirësuese të përkohshme vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit si zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, heqjen e mbetjeve të ngurta, plastikave, qelqi, hekuri dhe të hidrokarbureve, etj. • Zbulimi, shikimi dhe shijimi i zonave natyrore (ecje nëpër monopatet dhe shtigjet e lejuara, marrshim me udhërrëfyes apo i lirë, studim i florës dhe faunës tokësore e detare, të peizazhi me vlera të veçanta, i formave gjeologjike e gjeomorfologjike, shpellat, etj.).

Natyralityeti/Asetet natyrore-kulturore	Veprimtaritë njerëzore/sociale-ekonomike-turistike
Nën-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)	Shkalla e II e Ruajtjes
	Nënzona mbështet lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor të veprimtarive parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Mbrojtja sigurohet në bashkëveprim me autoritete lokale, dhe palët e tjera të interesuara, nëpërmjet patullimeve duke zbatuar rregullat apo metodikat e përdorimit të caktuara rreptësisht
Nën-Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ZZHQ)	Shkalla e III e Ruajtjes
Sipërfaqja e përgjithshme 1,579.87 ha, nga e cila 157.00 ha tokësore dhe 1,422.87 ha detare. Përshkrimi: Pjesa tokësore e kësaj nënzona përfshin gjithë territorin që mbetet nga ZQ, ZME dhe ZR, kryesisht pjesa e sipërme e kepit të Alaupit, e plazhit të Lllamanit, pjesa qëndrore e kepit të Kavadorit, Panormës, të Spinarisit dhe shpatet përgjatë rrugës automobilistike. Po kështu përfshihet e gjithë sipërfaqja ujore detare e nëndetare, burimet nën ujore të gjirit të Armeridhës dhe shpellat. Habitatet dhe specie: • Habitatet dhe specie: - Shkurret termo-mesdhetare dhe para-shkretëtirë , i përbërë nga shoqërimet e Rryellit (<i>Euphorbia dendroides</i>), tek kepi i Panormës. Përbërja floristike e kësaj bashkësie konsiston kryesisht në: <i>Salvia triloba</i> , <i>Lotus cytisoides</i> , <i>Limonium anfractum</i> , <i>Elymus pycnanthus</i> , <i>Desmazeria marina</i> , <i>Lotus cytisoides</i> , <i>Phlomis fruticosa</i> , <i>Glancium flavum</i> , <i>Galium aparine</i> , <i>Pistacia terebinthus</i> , <i>Spartium junceum</i> , <i>Ruscus aculeatus</i> , <i>Asparagus acutifolius</i> , <i>Urginea Maritima</i> , <i>Aspodelus aestivus</i> , <i>Chrysopogon Gryllus</i> , <i>Acanthus spinosus</i> , <i>Trifolium angustifolium</i> , <i>Brassica incana</i> , <i>Palurus spina-christi</i> . Këto specie: <i>Crithmum maritimum</i> , <i>Limonium anfractum</i> , <i>Elymus pycnanthus</i> , <i>Desmazeria marina</i> , <i>Lotus cytisoides</i> , etc. represent endemic communities of <i>Crithmo-Limonietum anfracti</i> , <i>Capparis orientalis</i> , <i>Putoria calabrica</i> , <i>ephedra foemina</i> , etc. Further, <i>Acis Ionica</i> , <i>Athamanta macedonica</i> , <i>Brassica incana subsp. egea</i> , etc., përfaqësojnë një bimësi të rrallë dhe disa specie relike subendemike. Komunitetet Detare benthic dhe habitatet - Biocenosat e shkëmbinjeve të ulët mediolitoral , kryesisht algat e kuqe (<i>Lithophyllum byssoides</i>). - Biocenosat e shpellave mediolitoral , rriten lloje si: <i>Hildenbrandia prototypus</i> , <i>Phymatolithon lenormandii</i> , <i>Peyssonelia spp.</i> , - Biocenosat e algave infralitorale - Shoqërime me <i>Cystoseira amentacea var. spicata</i> . - Livadhet me bar deti, janë të pranishme tre lloje bimësh: <i>Posidonia Oceanica</i> , <i>Cymodocea nodosa</i> and <i>Halophila stipulacea</i> . - Shoqërimet e biocenosave të koralogjeneve : tek Gjiri i Lllamanit përfaqësohet nga alga mucilagjinose, fotofile të tjera, iriq të zinj (<i>Arbacia lixula</i>) dhe sfungjerë të dominuar nga <i>Chondrilla nucula</i> . Në Gjirin e Porto Palermos, makrobentosit është i dominuar nga popullata me alga fotofile, sfungjerë (<i>Chondrilla nucula</i>) dhe iriqët e zi të detit (<i>Arbacia lixula</i>). Në pjesën veriore, livadhi me Posidonia është në një gjendje të mirë dhe një prani e konsiderueshme e <i>Codium sp.</i> dhe <i>Pinna nobilis</i> . Ndërsa në pjesën jugore, janë regjistruar edhe shumë alga të tjera invazive të <i>Caulerpa racemosa var. cylindracea</i> (hardhi të <i>Caulerpes</i>). - Në zonën Gadishulli i Panormës-Kepi i Spinarisit, mediolitorali karakterizohet nga një prani e vazhdueshme e algave <i>Cystoseira amentacea</i> dhe fotofileve të tjera, të dominuara nga <i>Padina</i> , <i>Acetabularia</i> dhe <i>Dyctyota</i> . - Në pjesën Veri-Perëndimore dhe Lindore, pranë kufirit më të ulët të Posidonias, janë të pranishme formacionet koraligjene të pasura me makroalga dhe sfungjerë të gjinisë <i>Axinella</i> , <i>Agelas</i> dhe <i>Spongia</i> . - Zona e Porto Palermos-Lllamanit është mjaft e larmishme dhe në llojshmërinë e peshqëve, ku më të zakonshmet janë: <i>Chelon sp.</i> , <i>Mullus surmulletus</i> , <i>Diplodus sp.</i> , <i>Coris Julii</i> , <i>Serranus cabrilla</i> , <i>Oblada sp.</i> , <i>Chromis sp.</i> etc.	Në këtë nënzona janë të ndaluara: • Veprimtaritë ku përfshihet shfrytëzimi, modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij. • Çdo veprimtari apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojë gjendjen e konservimit të ekosistemit e habitatit dhe që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore, peizazhike dhe kulturore. • Derdhja e hidrokarbureve, e ujërave të ndotura, të ujërave të zëza dhe ato sanitare të patrajuara. • Fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi, si dhe fuçi, mbeturinat metalesh e qelqi dhe të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit. • Futjen e çdo speciejë jo indigjene/vendase, të specieve gjenetike të modifikuara, apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë, dëmtimi i livadheve të posidonias nga marinë-kultura dhe spirancat. • Gërmimet, guroret, marrja e rërës apo dhe zhavorit. • Gjuetia dhe çfarë do lloji mjeti për peshkim dhe marinë-kultura, jashtë rregullave dhe objektivave të menaxhimit. • Hedhja dhe grumbullimi i mbeturinave urbane, të ndërtimit buzë rrugëve dhe në vendet skenike e të preferuara nga vizitorët. • Hedhja e mbetjeve të ngurta, inerteve, lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse, të plehrave dhe pesticideve. • Ndotja nga shkarkimet e anijeve, derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura e të zeza të patrajuara. • Përdorimi i molit të Portopalermos nga anijet e mëdha të peshkimit. • Prekja e cilësisë apo e natyralityetit të peizazhit bregdetar, detare e tokësore, përfshirë dhe burimet shoqëruese biologjike dhe vlerat kulturore. • Prerja e bimësisë pyjore dhe ndezja e zjarreve në bregdet. • Shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë gjetinë ilegale të tyre, mbipeshkimi dhe përdorimi i mjeteve e metodave të ndaluara janë të prekshme në zonën e mbrojtur dhe rreth saj si dhe largimi gradual i marinë-kulturës. • Stërvitjet dhe veprimet ushtarake. Në këtë nënzona janë të lejuara: • Veprimtaritë e qeta, vizita në vende të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe shijimi i traditave gastronomike, nëpërmjet guidave apo dhe të organizuar në grupe të kufizuara, të cilat ruajnë qetësinë e zones, cilësitë e natyrës së egër, ato që nxisin zhvillimin e ekoturizmit, nga agjencitë e specializuara dhe të miratuara. • Veprimtaritë e qëndrueshme dhe të kontrolluara të peshkimit tradicional, dhe gradualisht largimin e veprimtarisë së marinë-kulturës nga sipërfaqja e ZM. • Veprimtaritë që nuk ndikojnë në integritetin ekologjik të ekosistemit mund të aplikohen vetëm kur lëshohet leja mjedisore. • Veprimtaritë sezonale social-ekonomike, kullotja, mbledhja e bimëve mjekësore dhe përdorimi i tokës për prodhime bujqësore. • Krijimi dhe vendosja e infrastrukturës së nevojshme për pritjen dhe informimin e vizitorëve kryesisht pranë pikave hyrëse, tërheqëse dhe të vendqendrimeve, në përputhje me kapacitetin mbajtës mjedisor. • Kullotja sezonale e bagëtive dhe mbarështrimi tradicional i tyre (përfashto dhitë), dhe krijimi dhe mirëmbajtja e strukturave strehuese (stanet) dhe ushqyese të bagëtive. • Mbështet mënyra jetese dhe veprimtaritë ekonomike që janë në harmoni me natyrën, ruajtjen e konstitucionit shpirtëror dhe kulturor të popullsisë lokale. • Mirëmbajtja dhe trajtimi i mbetjeve urbane, i ujërave të zeza dhe të përdorura, kryesisht në zonat e caktuara për pushuesit. • Ndërtimi i moleve të vegjël dhe i vendeve të parkimit, në pikat e caktuara nga administrata e ZM. • Ndërhyrjet përmirësuese të përkohshme, vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit si zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, heqjen e mbetjeve të ngurta, plastikave, qelqi, hekuri dhe të hidrokarbureve, etj. • Ndërtimi i infrastrukturës për veprimtaritë sportive, argëtuese, sportet ujore e zhytjeve, të përdorimit të motorave të ujit, varkat, skafet (brenda zonave të caktuara nga administrata), peshkimin sportiv, si dhe ecjet në natyrë në shtigjet e caktuara nga administrata. • Përdorimit afatgjatë të qëndrueshëm, të barazpeshuar të burimeve natyrore tokësore, detare e nëndetare që nënzona u mundëson popullsisë lokale përfitime ekonomike, por që nuk vijnë ndesh me objektivat e menaxhimit.

Nature Type/Natural and Cultural Assets	Human/Social/ Economic and Touristic Activities
Sustainable Development Zone (SDZ)	Third Level of Protection
<ul style="list-style-type: none"> Vlerat kulturore: Nuk ka. Performanca natyrore e mjaftueshme. Ka përparësi harmonizimin e ruajtjes së natyrës, të peizazhit dhe të biodiversitetit, duke bashkërenduar menaxhimin e zonës së mbrojtur me zhvillimin e qëndrueshem ekonomik e social. 	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i molit të Portopalermos për një numër të kufizuar anije e skafe turistike, për varkat e peshkatoreve artizanale, për mjetet lundruese të ndihmës së shpejtë dhe të organeve të kontrollit të detit. Zbulimi, shikimi dhe shijimi i zonave natyrore (ecje nëpër monopatet dhe shtigjet e lejuara, marrshim me udhërrëfyes apo i lirë; studim i florës dhe faunës tokësore e detare, të peizazhi me vlera të veçanta, i formave gjeologjike e gjeomorologjike, shpellat, etj.). <p>Nënzona mbështet lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor të veprimtarive parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshem të resurseve natyrore.</p> <p>Zona krahas zhvillimit social-ekonomik duhet të sigurojë, të ruajë kushtet e habitatit të domosdoshme për mbrojtjen e specieve të rëndësishme, grup-speciet, komunitetet biotike ose karakteristikave fizike të mjedisit, gjë që kërkon ndërhyrje njerëzore të veçanta për një menaxhim të qëndrueshem.</p> <p>Mbrojtja sigurohet në bashkëveprim me autoritete lokale dhe palët e tjera të interesuara, nëpërmjet patrullimeve duke zbatuar rregullat apo metodikat e përdorimit të caktuara rreptësisht.</p>
Nën-Zona e Rekreacionit (ZR)	Shkalla e III e Ruajtjes
<p>Sipërfaqja e përgjithshme 42.61ha, tokësore.</p> <p>Në gjire distanca për përdorim nga pushuesit nuk duhet të jetë më tepër se 150-200m, dhe kufizohet me bova, për të sinjalizuar dhe kufizuar përdorimin e tyre nga varkat, skafet, motorat e ujit dhe mjetet e tjera, që cilat rrezikojnë jetën e pushuesve.</p> <p>Përshkrimi: Përfshihen të gjitha qendrat aktuale që përdoren nga biznesi e pushuesit, vizitorët dhe turistët në Gjirin e Lamanit, të Armeridhës, të Shën Nikollës, të Gravës, si dhe ndërtesa ushtarë, të cilat do të riklasifikohen dhe do të përdoren për qëllime pushimi dhe turistike.</p> <ul style="list-style-type: none"> Habitatet dhe specie: Nuk ka. Vlerat kulturore: Kalaja e Porto Palermos dhe Kisha e Shën Nikollës. 	<p>Në këtë nënzonë janë të ndaluar:</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaritë ku përfshihet shfrytëzimi, modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij. Derdhja e hidrokarbureve, e ujërave të ndotura, të ujërave të zëza dhe ato sanitare të patrajuara. Fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi, si dhe fuçi, mbeturinat metalesh e qelqi dhe të tjera të rënda që mund të zhyten në fundin e detit. Gërmimet, guoret, marrja e rërës apo dhe zhavorit. Gjuetia dhe çfarë do lloj mjeti për peshkim dhe marinë-kultura. Hedhja dhe grumbullimi i mbeturinave urbane dhe të ndërtimit buzë rrugëve dhe në vendet skenike e të preferuara nga vizitorët. Hedhja e mbetjeve të ngurta, inerteve, lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse, të plehrave dhe pesticideve. Ndotja nga shkarkimet e anijeve, derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura e të zeza të patrajuara. Përdorimi i molit të Portopalermos nga anijet e mëdha të peshkimit. Prekja e cilësisë apo e natyralitetit të peizazhit bregdetare, detare e tokësore, përfshirë dhe burimet shoqëruese biologjike dhe vlerat kulturore. Kullotja dhe mbarështimi i bagëtive brenda kësaj nënzone. <p>Në këtë nënzonë janë të lejuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> Krijimi dhe vendosja e infrastrukturës së nevojshme për pritjen dhe informimin e vizitorëve, kryesisht pranë pikave hyrëse, tërheqëse dhe të vendqendrimeve, në përputhje me kapacitetin mbajtës mjedisor. Mirëmbajtja dhe riklasifikimi i ndërtesave ekzistuese dhe të ushtrisë për qëllime të ndërtimit të resorteve, zonave të pushimit dhe pritjes së pushuesve dhe vizitorëve. Mirëmbajtja dhe trajtimi i mbetjeve urbane, i ujërave të zëza dhe të përdorura, kryesisht në zonat e caktuara për pushuesit. Ndërhyrje përmirësuese të përkohshme vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit si zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, heqjen e mbetjeve urbane, të ngurta, plastike, qelqi, hekuri etj. Ndërtimi i moleve të vegjël dhe i vendeve të parkimit, në pikat e caktuara nga administrata e ZM. Ndërtimi i godinave për banim apo turistike brenda kësaj nënzone duhet të bëhet vetëm pasi të jenë caktuar parcelat e hapësirave publike përfshirë korridoret e rrugëve me infrastrukturë komunale dhe zona të gjelbra si dhe një brez 10-50 m nga bregu i detit për vendosjen e çadrave e të strukturave të lehta të shërbimeve për pushuesit. Ndërtimi i infrastrukturës për hapësira publike, fusha sportive e kënde lojërash, sporte ujore e të zhytjeve, të përdorimit të motorave të ujit, varkat, skafet, vendet e peshkimit sportiv, kulla vëzhgimi, ecjet në natyrë në shtigjet e caktuara, muzeumi nënujor, parkime, kampingje, për qëllime shpirtërore, veprimtarive kulturore, librari, panairë, ekspozita, manifestime publike, fotografim, pikturim i natyrës e peizazhit, shëtitore përgjatë bregut, lehtësira për ushqim apo argëtim për vizitorët e turistët etj. të kësaj natyre. Resorti turistike në ish pronat e ushtrisë nuk duhet të ketë densitet të lartë, të kufizohen ndërtimet që çenojnë, prekin format e peizazhit dhe të miratohet plani rregullator i hollësisht nga KKT-ja, në përputhje të plotë me objektivat dhe masat menaxhuese të caktuara për zonën e mbrojtur. Veprimtaritë sociale-ekonomike, turistike, tregtare dhe shërbimet në ndihmë të pushuesve dhe vizitorëve <p>Nënzona mbështet lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor të veprimtarive parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshem të resurseve natyrore.</p> <p>Mbrojtja sigurohet në bashkëveprim me autoritete lokale, dhe palët e tjera të interesuara, nëpërmjet patrullimeve duke zbatuar rregullat apo metodikat e përdorimit të caktuara rreptësisht.</p>

3.4 Plani i Veprimit

Plani i veprimit mbështet realizimin e plotë të planit të menaxhimit, të programeve, objektivave afatgjatë e afatshkurtër të caktuar për menaxhimin e zonës së mbrojtur, të afateve dhe strukturat përgjegjëse që do të merren me realizimin e tyre.

Forcimi i administrimit dhe i menaxhimit të zonës së mbrojtur, siguron administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit unik detar, bregdetar dhe të peizazhit si dhe për të mirëmbajtur proceset kryesore ekologjike të zonës së mbrojtur, duke lejuar ndërkohë edhe veprimtaritë sociale, ekonomike e ekoturistike afatgjatë, në përputhje me vizionin e saj.

Plani i veprimit cakton masat që duhet të ndërmerren për krijimin dhe funksionimin e administratës, pas shpalljes së zonës të mbrojtur. Masat për pjesëmarrësit, palët e interesuara për njohjen, zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, të planit të menaxhimit. Nevojën për ngritjen e kapaciteteve, forcimin e bashkëpunimi me Bashkinë e Himarës dhe grupeve të tjera vendore të interesit. Këto masa kërkojnë gjithashtu sigurimin e mjeteve të nevojshme të punës dhe të logjistikës për kryerjen e detyrës së personelit të administratës së zonës të mbrojtur.

Ruajtja e ekosistemit, habitateve, biodiversitetit dhe peizazhit detar e bregdetar, synon konservimin afatgjatë të tyre, veçanërisht të tipeve të habitateve dhe specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara. Masat e veprimit konsistojnë në menaxhimin e specieve të florës dhe faunës me qëllim mirëmbajtjen e tyre në një gjendje të favorshme konservimi. Kjo do të arrihet nëpërmjet identifikimit, hartimit të listave për tipet e habitateve e të specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara, sipas statusit mbrojtjes të tyre. Masat në këtë rast duhet të rregullojnë, dhe kur është e nevojshme të ndalojnë, veprimtaritë që kanë efekte negative në speciet apo habitatet e tyre, të realizojnë menaxhimin me masa të tjera për sigurimin e një gjendjeje të favorshme konservimi të tyre. Njëherazi, duhet të formulohen e të zbatohen masa veprimit për mbrojtjen, ripërtëritjen dhe përmirësimin e statusit të tyre të kërcënimit, përfshi dhe speciet migruese, nëpërmjet hartimit të planeve të veçanta të veprimit.

Masë e rëndësishme, ndonëse e vogël për ZM, duhet të merret për rregullimin e futjeve të qëllimta apo aksidentale të specieve joindigjene ose atyre të modifikuara gjenetikisht në habitatet natyrore dhe të ndalojnë futjen e atyre specieve që mund të kenë ndikime të rënda në ekosistemin, habitatet apo speciet siç është rasti i *Agaves (Agave americana L.)*, Arrëhindit (*Ailanthus altissima (Mill.) Swingle*), *Caulerpa Racemosa* var. *cylindracea*, *Halophila stipulacea*, Gaforrja (*Pernon gibbesi*), etj.

Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore bregdetare-detare, përfshi dhe ato historike e kulturore, mbështet sigurimin, forcimin e sistemit të menaxhimit, përdorimin afatgjatë të burimeve natyrore, të veçorive të peizazhit dhe të vlerave kulturore e historike, në përputhje me kapacitetin ekologjik të zonës së mbrojtur. Ato rregullojnë, sipas nënzoneve, veprimet konkrete për mirëpërdorimin e

këtyre burimeve, sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e jetesës së komuniteteve lokale dhe përmirësimin e shërbimeve të qëndrueshme të ekosistemit, nëpërmjet mekanizmave financiare që mund të rritin finacimet për rimëkëmbjen e natyrës dhe të shërbimeve që lidhen me të

Veprimtaria kryesore ekonomike, brenda sipërfaqes së ZM, është zhvillimi i marinë-kulturës, pasi veprimtaritë bujqësore, silvo-pastorale dhe mbarështrimi i bagëtive mbetet shumë i kufizuar. Peshkimi në Gjirin e Porto Palermos është një veprimtari relativisht më pak i rëndësishëm. Masat konsistojnë në zhvillimin e peshkimit artizanal, në grupe të kufizuar peshkatarësh vendas dhe të peshkimit turistik.

Masë e rëndësishme mbetet përforcimi i monitorimit, kontrollit dhe mbikqyrjes, në mënyrë që të garantojë mirëmenaxhimin e peshkimit dhe ndalimin e tij në gjirinë e Perotopalermos dhe të mbledhjes së paligjshme e shkatërruese të daterit (*Lithophaga*), që ka shkaktuar dëmtimin e brigjeve shkëmbore. Në procesin e menaxhimit të ZM do të përfshihen peshkatarët vendas dhe grupet e peshkimit artizanal (peshkatarët e vegjël.

Në planin e veprimit parashikohet që subjektet, të cilëve leja e marinë-kulturës u mbaron në vitin 2018 dhe 2021, duhet të miratojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me statusin e ri të zonës, jashtë territorit të saj, mbështetur nga ligji i ri për akuakulturën dhe statusi mbrojtës në lidhje me Mbrojtjen Natyrore dhe Gjysmë-Natyrore të habitatave të faunës së egër dhe florës.

Masa konservuese dhe përdoruese parashikohen edhe për burimet kulturore si Kalaja e Ali Pashës, Kisha e Shën Nikollës, ato arkeologjike nënujore dhe për muzeumin.

Zhvillimi i veprimtarive të qëndrueshme çlodhëse, argëtuese, sportive dhe shëndetësore, siguron zhvillimin e veprimtarive ekoturistike, çlodhëse, argëtuese, shëndetësore dhe kulturore. Nxitjen e komunitetit dhe të bizneseve, pa çenuar vizionin dhe objektivat e ZM, duke sjellë përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve dhe të vizitorëve, të lidhura me bashkëfunksionimin e ruajtjes së natyrës e të peizazhit me zhvillimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive ekoturistike, përbëjnë thelbin e masave vepruese.

Masat e caktuara nxitin që të zbatohen format e zhvillimit dhe menaxhimit të veprimtarive, të cilat ruajnë integritetin natyror, social e ekonomik dhe gjendjen e burimeve detare-bregdetare e kulturore në vazhdimësi.

Po kështu, synojnë zhvillimin e standarteve të lehtësirave apo shërbimeve turistike që janë në harmoni me karakterin e ZM. Infrastruktura që lidhen me menaxhimin e saj dhe pritjen e vizitorëve duhet të ketë pamje të bukur, tërheqëse, natyrore të qetë, të shijohet nga vizitorët e turistët dhe të jetë prezantuese për identitetin e zonës së mbrojtur.

Synohet zhvillimi i ekoturizmit dhe turizmit të peshkimit rekreativ-sportiv, si një mënyrë për të rritur të ardhurat dhe interesimin e peshkatarëve për vlerat e zonës.

Veprime konkrete duhet të ndërmerren që të mbrohet cilësia e ujit detar-bregdetar përmes zhvillimit të infrastrukturës së sistemit të kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të zëza dhe ato të përdorura, për sigurimin e ujit të pijshëm, të menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, etj.

Promovimi i vlerave, monitorimi e kërkimi shkencor, ndërgjegjësimi dhe edukimi, ndihmon në promovimin e vlerave mjedisore e kulturore, nxitjen e kërkimit shkencor, të monitorimit, të veprimtarive ndërgjegjësuere dhe informuese në procesin edukativ të rinisë, popullatës dhe për vizitorët.

Masat duhet të inkurajojnë dhe zhvillojnë kërkime shkencore për përdorimin e qëndrueshëm të nënzoneve veçanërisht menaxhimin e habitateve dhe specieve të mbrojtura. Mbështetja e këtyre masave të do përmirësojë programin e monitorimit për kërkime shkencore, teknikat menaxhuese dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të marra për të zbatuar planin e menaxhimit dhe të veprimtarive njerëzore.

Të rëndësishme janë masat vepruese për publicitetin e duhur që duhet t'i kushtohet në përgjithësi zonës së

mbrojtur. Veçanërisht në njohjen e vlerave ekologjike, natyrore, të biodiversitetit, peizazhit, tradicionale e kulturore, të kufijve, rregullave të caktuara për menaxhim, veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara, për speciet e mbrojtura, habitatet e tyre, rregullat e menaxhimit të vizitorëve, duke siguruar dhe llojshmërinë e botimeve.

Kësisoj proces i rëndësishëm mbetet informimi i publikut për interesin, vlerat e zonës së mbrojtur, e veçanërisht për speciet, habitatet, për dijet shkencore, që mund të fitohen nga pikëpamja e ruajtjes së natyrës dhe e kulturës. Ky informacion duhet të ketë një vend të vetin në programet edukative dhe ndërgjegjësuere.

Gjithashtu, vlerësohen në këto masa përpjekjet dhe nxitja e pjesëmarrjes së publikut, të organizatave jo qeveritare, të shkollave, të medias, biznesit e privatëve, për ndërmarrjen e hapave që janë të nevojshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së mbrojtur dhe njohjen e ndikimit të veprimtarive njerëzore.

Në tabelën 8, jepen të gjitha veprimet dhe kuadri kohor për zbatimin e masave të planit të veprimt.

Tabela 8: Veprimet kryesore menaxhuese

VEPRIMET MENAXHUESE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI KOHOR	NËNZONAT E MENAXHIMIT	INDIKATORËT
PROGRAMI 1: FORCIMI I ADMINISTRIMIT DHE I MENAXHIMIT TË ZONËS SË MBROJTUR				
Miratimi i rajonit të Gjirit të Palermos-Llamani, zonë e mbrojtur, me status “Park Natyror”.	MM / AKZM	2015	Zona e Mbrojtur	Mbikqyrja dhe menaxhimi në mënyrë profesionale dhe me efektivitet.
Miratimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Natyror “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”.	MM / AKZM	2015	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i dokumentit kryesor për menaxhimin e ZM.
Miratimi i krijimit të administratës së zonës të mbrojtur “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”.	MM / AKZM	2015	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i stafit profesional në dispozicion të administrimit të ZM.
Haritimi dhe zbatimi i veprimeve për njohjen e dispozitave ligjore në fuqi, në lidhje me administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore të ZM.	Administrata ZM ISHMPU	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Zbatimi i ligjshmërisë, ulja e rasteve të kundërvajtjeve penale dhe administrative.
Njohja dhe zbatimi i planit të menaxhimit të PN “Gjiri i Portopalermos-Llamani”.	Administrata ZM	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e performancës së menaxhimit të ZM.
Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë, administratës së zonës të mbrojtur dhe grupeve të tjera vendore të interesit.	Administrata ZM Bashkia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Përfshirjen e palëve të interesuara në procesin e konsolidimit të menaxhimit dhe përdorimit të burimeve natyrore.
Trajnim i personelit të Administratës mbi menaxhimin e informacionit dhe të të dhënave për ekosistemet bregdetare e detare.	MM / AKZM Institucionet shkencore	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Ngritja e nivelit shkencor për ekosistemet detare dhe bregdetare.
Trajnim i anëtarëve lokale për menaxhimin, veprimtaritë në ZM dhe mbi përgjegjësitë e tyre.	MM / AKZM AdZM / Bashkia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Konsolidimi i njohurive dhe i përgjegjësisve për zbatimin e veprimtarive në ZM.
Përcaktimi në terren i kufijve të ZM dhe i nënzonave të menaxhimit.	AdZM / Bashkia	2015-2016	Zona e Mbrojtur	Vendosja e shënjave treguese për kufirin tokësor dhe detare të ZM.
Përgatitja dhe implementimi i një rregulloreje për funksionimin dhe përgjegjësitë e administratës së ZM.	MM / AKZM AdZM	2015	Zona e Mbrojtur	Përcaktimi i detyrave, përgjegjësitë dhe të drejtat e stafit në ushtrimin e detyrës.
Kontrolli i veprimtarive sociale, ekonomike, turistike dhe të shërbimeve, brenda territorit të ZM.	ISHMP AdZM	2015 vazhdimisht	Nën-zonat e menaxhimit	Vendosja e kontrollit sipas nënzonave për të gjitha veprimtaritë social-ekonomike.
Kontroll dhe rregullim i peshkimit dhe i marinë-kulturës, sipas nënzonave të menaxhimit.	ISHMP AdZM	2015 vazhdimisht	Nën-zonat e menaxhimit	Disiplinimi i peshkimit artizanal dhe largimi gradual i marinë-kulturës.
Kontroll i gjuetisë ilegale të peshkimit dhe të specieve të faunës së egër tokësore dhe detare.	ISHMP AdZM	2015 vazhdimisht	Nën-zonat e menaxhimit	Ndalim i gjuetisë së specieve të faunës së egër tokësore dhe detare, brenda ZM.

VEPRIMET MENAXHUESE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	AFATI KOHOR	NËNZONAT E MENAXHIMIT	INDIKATORËT
Kontroll i zjarreve në kullota, ndodjes së ujërave detare e bregdetare, mbetjet e ngurta, derdhjen e ujërave të zeza dhe sanitare të parajtuara, hedhjen çfarëdolloj mbeturinë dhe mbytjen e mjeteve të lundrimit.	ISHIMP AdZM	2015 vazhdimisht	Nën-zonat e menaxhimit	Rritja e cilësisë e ujërave detare e nëndetare dhe të peizazhit.
Sigurimi i mjeteve të nevojshme të punës dhe të logjistikës për kryerjen e detyrës së personelit të administratës së zonës të mbrojtur (Ndërtesa e personelit, pajisje e mobilje zyre, PC komplet, printer, fotokopje, scanner, uniforma, motora, dylbi, kamera, teleskop, skaf.)	MM / AKZM AdZM	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e performancës së administratës dhe i kontrollit për zbatimin e detyrave dhe të planit të menaxhimit
PROGRAMI 2. RUAJTJA E EKOSISTEMIT, HABITATEVE, BIODIVERSITETIT DHE PEIZAZHIT DETAR E BREGDETAR				
Hartimi i planave të veprimit për konservimin e shumëllojshmërisë biologjike, për mirëmbajtjen e habitateve detare, bregdetare dhe tokësore.	MM/AKM / AKZM Insit. Shkencore	2015 vazhdimisht	Sipas nënzonave	Përmirësimi i cilësisë dhe i statusit për t'ipet e habitateve dhe të specieve të rrezikuara dhe të mbrojtura.
Identifikimi dhe hartimi i listave të komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike, t'ipet e habitateve e të specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara, sipas statusit mbrojtjes të tyre.	MM/AKM / AKZM Insit. Kërkimore	2015-2018	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i listave me të dhëna të plota për specie, t'ipet e habitateve dhe krijimi i database të ZM.
Formulimi dhe zbatimi i masave të veprimit për mbrojtjen, ripërtëritjen dhe përmirësimin e statusit të tyre të kërcënimit, përfshi dhe speciet migruese.	MM/AKM Insit. Kërkimore	2015-2020	Zona e Mbrojtur	Përmirësimi i statusit të ruajtjes dhe të kërcënimit të specieve.
Identifikimi i proceseve dhe kategoritë e veprimtarive, të cilat kanë apo kanë të ngjarë të kenë ndikime negative në rëndësishme në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike dhe monitorimi i efekteve të tyre.	MM / AKM / AKZM / Insit. Kërkimore AdZM Bashkia	2015-2020	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i të dhënave të nevojshme për veprimtaritë sociale, ekonomike e turistike
Rregullimin e furtjeve të qëllimit apo aksidentale të specieve jovendase dhe të modifikuara gjenerikisht në habitatet natyrore të ZM.	MM/AKM / AKZM Insit. Kërkimore	2015 vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Ndalimi i furtjes së specieve invazive.
Mirëmbajtja e cilësisë të lartë të ujërave detare e të burimeve nëndetare, parandalimi i degradimit dhe shkatërrimit të tyre.	AKZM / AKM AdZM / Bashkia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Ruajtja e cilësisë së ujërave të ekosistemit detar dhe të burimeve ujore nëndetare.
Ruajtja e karakteristikave detare dhe bregdetare të rëndësishë ekologjike, gjeologjike, gjeomorfologjike, kepet, gjiret, shpellat, tuneli, burimet dhe bota nënujore.	AKZM Administrata ZM / Bashkia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Ruajtjen e elementeve të njeshëm ekologjik bregdetar-detar nga shqetësimi dhe keqpërdorimi.
Hartimi i programit të veçantë për ruajtjen e livadheve me <i>Posidonia oceanica</i> .	MM / AKZM / AKM Insit. Kërkimore	2015-2017	Zona e Mbrojtur	Rritja e sipërfaqes me <i>Posidonia</i> dhe konsolidimi i menaxhimit të species.
Hartimi i programeve për mbikqyrjen dhe luftimin e llojeve invazive, <i>Agave americana L.</i> dhe <i>Ailanthus altissima (Mill.) Swingle</i> , të algave <i>Caulerpa sp.</i> , të Gatofres (<i>Percnon gibbesi</i>) etj.	MM / AKZM / AKM Insit. Kërkimore	2015-2017	Zona e Mbrojtur	Mbajta pastër e sipërfaqes (tokësore e nëndetare) së ZM, nga speciet invazive.
PROGRAMI 3: PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE BREGDETARE-DETARE, PËRFSHI DHE ATO HISTORIKE E KULTURORE.				
Zbatimi i formave të zhvillimit dhe menaxhimit të veprimtarive, që ruajnë integritetin natyror, social e ekonomik të burimeve natyrore detare-bregdetare dhe kulturore.	AdZM Bashkia	2015 vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Arritjen e zhvillimit e qëndrueshëm të veprimtarive social-ekonomike në zonën e mbrojtur.

VEPRIMET MENAXHUESE	INSTITUCIONI PËRQJEGJËS	AFATI KOHOR	NËNZONAT E MENAXHIMIT	INDIKATORËT
Sigurimi i mekanizmave të reja financiare që rritin investimet për rimëkëmbjen e natyrës, të biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore detare-bregdetare, në përputhje me kapacitetin mbajtës mjedisor.	AdZM Bashkia	2015 vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Përmirësimin e kapitalit natyror të peizazhit dhe të shërbimeve të ekosistemit bregdetar e detar.
Zhvillimi i standarteve të lehtësirave apo shërbimeve turistike në harmoni me karakterin e ZM, infrastrukturën e menaxhimit dhe të prezantimit të identitetit të ZM.	AdZM Bashkia	2015 vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Përmirësimi i shërbimeve të qëndrueshme ekonomike të ekosistemit dhe biodiversitetit detar e bregdetar.
Rregullimi i planifikimit të territorit, shfrytëzimit racional të hapësirave, sipas kapacitetit mbajtës të mjedisit dhe instrumentave të planifikimit të territorit.	AdZM Bashkia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Krijimi i standarteve të planifikimit të territorit dhe të ndërtimit në përputhje me kapacitetet dhe statusin e ZM.
Zhvillimi i infrastrukturës së sistemit të kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të zëra e ato të përdorura, për sigurimin e ujit të pijshëm, të menaxhimit dhe trajtimit të mbejeve urbane, etj., në kuadrin e mbrojtjes së cilësive të ujërave detare-bregdetare.	MM / AKZM / Ministrinë e linjës Bashkia / Administrata ZM	2015 e vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Shitim të numrit të vizitorëve, të shitejeve të prodhimeve tipike të zonës dhe të cilësive së peizazhit.
Rregullimi i shërkimit apo hedhjes së mbejeve apo substancave të tjera që mund të dëmtojnë direkt ose tërthorazi integritetin e zonës e mbrojtur.	ISHMP / Administrata ZM Bashkia	Vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Rritja e performancës mjedisore të ZM.
Rregullimi ose ndalimi e çdo veprimtarie shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës e ujërave apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit, të shrautit të detit apo nëntokës së tij brenda zonës së mbrojtur.	ISHMP / Administrata ZM Bashkia / Insit. Kërkimore	Vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Menaxhim i qëndrueshëm i tokës, ujërave dhe i peizazhit detar dhe nëndetar.
Rregullimi apo ndalim i çdo veprimtarie tjetër që dëmtonë e shqetësonë speciet ose që kërcënonë gjendjen e konservimit të ekosistemit apo që dëmtojnë karakteristikat natyrore dhe kulturore të ZM.	ISHMP/DSSH Administrata Bashkia / Insit. Kërkimore	Vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Përmirësimi i cilësive së peizazhit, shitim të numrit të faunës së egër detare e nëndetare, dhe të vizitorëve.
Rregullimi apo ndalim i pezhkimit e gjuetisë, të florës dhe faunës së egër, të datorit, koraleve dhe specieve të tjera të mbrojtura apo shkatërrimin e habitatit të shkëmbinjëve bregdetarë dhe nëndetar.	ISHMP/DSSH Administrata Bashkia / Insit. Kërkimore	Vazhdimisht	Zona e Mbrojtur	Ndalim i grumbullimit të specieve të mbrojtura, shitim të numrit të peshqëve që përdoren për tregti, pakësim të dëmtimit të brigjeve shkëmbore dhe të peizazhit.
Largimi i marinë-kulturës nga territori i ZM, bazuar në statusin e ri dhe nixtja e peshkimit artizanal dhe rekreativ.	MM / ISHMP MBZ/RAU / Bashkia Insit. Kërkimore	2018-2021	Gjiri i Armeridhës dhe i Shën Nikollit	Ruajtjen e cilësive së ujërave detare e nëndetare, rritja e burimeve peshkore natyrore dhe zhvillimi i ekoturizmit të peshkimit rekreativ.
Hartimi dhe zbatimi i projekteve teknike për sigurimin e nënzona detare të nevojshme për ruajtjen e specieve peshkore, të qetësive së shumimit të tyre (vendosja e blloqeve penguese për mjetet e lundrimit a të peshkimit në harmoni me kushtet nëndetare), të zhvillimit të turizmit dhe të muzeumeve nënujore.	Administrata ZM Bashkia / Insit. Kërkimore	2017-2024	Nënzonat Qendrore	Shitimi i veprimtarive ekoturistike në ZM.
Vlerësimi i pasurisë kulturore dhe ruajtjen e karakterit të domethënies historike dhe origjinale të tyre.	MK / AKZM Bashkia / Administrata ZM	2016-2018	Zona e Mbrojtur	Përgatitja e listës me të gjitha pasuritë kulturore, historike, arkeologjike dhe shpirtërore.
Zbatimi i projekteve teknike të veçantë për konservimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e burimeve kulturore si Kalaja e Porto Palermos, Kisha e Shën Nikollës, ato arkeologjike nënujore dhe krijimin e muzeumit.	MK / AKZM Bashkia / Administrata ZM	Çdo vit	Nënzonat e vlerave kulturore	Promovimi i vlerave kulturore, organizim të panairëve, ekspozitave, festivaleve folklorike, manifestimeve historike me vlerë lokale.
PROGRAMI 4: ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE TË QËNDRUESHME ÇLODHËSE, ARGËTUESE, SPORTIVE DHE SHËNDETËSORE.				
Nixtja dhe zhvillimi i veprimtarive ekoturistike, çlodhëse, argëtuese, shëndetësore dhe kulturore, nëpërmjet mbështetjes së sektorit privat dhe të komunitetit, pa cënuar vizionin dhe objektivat e ZM.	AdZM / Bashkia Sektorit privat	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e përmirësimit të shërbimeve, cilësive së jetesës të banorëve dhe shtim të vizitorëve.

VEPRIMET MENAXHUESE	INSTITUCIONI PËRÇJEGJËS	AFATI KOHOR	NËNZONAT E MENAXHIMIT	INDIKATORËT
Përcaktimin e itinerareve të lëvizjes në natyrë, të vendqendrimave sipas kërkesave të vizitorëve, kampingjet, rulotave, nyjet sanitare, vend grumbullimi i mbeturinave, shërbimi mjekësor, parking, vendet e peshkimit sportiv, shërbimet me kalë, molot, etj.	AdZM / Bashkia	2015-2017	Zona e Mbrojtur	Krijimi i kushteve për pritjen dhe informimin e vizitorëve.
Nxjtja e biznesit dhe komunitetit që të zbatohen format e zhvillimit dhe menaxhimit të veprimtarive, që ruajnë integritetin natyror, social, ekonomik e kulturor dhe gjendjen e burimeve detare-bregdetare.	AdZM / Bashkia Sektori privat	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i ndërveprimit të përbashkët të palëve të interesuara për zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore e kulturore.
Ndërtimi i infrastrukturës së pritjes të vizitorëve me pamje të bukur, tërheqëse, natyrore të qetë, që të shijohet nga turistët dhe të jetë prezantuese për identitetin e zonës së mbrojtur, sipas projekteve teknike.	DSHP Administrata / Bashkia	2015-2019	Zona e Mbrojtur	Prezantimi i kushteve të pritjes së ZM sipas standarteve më të mira që sigurojnë tërheqjen dhe shkrimin e numrit të vizitorëve dhe të turistëve.
Përcaktimin e zonave të veprimtarive eko-turistike në det dhe nëndet (zhytjeve, shëtitje me varkë me vela, peshkim sportivë, vrotim shpendësh ujor etj.	Administrata ZM / Sektori privat	2015 - 2016	Zona e Mbrojtur	Krijimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve që plotësojnë nevojat e vizitorëve dhe gjenerojnë të ardhura për komunitetin.
Vendosja dhe mirëmbajtja e kontenerëve për trajtimin dhe ndarjen në burim të mbeturinave në qendrat e plazheve dhe të preferuarra nga vizitorët.	Administrata ZM Bashkia / Sektori privat	2015 vzhdimisht	Zona e Mbrojtur	Menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta.
Përgatitja e guidave natyrore/eko-guidave të përshtatshme për grupe të ndryshme interesi.	Administrata ZM Bashkia, OJF	2015 vzhdimisht	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i informacionit dhe rritje e performancës së menaxhimit të vizitorëve.
Krijimi i qendrës muzeale, zonat arkeologjike, librari të dhe dyqanet e lidhura me argëtimin, prijjen e vizitorëve dhe për të promovuar burimet natyrore-kulturore dhe prodhimet tradicionale lokale.	AdZM Bashkia / Sektori privat	2015-2020	Zona e Mbrojtur	Sigurimi e informacionit për promovimin e vlerave natyrore, tradicionale, kulturore, shpirtërore që u mundësohen vizitorëve.
PROGRAMI 5: PROMOVIMI I VLERAVE, MONITORIMI E KËRKIMI SHKENCOR, NDËRÇJEGJËSIMI DHE EDUKIMI.				
Nxjtja e kërkimit dhe çdo veprimtarie shkencore që siguronë njohjen e vlerave, formën e menaxhimit të zonës së mbrojtur, përdorimin e qëndrueshëm, menaxhimin e habitateve dhe specieve të mbrojtura.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata ZM	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Studime dhe vlerësime të ekosistemeve tokësore dhe detare.
Studimi dhe vlerësimi i veprimtarive që kanë efekte negative në speciet apo habitatet e tyre, caktimi masave për sigurimin e një gjendjeje të favorshme konservimi të specieve të mbrojtura dhe të produkteve të tyre.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata ZM	2016-2017	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i listës së masave për përmirësimin e gjendjes së favorshme të konservimit të specieve dhe habitateve.
Hartimi i programeve monitoruese për identifikimin, vlerësimin e nënzonave, të efektivitetit të masave në zbatimin e planit të menaxhimit dhe përmirësimin e statusit të ruajtjes të specieve të mbrojtura.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata	2016-2017	Zona e Mbrojtur	Përmirësim të statusit të ruajtjes së specieve sipas nënzonave të menaxhimit.
Studimi, identifikimi dhe hartimi i listës së specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara të florës e faunës dhe përcaktimi i statusit mbrojtjes së specieve.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata ZM	2016-2017	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i listës së specieve të kërcënuara e të rrezikuara të florës dhe faunës së egër.

VEPRIMET MENAXHUESE	INSTITUCIONI PËRÇJEGJËS	AFATI KOHOR	NËNZONAT E MENAXHIMIT	INDIKATORËT
Studimi, identifikimi i habitateve dhe speciet problematike, statusit mbrojtës i tyre, përcaktimi i zonave prioritare për ruajtjen e specieve me interes për komunitetin.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata	2016-2018	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i një liste të habitateve dhe i zonave prioritare të konservimit të specieve me interes të KE.
Përcaktimi i indikatorëve matës dhe i parametrave kryesor për monitorimin e situatës mjedisore të ZM.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore	2016-2017	Zona e Mbrojtur	Përmirësimi i gjendjes së mjedisit natyror.
Studim mbi njohjen e shtrirjes së huaja dhe të ndikimit të tyre mbi ekosistemet natyrore të ZM.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore	2016-2018	Zona e Mbrojtur	Lista e përthapjes së specieve të huaja invazive.
Studim gjithëpërfshirës i shpërndarjes dhe i përcaktimit të statusit të llojeve të ndryshme të shkëmbinjve nënujorë.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore	2016-2018	Zona e Mbrojtur	Lista dhe statusi i llojeve të shkëmbinjve nënujorë.
Përcaktimi i masave të nevojshme për rregullimin e fytjeve të qëllimta apo aksidentale të specieve jovendase, të modifikuara gjenetikisht në habitatet natyrore dhe të ndalohet futja e specieve që mund të kenë ndikime të rënda në ekosistem, habitat apo dhe tek speciet e zonës së mbrojtur.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore Administrata ZM	2016-2017	Zona e Mbrojtur	Ujja e ndikimit të specieve jovendase në ekosistemet tokësore dhe detare.
Studimi, identifikimi dhe vlerësimi i efektivitetit të masave mbrojtëse e menaxhuese, zbatimi i planit të menaxhimit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes së specieve dhe i habitateve të tyre.	MM / AKZM / AKM Inst. Kërkimore / Administrata ZM	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e performancës së zbatimit të planit të menaxhimit.
Hartimi i programit edukim-ndërgjegjës për publicitetin e ZM, njohjen e vlerave ekologjike, natyrore, të biodiversitetit, peizazhit, tradicionale e kulturore, të kufijve, rregullave të menaxhimit, veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara dhe rregullat që duhet të zbatohen subjektr private dhe vizitorët.	Administrata ZM Bashkia / OJF	2016	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i programit të edukimit dhe ndërgjegjësimit.
Përmirësimi i procesit të ndërgjegjësimit publik, të kupuarit, vlerësimi i mjedisve të ZM dhe ndikimi i mundshëm i veprimtarive njerëzore në këto mjedisë.	Administrata ZM Bashkia / OJF, Masmedia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Vlerësim të potencialit të zonës së mbrojtur për zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarive njerëzore.
Mbështetje e OJF-ve mjedisore lokale dhe mediave për ndërmarrjen e veprimtarive ndërgjegjësuese.	DSHP/Administrata Bashkia / OJF, Masmedia	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit, OJF, dhe të sektorit privat në mirëmenaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore.
Organizim seminaresh dhe trajnimesh mbi përdorimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore e kulturore.	Administrata ZM Bashkia / OJF	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i dijeve, ngritje të kapaciteteve për menaxhimin e ZM.
Përgatitja e broshurave, fletëpalosje, posterat, albume, DVD, CD, spote publicitare, filma me metrazh të shkurtër; bluza dhe kapele me logon e ZM, vlerat natyrore, peizazhore dhe kulturore etj.	Administrata ZM Bashkia / OJF	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Sigurimi i materialeve të ndryshme publicitare, ndërgjegjëse dhe prezantuese për ZM.
Informimi publik për interesin dhe vlerat e zonës së mbrojtur, speciet dhe për dijet shkencore që mund të ftohohen nga pikëpamja e ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe këndvështrime të tjera.	Administrata ZM Bashkia / OJF	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Rritja e transparencës në zbatimin e planit të menaxhimit, të përdorimit racional të burimeve natyrore dhe kulturore.
Nxjtja e pjesëmarrjes së publikut, të OJF-ve, shkollave, medias, biznesit dhe privatëve, për ndërmarrjen e hapave të nevojshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ZM.	Administrata ZM Bashkia / OJF	Çdo vit	Zona e Mbrojtur	Zhvillimi i veprimtarive konkrete me pjesëmarrjen e paleve të intrerestuara.



IV. PLANI FINANCIAR

Plani financiar është i bazuar në veprimet e menaxhimit të paraqitura në pjesën 3. Ky plan përfshinë edhe nevojat e burimeve njerëzore.

MM dhe AKZM, nëpërmjet AdZM në Qarqe, ka përgjegjësitë për administrimin dhe menaxhin e rrejtit të ZM-ve në Shqipëri. Njëherazi mbetet autoriteti që përgatit programet dhe planin financiar (PBA) për fushën e ruajtjes e së natyrës, ku përfshihet rrjeti i ZM dhe biodiversitetit.

Çdo vit strukturat e MM dhe AKZM, në bashkëpunim me strukturat e saj në bazë, por dhe me Ministrinë e Financave, karahas përlllogaritjeve të të ardhurave, pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative, përgatit edhe planin e investimeve, sipas programeve të miratuara.

Nëpërmjet fish-projekteve që parashikohen të kryehen në ZM, sipas një formati standard, përlllogaritjet bëhen në mbështetje të ligjit themelor të “Buxhetit të Shtetit” dhe të artikujve që ai përmban.

Shpenzimet për sa i përket pagave të stafit të përhershëm, sigurimet shoqërore dhe kostot e tjera operative për Administratën e Zonave të Mbrojtura të Qarkut Vlorë, mbulohen drejtpërsëdrejti nga buxheti i shtetit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

